

Dokument
Udhëzues për Direktivën e Produkteve
të Ndërtimit në Shqipëri

Udhëzues i publikuar nga
Programi CARDS 2006

Përgatitur nga:

Adam Pinney,	<i>konsulent;</i>
--------------	-------------------

Ivan Hendrix,	<i>Kryetar i Grupit të Ekspertëve të Projektit;</i>
---------------	---

Ardian Maçi,	<i>menaxher i zyrës së Projektit;</i>
--------------	---------------------------------------

Etleva Mullaj (Qinami),	<i>konsulente;</i>
-------------------------	--------------------

Gjergj Filipi,	<i>konsulent</i>
----------------	------------------

P Ë R M B A J T J A:

SEKSIONI 1: Prezantim i Direktivës së Produkteve të Ndërtimit (CPD).....	7
1.1) <i>Si ta lexojmë këtë dokument udhëzues ?</i>	7
1.2) <i>Çfarë është Direktiva e Produkteve të Ndërtimit?.....</i>	9
1.2.1) <i>Bazat e direktivës.....</i>	9
1.2.2) <i>Avantazhet e CPD.....</i>	12
1.3) <i>Çfarë mbulon CPD</i>	13
1.3.1) <i>Situata në gjirin e BE-së.....</i>	13
1.3.2) <i>Situata në Shqipëri</i>	16
1.4) <i>Përgjegjësitë dhe pritshmëritë.....</i>	16
1.4.2) <i>Pritshmëritë.....</i>	16
1.5) <i>Kuadri ligjor në Shqipëri, duke përfshirë edhe përcaktimet e tjera ligjore përkatëse.</i>	20
1.6) <i>Lista e shkurtimeve.....</i>	22
SEKSIONI 2: Si funksionon CPD.....	29
2.1) <i>Standardet dhe Aprovimet Teknike Europiane (ETA).....</i>	29
2.1.1) <i>Hyrje.....</i>	29
2.1.2) <i>Standardet e produkteve.....</i>	29
2.1.2) <i>Aprovimet Teknike Europiane.....</i>	31
2.2) <i>Vlerësimi i konformitetit.....</i>	34
2.2.1) <i>Hyrje.....</i>	34
2.2.2) <i>Testim i tipit fillestar (ITT).....</i>	35
2.2.3) <i>Kontrolli i Prodhimit në Fabrikë (FPC).....</i>	36
2.3) <i>Çertifikimi i konformitetit.....</i>	37

2.3.1) Hyrje.....	37
2.3.2) Sistemet e çertifikimit të konformitetit.....	37
2.3.3) Përcaktimi i një sistemi të çertifikimit të konformitetit për një produkt specifik.....	39

SEKSIONI 3: Proceset mbështetëse të CPD.....43

3.1) Akreditimi.....	43
3.1.1) Të përgjithshme.....	43
3.1.2) Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	44
3.2) Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit.....	44
3.3) Mbikqyrja e Tregut.....	46
3.3.1) Hyrje.....	46
3.3.2) Aktivitetet e mbikqyrjes së tregut.....	47
3.3.3) Mbikqyrja e tregut dhe prodhuesit.....	48
3.3.4) Roli dhe përgjegjësia e prodhuesve.....	51
3.4) Standardizimi.....	51

SEKSIONI 4: CPD në praktike.....53

4.1) Përftimi i markës së konformitetit.....	53
4.2) Kuptimi i markës CE.....	65
4.3) Burimet e informacionit.....	68

SEKSIONI 5: Afatet për CPD dhe sektorin e ndërtimit në përgjithësi.....71

5.1) Nevojat e zhvillimit (CPD).....	71
5.2) Zhvillimi i sistemit rregullator të sektorit të ndërtimit (përveç CPD).....	75
5.3) Detyrimet dhe anagazhimi i palëve të interesuara.....	78
5.4) “Standardet mbështetëse”.....	81
5.4.1) Hyrje.....	81
5.4.2) Përformanca e energjisë, substancat e rrezikshme, produktet në kontakt me ujin, akustika, kosto e ciklit të jetës dhe standardet ambientale.....	81
5.4.3) Standardet e sistemeve të menaxhimit.....	83
5.4.4) Eurokodet Strukturale.....	84

“Autorët janë përpjekur të verifikojnë që informacioni i dhënë në këtë Dokument Udhëzues është i saktë dhe aktual, por nuk mund të garantojnë që informacioni, shërbimet apo elementet e tjerë të ketij dokumenti, duke përfshirë por pa u kufizuar me garancitë në lidhje me shfrytëzimit për qellime përfitimi apo përputhjes me një qëllim të vecantë. Informacioni i publikuar mund të përmbajë pasaktësi apo gabime tipografike. Informacioni dhe opinionët e përfshira në këtë Dokument Udhëzues, nuk përputhen domosdoshmërisht me ato të Komisionit Europian”

Seksioni 1

SEKSIONI 1: Prezantimi i CPD

1.1) Si ta lexojmë këtë Dokument Udhëzues

Ky Dokument udhëzues ofron të gjithë informacionin e nevojshëm, edhe pse në disa rastë në formë të shkurtuar, për të gjithë ata që janë të interesuar për ndërtimin dhe produktet e ndërtimit në Shqipëri; prodhuesit, autoritetet rregullatore të tregut, organizmat e vlerësimit të konformitetit (OVK) (përfshirë edhe laboratorët e testimit), projektuesit e ndërtesave, arkitektët, autoritetet e mbikqyrjes së tregut, studentet e fakultetit të ndërtimit, etj. Ai mbulon kryesisht mënyrën se si funksionon Direktiva e BE-se për Produktet e Ndërtimit (CPD), (cka është transpozuar pjesërisht në Shqipëri si Ligji 9290:2004), por mbulon gjithashtu edhe aktivitetet që kanë lidhje me të.

Ndërkohë që implementimi i CPD në vendet anëtare të Bashkimit Europian është tashmë në një stad të avancuar, është fakt që direktiva sapo ka filluar të zbatohet në Shqipëri dhe disa nga parimet dhe praktikat janë akoma për t'u finalizuar. Për këtë arsye nuk është e mundur të thuhet shumë rreth aplikimit të CPD në Shqipëri në këtë moment. Prandaj ky dokument udhëzues përshkruan kryesisht implementimin e direktives në vendet antare të BE-se, pavarësisht se parashikohet që edhe kushtet për garantimin e konformitetit në Shqipëri do të jenë të ngjashme me ato të BE-së. Aktualisht, për këtë arsye, ky Udhëzues duhet lexuar më shumë si “Çfarë do të ndodhë në Shqipëri brenda pak viteve” se çfare po ndodh konkretisht në këtë moment.

Për prodhuesit të cilët dëshirojnë të eksportojnë produktet e tyre në një vend anëtar të BE-se apo në çdo vend që njeh shenjën e konformitetit CE të BE-se, ekziston tashmë mundësia për ta bërë këtë gjë (edhe pse për shumë produkte mund të mos jetë akoma e praktikueshme). Për këtë arsye ky Udhëzues u shpjegon prodhuesve se çfarë u duhet të bëjnë, nëpërmjet shembujve praktike, nëse dëshirojnë të eksportojnë produktet e tyre.

Ky dokument përbën një udhëzues gjithëpërfshirës të gjithë aspekteve të CPD. Për këtë arsye ai nuk është parashikuar që të gjithë lexuesit të jenë njëloj të interesuar për të gjitha seksionët. Edhe pse leximi i të gjithë dokumentit u ofron lexuesve njohuri të plota në të gjitha aspektet, tabela e mëposhtme ofron një orientim për lexuesit në lidhje me seksionet për të cilat ata do kenë më shumë interes, dhe arsyen pse.

Palë e interesuar	Seksioni përkates	Arsyet
Prodhues, importues, magazinues, etj.	Seksioni 1, Seksioni 2, Seksioni 3, Seksioni 4, Seksioni 5.	Spjegon parimet e përgjithshme si dhe përfitimet e CPD. Sqaron se si funksionon direktiva. Përshkruan disa procese kyce për aplikim. Tregon shembuj praktike të përdorimit të markës CE Diskuton rreth nevojave dhe afateve të zhvillimit.
Rregullatoret, autoritetet e mbikqyrjes së tregut	Seksioni 1, Seksioni 3, Seksioni 5.	Si me sipër. Si me sipër. Diskuton rreth ceshtjeve të implementimit të rregulloreve
Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit	Seksioni 1, Seksioni 2.3, Seksionët 3.1 dhe 3.2.	Si me sipër. Fokuset tek detyrat e OVK. Përcakton rolet e OVK-ve dhe akreditimit.
Përgatitësit e specifikimeve teknike	Seksioni 1, Seksioni 2.1.	Si me sipër. Mbulon standardet dhe aprovimet teknike.
Përdoruesit e produkteve të ndërtimit	Seksioni 1, Seksioni 3.3, Seksioni 4.2, Seksioni 5.	Si me sipër. Mbikqyrja e tregut. Tregon shembuj të përdorimit të shenjës CE tek produktet. Si me sipër.

Së fundmi, CPD ofron dy rrugë për markën e konformitetit: standardet dhe aprovimet teknike. Standardet do të përdoren për shumicën e produkteve, dhe për këtë arsye ky Udhëzues është shkruar kryesisht në lidhje me to.

1.2) Ç'është Direktiva e Produkteve të Ndërtimit?

1.2.1) Bazat e direktivës

Direktiva e Produkteve të Ndërtimit (CPD) është një nga direktivat e Përafrimit të Ri të BE-se për produktet industriale: Kjo direktive ka dy qëllime:

- të ofrojë një mënyrë të vetme, në të gjithë Europën, nëpërmjet së cilës produktet e ndërtimit të mund të demonstrojnë që kanë nivele të caktuara performace, duke i dhënë mundësi përdoruesve të zgjedhin produktet e duhura në mënyrë që aktivitetet e ndërtimit të plotësojnë kërkesat rregullatore që aplikohen në vendin e përdorimit,
- të eliminojë pengesat teknike në tregti për produktet e ndërtimit, duke siguruar qarkullimin e lirë të tyre në vëndet të cilat e kanë adoptuar CPD, në bazë vetëm të një vleresimi të produkteve, dhe si rezultat, mbartjen e një simboli si shenjë konformiteti.

Me futjen e CPD në Shqipëri, performanca e produkteve do të demonstrohet nga përputhja me specifikimet teknike të harmonizuara (në shumicën e rasteve një standard i harmonizuar European i produktit i adoptuar në Shqipëri). Kjo nënkupton që produkti do t'i nënshtrohet një procedure të çertifikimit të konformitetit që përfshin një Testim të Tipit Fillestar të produktit dhe zbatimin nga prodhuesi të një sistemi të Kontrollit të Produktit në Fabrikë, me ndërhyrjen e mundshme në proces të një organizmi palë e tretë (këto janë spjeguar në mënyrë më të detajuar gjatë këtij Dokumenti Udhëzues).

Shumica e direktivave (siç janë Direktiva e Makinerive apo Direktiva e Pajisjeve me Voltazh të Ulët), përmbajnë Kërkesa Themelore (p.sh. kërkesa rregullatore që duhet të përmbushë produkti për t'u konsideruar "i sigurtë") të cilat aplikohen direkt tek produkti në fjalë. Për këtë arsye mund të thuhet, në rastin e një makinerie për shembull, se kërkesat rregullatore aplikohen direkt në makineri. Kur produkti mbart një markë konformiteti në kuadrin e njërës prej këtyre direktivave, pyetja e thjeshtë që bëhet është "A është i sigurtë ky produkt?" dhe marka e konformitetit jep përgjigjen "Po" (të paktë në kuadrin e kushteve të caktuara të instalimit dhe/ose përdorimit). Sistemi rregullator për aktivitetet e ndërtimit si dhe produktet e ndërtimit nuk funksionon pikërisht në këtë mënyrë për të kuptuar se si funksionon CPD-ja, është e rëndësishme të kuptohet sistemi i përgjithshëm rregullator për ndërtimin dhe produktet e ndërtimit.

Të gjitha vendet Europiane, përsa i përket ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, nuk rregullojnë direkt produktin e ndërtimit. Përkundrazi, ato rregullojnë punën e plotë të ndërtimit (për shembull një ndërtesë apo një rrugë). Ato e ushtrojnë

ketë gjë nëpërmjet gjashtë Kërkesave Themelore të cilat janë:

- Rezistenca mekanike dhe stabiliteti,
- Siguria në rast zjarri,
- Higjena, shëndeti dhe ambienti,
- Siguria në përdorim,
- Mbrojtja ndaj zhurmave,
- Ekonomia e energjise dhe mbajtja e nxehtësisë.

Këto gjashtë Kërkesa Themelore (ER) janë zgjeruar në formën e CPD dhe lidhja ndërmjet ER dhe karakteristikave Themelore të produkteve është bërë në gjashtë Dokumentë Interpretuese, nga një për secilën ER. Duke marrë si shembull sigurinë ndaj zjarrit, direktiva kërkon që punimet e ndërtimit duhen projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që në rast zjarri:

- Aftësia peshëmbajtëse e konstruksionit parashikohet për një periudhë specifike kohe,
- Gjenerimi dhe shpërndarja e zjarrit dhe tymit në kuadrin e punimeve, të jenë të kufizuara,
- Përhapja e zjarrit tek ndërtimet ngjitur të jetë e kufizuar,
- Banoret të kenë mundësi t'i lenë vetë ambientet apo të shpëtohen me mjetë të tjera,
- Të merret parasysh gjithashtu edhe siguria e grupeve të ndërtimit.

Kërkesa e parë, e treta (pjesërisht) dhe ajo e pesta, kanë të bëjnë me karakteristikën “Rezistence ndaj zjarrit” (dmth mënyrën se si do silllet produkti në rastin e një zjarri të zhvilluar plotësisht) për produkte sic janë trarët, ndarjet dhe dyert e daljes nga zjarri. Kërkesa e dytë dhe e katërt kanë të bëjnë me karakteristikën “Reagimi ndaj zjarrit” (dmth nëse një produkt digjet apo jo dhe nëse po, deri në c’shkalë); kërkesa e dytë dhe e tretë kanë të bëjnë me karakteristikën “Përformanca e çative ndaj zjarreve të jashtme” dhe, së fundmi të gjitha së bashku kanë lidhje me kërkesat e përformances për detektimin e zjarrit, alarmin ndaj zjarrit si dhe/ose produktet për kontrollin e zjarrit dhe tymit.

CPD-ja nuk synon që të harmonizojë Kërkesat Themelore të vendeve të ndryshme; kjo gjë si dhe fakti se deri në c’ nivel shkon ky rregullim, i janë lënë në dorë vetë vendeve nëpërmjet rregulloreve Kombëtare të Ndërtimit (apo ekuivalentë të tyre). Kjo sidomos në rastet kur ‘diferencat në kushtet gjeografike apo klimaterike, të mënyrës së jetesës si dhe nivelet e ndryshme të mbrojtjes që mund të mbizotërojnë në nivel kombëtar, rajonal apo lokal’, bëjnë që shtetet anëtare të kenë rregullore të ndryshme. Për ta ilustruar këtë parim me disa shembuj, vende me kushte shumë të ftohta dimri mund të kenë kërkesa që mbështjellja e jashtme e një ndërtese të lejojë humbjen e me pak nxehtësie në krahasim me një vend ku dimri është më pak i fortë; vende me një klimë të lagësht mund të kenë rregullore për

rezistencen e punimeve ndaj lagështirës dhe hidro-izolimit, ndërkohë që vende me klimë të thatë mund të mos e kenë fare këtë rregullore. Së fundi në lidhje me reagimin ndaj zjarrit, sistemi i Europian i klasifikimit përcakton shtatë klasa performace (ku A1 është me e larta dhe F me e ulta); një vend i caktuar mund të ketë kërkesa që produktet e përdorura nëpër ndërtesa të jenë të paktën të klasit E, ndërkohë që një vend tjetër të ketë kërkesa që produktet të jenë të paktën të Klasit B, ndërkohë që një vend tjetër mund të mos ketë fare kërkesa për reagimin ndaj zjarrit. Të gjitha këto situata të ndryshme të mundshme rregullatore kanë një ndikim direkt tek karakteristikat e një produkti të cilat duhet të deklarohen një prodhues, i cili dëshiron ta shesë këtë produkt në atë vend dhe/ose për një qëllim të caktuar të vecantë, dhe deri në një fare mënyrë se çfare niveli apo klase performace duhet të ketë produkti.

Si rrjedhojë CPD-ja nuk i përgjigjet dhe nuk mundet t'i përgjigjet pyetjes “A është i sigurtë produkti i ndërtimit?” sepse përgjigja e kësaj pyetje varet nga sistemi rregullator për aplikimin e përdorimit final si dhe vendin specifik ku ky produkt do të përdoret. Për shembull, ekzistojnë shumë lloje tullash me qëllime të ndryshme përdorimi dhe me karakteristika dhe nivele të ndryshme performace. Një lloj i caktuar tulle është i përshtatshëm për qëllimin e tij të përdorimit por mund të mos jetë i përshtatshëm për një qëllim tjetër përdorimi. Një tip tulle jo struktural (si psh në rastin e tullave që nuk destinohen për mbajtje peshe) mund të mos jetë e përshtatshme për përdorim në një mur mbajtës, një tullë dekorative e përcaktuar që të punojë në kushte relativisht të thata mund të mos jetë e përshtatshme nëse ekspozohet në ambient të jashtëm të lagësht apo kur kemi cikle të shpeshta ngrirje-shkrirje. Përdoruesi mund të mos e deklarohet direkt qëllimin e përdorimit të produktit; ai mund ta lërë këtë të kuptohet nga karakteristikat që ai dëshiron të deklarohet si dhe nivelit të performances së produktit të tij kundrejt këtyre karakteristikave.

Për këto arsye është më e lehtë të konsiderohet që CPD-ja kërkon nga prodhuesit të vendosin përdorimin final të produktit dhe prej kësaj të vendosin se çfare karakteristikash të vleresojnë dhe deklarojnë. Marka e konformitetit të këtij produkti, mund të konsiderohet si ‘garanci’ që produkti ka performancën e deklaruar, por fakti nëse ky produkt specifik është apo jo i përshtatshëm për një punim të caktuar ndërtimi, i lihet blerësit, përdoruesit apo specifikuesit të produktit (mënyra se si prodhuesi vendos se çfarë karakteristikash të deklarohet është spjeguar në pikën 4.1 tek vendosja e markës së konformitetit).

CPD funksionon nëpërmjet katër elementeve kryesore:

- Një sistem specifikimesh teknike të harmonizuara (kryesisht Standarde Europiane),
- Një sistem për të cilin është rënë dakord, për certifikimin e konformitetit të cdo produkti,

- Një kuadër i organizmave të notifikuar/autorizuar,
- Përdorimi i markës CE tek produktet.

Secili prej këtyre elementeve është diskutuar në mënyrë më të detajuar në seksionet e ardhshme të këtij Dokumenti Udhëzues.

1.2.2) Avantazhet e CPD

Pengesat teknike në tregti (sic janë standardet e detyrueshme kombëtare dhe nevoja për testim dhe mundësisht për çertifikim të produkteve në të gjitha vendet ku ato shiten), janë të dëmshme për të gjitha palët. Mënjanimi i tyre, si rrjedhojë, do ta lejonte tregun Shqiptar të produkteve të ndërtimit të përfitonte dhe do të hapë mundësitë për produktet Shqiptare që të qarkullojnë më lirshëm nëpër vendet e tjera.

Ekzistenca e një grupi specifikimesh teknike dhe sisteme të çertifikimit të konformitetit për të cilat është rënë dakord, të njëjtë nëpër të gjitha vendet, sjell avantazhe të shumta. Kjo nënkupton që produktet duhen vlerësuar dhe çertifikuar vetëm një herë, në çfarëdo vendi, në mënyrë që të mund të hidhen në tregjet e të gjitha vendeve të tjera. Përputhja me specifikimet teknike të harmonizuara mund ta përmiresojë cilësinë e disa produkteve Shqiptare, dhe Kontrolli i Prodhimit në Fabrikë sikurse kërkohet prej CPD-se mund të ndihmojë që të reduktojë humbjet dhe të rrisë cilësinë. Përveç kësaj në shumë raste, Standardet Europiane përcaktojnë ‘nivele baze’ performance, nën të cilat produktet nuk lejohen të hyjnë në treg. Kjo do të ndihmonte heqjen e produkteve “të pasigurta” nga tregu Shqiptar dhe do të eliminonte dukuri si “dumping-u” (futja në treg e produkteve me cmim dhe cilësi të ulët) i produkteve të pakënaqëshme. Së fundmi, krijimi i një sistemi të mbikqyrjes së tregut, ashtu sic kërkohet prej CPD, do të ndihmonte garantimin që në tregun Shqiptar të hynin vetëm produkte me konformitet. Të marra së bashku, këto përfitime do të bënin të mundur që produktet Shqiptare të fillonin të ishin konkurese në cilësi dhe jo vetëm në kosto, kjo mund të shoqërohej me zëvendësime të produkteve të importit si dhe mund të krijojnë hapje tregjesh eksportimi. Përveç kesaj, ato mund të ndihmojnë edhe në përmirësimin e mbrojtjes së konsumatorit.

Një shqetësim që lidhet me zbatimin e CPD-se është kosto e shtuar që ka të bëjë me nevojën për testim të produkteve, për arsye të koston së përdorimit të Organizmave të jashtëm të Autorizuar (çka spjegohet më vonë në kv të Udhëzues) si dhe për shkak të nevojës së prodhuesve që të zbatojnë një sistem kontrolli të prodhimit në fabrikë (FPC). Gjithësesi, dëshmi nga prodhuesit e Bashkimit Europian, tregojnë se këto kosto nuk janë edhe aq të larta dhe kompensohen lehtësisht nga përfitimet që sjellin. Kjo gjë është veçanërisht e vërtetë në rastin e produkteve që eksportohen.

Ndërkohe që është e vërtetë që produktet duhet të testohen një herë që të demonstronjë përputhjen me Standardet Europiane, kosto e këtij operacioni është e ulët nëse do konsiderohej e shtrirë për gjatë procesit të prodhimit dhe mund të ketë përfitime në lidhje me rezultatet e testimit që përdoret për të siguruar që produktet kanë, ose mund të zhvillohen që të kenë, nivele të njëjta performace me produkte të tjera të tregjeve Europiane. E njëjta gjë është e vërtetë për sistemet FPC; vërtet ka kosto të cilat lidhen me krijimin e sistemeve të tilla, por këto kosto duhet të kompensohen lehtësisht nga përfitimet që rrjedhin prej tyre.

Si përmbledhje, CPD-ja as nuk ndryshon dhe as nuk i shton gjë sistemit rregullator në Shqipëri për produktet e ndërtimit; ajo vetëm vë në dispozicion një mundësi, të harmonizuar në të gjithë Europën, nëpërmjet se cilës produktet shqiptare të mund të demonstronjë që përputhen me kërkesat rregullatore të vendosura mbi to. E gjithë eksperiencia nga vendet e BE-se tregon atë që përfitimet nga zbatimi i një sistemi rregullator që bazohet tek CPD-ja, për sa i përket përmirësimit të cilësisë së produkteve Shqiptare, heqjes nga tregu Shqiptar të produkteve të pakënaqshme (duke eliminuar në këtë mënyrë “hedhjen” në tregun Shqiptar të produkteve me standard të ulët), hapja për tregjet e eksportit për disa produkte dhe mundësia që produktet të konkurojnë nëpërmjet cilësisë dhe jo vetëm çmimit, i kompensohen lehtësisht kostot afat-shkurtër shtesë.

1.3) Çfarë mbulon CPD

1.3.1) Situatë në gjirin e BE-së

Neni 1.2 i CPD jep përcaktimin e një “produkti ndërtimi” si “cdo produkt i cili prodhohet për t’ju bashkëngjitur në mënyrë të përhershme një punimi ndërtimi, duke përfshirë këtu si ndërtimet ashtu edhe punimet e inxhinierise civile”. Neni 1.1 tregon gjithashtu se CPD aplikohet tek ato produkte tek të cilat veprojnë Kërkesat Themelore (shiko piken 1,2 me lart). Kjo e fundit nënkupton që CPD aplikohet vetëm tek ato produkte të cilat janë objekt i një apo me tepër kërkesa rregullatore në të paktën një nga Vendet Anëtare.

Gjithësesi këto dy përcaktime, kërkojnë një sqarim të mëtejshëm me qëllim që të kuptohet plotësisht pse disa produkte janë përfshirë në kuadrin e CPD dhe disa të tjera jo. Pika e parë që ka nevojë për plotësim është ‘në mënyrë të vazhdueshme’. Ekzistojnë shumë produkte të cilat nuk janë të bashkëngjitura në mënyrë të vazhdueshme me punimet e ndërtimit, në atë kuptim që nëse ndryshohen punimet, këto produkte mund të zëvendësohen apo të eliminohen fare (një dritare mund të eliminohet dhe të mbyllet me mur, një çati pa tjegulla mund të zëvendësohet me një çati me tjegulla, një mur mund të shembet për

të lejuar që dy dhoma të bashkëngjiten dhe letra e mureve mund të ndërrohet në intervale të shkurtra kohe). Përcaktimi “në mënyrë të vazhdueshme” do të kuptohej më mirë në thelb se nëse një produkt është i pranishëm në punime, ai ka një rol për të luajtur për të përmbushur një apo me shumë Kërkesa Themelore.

Po kështu, ekzistojnë disa produkte të cilat janë të bashkëngjitur po në mënyrë të përhershme ashtu si në shembujt e dhënë më lart por ato nuk mbulohen nga CPD: impiante industriale, ndriçimet dhe pajisjet e tjera elektrike, pajisjet që përbëjnë kuzhinën, kaldajat qendrore për ngrohje që përdorin gaz si dhe boja për lyerje. Ekzistojnë shembuj të shumtë pse, edhe pse ato përputhen me përcaktimet për të qenë produkte ndërtimi, ato nuk konsiderohen si të tilla (ose, të paktën aktualisht nuk konsiderohen të tilla) për të qenë në kuadrin e CPD, për shembull:

- “kërkesat rregullore” konsiderohen të jenë “rregullore ndërtimi” dhe jo rregullore të tjera. Impiantet industriale dhe pajisjet elektrike mbulohen me shpesh nga kërkesa rregullore se sa nga rregullore ndërtimi, ,
- “në mënyrë të vazhdueshme” (përvec kushteve të sipërpërmendura) ka të bëjë me vetë aftësinë e punimeve të ndërtimit për të plotësuar rregulloret e ndërtimit. Shumica, për të gjitha impiantet industrial të mos mund të hiqen nga një ndërtese dhe të zëvendësohen prej të tjerave por kjo nuk duhet të ketë asnjë efekt lidhur me faktin nëse vetë ndërtesa vazhdon t’i përmbushë kërkesat e rregulloreve rreth saj,
- Produktet janë të mbuluara, zakonisht në mënyrë më specifike, nga direktiva të tjera, për shembull Ashensoret, Pajisjet që përdorin gaz dhe Direktiva e Pajisjeve me Voltazh të Ulët.

Pavarësisht se është e dobishme që të kuptohen këto parime (veçanërisht në rastin kur një prodhues kërkon markën CE por nuk është në gjendje ta përfitojë atë), në fund të fundit ekzistojnë vetëm tre “teste” nëpërmjet të cilave një produkt mund të fitojë markën CE sipas CPD-së:

- A ekziston një Standard i harmonizuar European që e mbulon produktin?
- A ekziston një Udhëzues për Aprovimin Teknik European që e mbulon këtë produkt nga e cila të mund të përgatitet një Aprovim Teknik European (ETA)?
- A dëshiron prodhuesi të aplikojë një ETA individuale dhe a është ky aplikim i pranuar nga një organizëm që lëshon aprovime?


Nëse përgjigja për të gjitha këto pyetje është “Jo”, atëherë produkti në fjalë nuk mundet (të paktën aktualisht) të konsiderohet si “produkt ndërtimi” brenda

përcaktimeve të CPD dhe si rrjedhojë nuk mundet që, në kuadrin e CPD-se, të përfitoje marken CE. Nëse ekziston një Standard European i harmonizuar i cili aplikohet përproduktin, atëherë shumica e Vendeve Anëtare të BE-se e kërkojnë me ligj që produktet të përputhen me këtë standard dhe që prodhuesi të përdorë markën CE. Megjithatë, përdorimi i ETA-ve në kuadrin e BE-se, mbetet vullnetar.

Eshtë e qartë se ndoshta këshilla më e mirë për prodhuesit do të ishte që nëse kanë si mundësinë ashtu edhe dëshiren që të aplikojnë markën CE, atëherë nuk do të ketë pasiguri në lidhje me të drejtën e tyre për t'i hedhur produktet e tyre në tregun e Bashkimit European. Marka CE duhet të njihet gjithashtu edhe në tregun Shqiptar, pavarësisht se mbase është më mirë dhe me praktike që, për produkte të shitura vetëm në Shqipëri, prodhuesit të kërkojnë markën Shqiptare të konformitetit (shih më poshtë).

la vlen të përmendet edhe një pikë e fundit. Ka njerëz që besojnë që CPD-ja aplikohet vetëm për ato produkte të realizuara në një vend dhe të eksportuara në një tjetër Vend Anëtar (çka do të përfshinte edhe produktet e prodhuara jashtë BE-se dhe të importuara). Kjo nuk është e vërtetë. Si CPD-ja ashtu edhe kërkesat për markën CE aplikohen për produkte të përgatitura dhe të shitura në të njëjtin vend, që do të thotë që të gjitha vendet që e kanë të detyrueshme markën CE, është gjithashtu e detyrueshme për prodhuesit nga ai vend kur i shesin produktet e tyre në vendin e tyre.

Skema e mëposhtme tregon në një mënyrë më të thjeshtuar, procedurë për të përcaktuar nëse një produkt mbulohet nga fusha e veprimtarisë së CPD, dhe nëse po, hapat që duhet të ndjekë prodhuesi.



1.3.2) Situata në Shqipëri

Ligji Shqiptar për produktet e ndërtimit (CPL bazuar pjesërisht tek CPD) lejon një numër mundësish për një prodhues që të demonstrojë që produkti i tij është i përshtatshëm që të hidhet në tregun Shqiptar: që plotëson kërkesat e një standardi Shqiptar të harmonizuar që është një transpozim i Standardit ekuivalent European të harmonizuar, që përputhet me një standard Shqiptar (të pa-harmonizuar) të publikuar nga DPS, që përmbush kriteret e rregulloreve teknike Shqiptare apo që ka përfutur një aprovim teknik Shqiptar.

Në përputhje me Nenin 10 të Ligjit Shqiptar të produkteve të ndërtimit, nuk duket që përdorimi i markes se konformitetit të jetë i detyrueshëm, por nëse prodhuesi dëshiron ta përdorë atë, do t'i duhet të veprojë në përputhje me sistemin dhe procedurën e përcaktuar të certifikimit të konformitetit (shih gjithashtu 2.3).

Nëse një prodhues Shqiptar dëshiron t'i eksportojë produktet e tij në cilindo Vend Anëtar të Bashkimit European, atij do t'i duhet të zbatojë ekzaktësisht procedurën (e përshkruar në Seksioni 4 të këtij Dokumenti Udhëzues) e nevojshme për të përfutur markën e konformitetit CE. Nëse ekziston një marrëeshje njohjeje reciproke ndërmejt Shqipërisë dhe BE-se, kjo do të thotë që prodhuesi Shqiptar duhet të garantojë që produkti i tij plotëson kërkesat e standardit European të harmonizuar përkatës apo të përfutur një Aprovim Teknik European, dhe që ai aplikon sistemin e duhur të vlerësimit të konformitetit i cili, nëse kjo kërkon përfshirjen e një organizmi të notifikuar, do të thotë që prodhuesi duhet të përdorë një organizëm të notifikuar brenda BE-së.

1.4) Përgjegjësitë dhe pritshmëritë

1.4.1) Përgjegjësitë

Mund të thuhet pa dyshim që ekzistojnë pesë “aktorë” kryesore që përfshihen në zbatimin e CPD. Ata mund të listohen si më poshtë:

- vendet antare/autoritetet e mbikqyrjes se tregut,
- operatorët ekonomike: prodhuesit, tregtarët, agjentët, importuesit, shpërndarësit, magazinuesit, etj.
- organizmat e notifikuar dhe organizmat e tjera të konformitetit (CABs),
- përgatitësit e specifikimeve teknike,
- blesit/përdoruesit/specifikuesit e produkteve.

Shumë nga përgjegjësitë e këtyre aktoreve janë përshkruar përgjatë këtij Dokumenti Udhëzues, por tabela e mëposhtme tregon, në një mënyrë të thjeshtuar, përgjegjësitë dhe veprimet e secilit prej tyre.

Tabela 1.1 - Përgjegjësitë dhe veprimet e aktoreve të CPD

Aktorët	Përgjegjësitë	Veprimet	Shënime
<p>Vendet Anëtare</p> <p>Autoritet e mbikqyrjes së tregut</p>	<p>Rregullore kombëtare për punimet e ndërtimit</p> <p>Implementimi i CPD</p> <p>Zbatimi (nëpërmjet mbikqyrjes së tregut)</p> <p>Heqja e pengesave teknike në tregti</p> <p>Kontrolli i produkteve në treg</p> <p>Vënia në zbatim</p>	<p>Përgatit rregulloret, përcakton kufizimet, rishikon dhe miremban</p> <p>Transpozon CPD në nivel kombëtar</p> <p>Shih me poshte</p> <p>Jep prezumimin e konformitetit për produktet që mbartin marken CE</p> <p>Kontrollon marken CE dhe deklaratën, ndoshta edhe teston produktin</p>	<p>CPD nuk i ndryshon rregulloret e Vendeve Anëtare</p> <p>Applikohet vetëm pasi produktet janë hedhur në treg</p>
<p>Operatorët ekonomike</p>	<p>Konformiteti i produkteve</p> <p>Marka e konformitetit</p>	<p>Vlerësimi i konformitetit me specifikimet teknike duke përfshirë ITT dhe FPC</p>	<p>Shih me poshtë për sqarime</p>

Organizmat e notifikuar Organizma të tjerë të vleresimit të konformitetit (CAB)	Certifikimi i konformitetit Vleresimi i konformitetit	Testimi, inspektimi, certifikimi në varesi të sistemit të Certifikimit të Konformitetit Testim apo inspektim në emer të prodhuesit apo të CAB të tjera	Përgjegjesia për konformitetin mbetet tek prodhuesi Prodhuesi mund të përdorë laboratore pale të treta
Përgatitësit e specifikimeve teknike (CEN, EOTA)	Prodhimi/ mirembajtja e EN, hEN, ETAG dhe ETA	Draftim (nga ekspërtë të jashtëm), aprovim dhe shpërndarje tek Organizmat Kombëtare të Standardizimit.	Specifikimet që krijojnë konflikte duhet hequr
Përdoruesit e produkteve	Përzgjedhja e duhur e produkteve, instalimi, etj.	Duhet të kuptojnë informacionin në lidhje me marken CE	Prodhuesi nuk mban përgjegjesi për përzgjedhje apo instalim të gabuar të produkteve

Marka CE apo markimi Shqiptar i konformitetit, do të nënkuptojnë që vëndet duhet të prezumojnë që produktet i kanë parametrat e deklaruar të performances dhe si rrjedhojë, nuk duhet t'u refuzojnë atyre aksesin nëpër tregjet e tyre kombëtare. Megjithatë, CPD-ja nuk kërkon të ndryshojë apo të përcaktojë kërkesat kombëtare rregullore për punimet e ndërtimit; këto do të mbeten përgjegjësi e vendeve të vecanta. Për këtë arsye nuk mund të mendohet që të gjitha produktet që kanë marke konformiteti të mund të përdoren në cdo lloj punimi ndërtimi; punimet duhen projektuar në mënyrë korrekte dhe produktet duhet të seleksionohen në mënyrën e duhur dhe mundësisht të kombinuara ashtu sic duhet me produktet e tjera, për të siguruar për mbushjen e kërkesave rregullore për ato punime.

Përgjegjësitë e operatorëve ekonomike varen nga pozicioni i tyre në zinxhirin e shpërndarjes, dhe CPD-ja aplikohet vetëm tek disa operatorë. Kushti për të plotësuar kërkesat e direktivës dhe si rrjedhojë të vendosin markën CE apo markën Shqiptare në produkt, vlen vetëm për ata persona emri i të cilëve shfaqet në produkt. Në shumicën e rasteve ky person do të jetë vetë prodhuesi i produktit, por ai mundet gjithashtu që të punësojë (edhe pse nuk është i detyruar) një agjent të vendosur në BE të ndërmarrë disa veprime në lidhje me konformitetin (p.sh. të realizojë teste) duke mbajtur ndërkohe përgjegjësinë për markimin. Gjithësesi, nëse një person e blen një produkt nga një prodhues dhe e shet atë

nën emrin e tij, vetë ky person mban përgjegjësi për markën e konformitetit. Ai mund ta realizojë përgjegjesinë e tij në mënyra të ndryshme, ose nëpërmjet një kontratë me prodhuesin për performancën e FPC, ose duke kryer vetë detyrime (p.sh. testimet e produktit).

Persona të tjerë në zinxhirin e shpërndarjes (magazinues, shpërndares, etj) nuk kanë asnjë përgjegjësi në kuadrin e CPD përderisa ata nuk e tjetërsojnë produktin në çfarëdo mënyre (ri-magazinimi nuk do të konsiderohet si tjetërsim). Por ata mund të kenë përgjegjësi në kuadrin e legjislacionit të Bashkimit Europian për të garantuar që informacioni teknik është përcjellë së bashku me produktin nëpër zinxhirin e shpërndarjes, dhe për shmangur shitjen e produkteve të pasigurta.

Aty ku sistemi i çertifikimit të konformitetit i përcaktuar në specifikimet teknike, kërkon ndërhyrjen e një organizmi të njohur dhe Kompetent (të notifikuar në BE dhe autorizuar në Shqipëri), prodhuesi mund ta përzgjedhë dhe përdorë këtë organizëm. Atëherë kur testimi është përgjegjësi e prodhuesit ai mund të përdorë ambientet e tij testuese nëse i ka këto (për testimet ITT dhe FPC), ose mund të përdorë laboratorë testimi si palë e tretë i cili nuk ka nevojë të notifikohet apo autorizohet.

Prodhuesi është gjithmonë përgjegjës për deklaratat e lëshuara për qëllimin final të përdorimit, performancën apo karakteristikat e tjera të produkteve të tij, edhe në rastin e përfshirjes së një organizmi të notifikuar. Gjithësesi, prodhuesi nuk mund të konsiderohet përgjegjës nëse blerësi e zgjedh produktin e gabuar apo e përdor atë në mënyrë të ndryshme nga ajo që ka specifikuar prodhuesi.

1.4.2) Pritshmëritë

Në këtë seksion të shkurtër të pritshmërive, është e nevojshme të diskutohet vetëm për pritshmëritë dhe konsekuencat tek prodhuesit të implementimit të CPD-së në Shqipëri. Çdo prodhues që nuk bën përpjekje” dhe ndërmerr procedura për përftimin e markës CE, ka të drejtë të presë që produkti i tij të pranohet në të gjitha ato Vende Anëtare ku ky produkt është eksportuar, apo që të pranohet në çdo vend tjetër i cili e ka implementuar direktivën në mënyrë të tillë që ta pranojë markën CE. Megjithatë, panvarësisht se markimi përbën “pasaportën” për eksportimin e produkteve, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë të cilët duhen marrë në konsideratë nga prodhuesi përpara se të marrë vendimin për të eksportuar. Kjo përfshin koston e transportit të produktit deri në këto vende, kosto e produktit të eksportuar kundrejt kostonë së produkteve të ngjashme vendase, nëse produkti ekziston ndërkohe në sasira të mëdha në vendin që po importon, si dhe raportin e kostonë në raport me nivelin e performancës.

Ata prodhues të cilët prodhojnë dhe shesin vetëm në Shqipëri, kanë të drejtë të presin që mbikqyrja e tregut do të sigurojë që produkte të pasigurta, pa konformitet apo të markuara jo në mënyrën e duhur, të terhiqen nga tregu, çka do

t'i mbronte ata nga konkurenca e pandershme e produkteve me standard të ulët (megjithëse, ashtu sic spjegohet në 3.3 të këtij Dokumenti Udhëzues, prodhuesit Shqiptarë mund të luajnë një rol aktiv në sistemin e mbikqyrjes së tregut). Kundër kësaj do të jetë fakti që, si pasojë e adoptimit dhe implementimit të CPD-se, tregu Shqiptar do të hapet për produkte të importuara me markën CE. Për këtë arsye është e rëndësishme, që prodhuesit vendas të jenë të përgatitur për këtë konkurrence duke siguruar që ata të punojnë, derisa të jetë praktike për ta, në nivelet Europiane me qëllim që të jenë në gjendje që të konkurojnë si në cilësi ashtu edhe në çmim me këto produkte importi.

Ata prodhues Shqiptarë që zgjedhin të përdorin markën Shqiptare të konformitetit mundet që të zbulojnë që, pasi kjo markë të jetë bërë e njohur dhe e pranuar gjerësisht, kjo markë t'u japë atyre një avantazh marketingu kundrejt konkuresve të cilët nuk e përdorin këtë markë, të paktën deri atëherë kur kjo markë të jetë bërë e detyrueshme për të gjithë prodhuesit. Gjithësesi, ndërkohe që markimi i konformitetit mbetet opsional, sic është aktualisht edhe rasti i Shqipërisë, çdo vendim për ta aplikuar dhe përdorur markën e konformitetit duhet të jetë një vendim si komercial ashtu edhe praktik. Për shembull, nuk ka kuptim që prodhuesit Shqiptarë të kërkojnë markën e konformitetit nëse organizmat e nevojshme të autorizuar nuk ekzistojnë akoma në Shqipëri. Përveç kësaj, prodhuesit duhet të gjykojnë edhe rreth kostos së mundshme që do të sillte vlerësimi i produkteve të tyre, kundrejt përfitimit të mundshëm në treg që do vintë si pasojë e marrjes së markës së konformitetit.

1.5) Kuadri ligjor në Shqipëri duke përfshirë edhe përcaktimet e tjera ligjore përkatëse

Aksesi i lirë i produkteve nëpër tregje po zhvillohet aktualisht në të gjithë sektorët e produkteve në të gjithë botën si në fushën konsumatore ashtu edhe në fushën industriale. Përputhja me kërkesat e detyrueshme të sigurisë përbën një detyrim ligjor dhe në të gjitha rastet operatorë ekonomike duhet të venë në dispozicion prova të kesaj përputhjeje. Gjatë gjithë jetëgjatësisë së një produkti, përputhja me kërkesat e detyrueshme mund të kërkojnë në:

- Etapën e projektimit/prodhimit (i ashtuquajtur i vlerësim konformiteti para-tregut),
- Etapën pas-hedhjes së produktit në treg (apo mbikqyrja e tregut).

Në shumicën e politike-bërjeve bashkëkohore, vërehet një tendence e qartë në drejtimin e pare etapes së (para-tregut), ku përgjegjesitë bien gjithnjë e më tepër tek prodhuesit. Me këtë ndryshim tendence, vërehet një kalim nga “autorizimi” i para-tregut për produktet (veçanërisht kur kjo realizohet nga shteti), dhe ndërkohë që marka e konformitetit jep ‘prezumimin e konformitetit’, mbikqyrja

e tregut kufizohet kryesisht me ato produkte që janë të njohura apo të dyshuara si jo konform. Këto ndryshime janë në të ardhmen kryesisht për qëllime kostojë (p.sh kosto e çertifikatës para-tregut lëshuar nga shteti mund të jetë e lartë) por edhe për arsye kohe (prodhuesi dëshiron ta nxjerrë produktin në treg sa më shpejt por procedurat e aprovimit nga shteti e pengonin këtë gjë). Për këtë arsye, mbikqyrja e tregut, po konsiderohet gjithnjë e më tepër si thelbësore për ato produkte, dhe kufizohet në këtë, të cilat pavaresisht nga sistemi i vlerësimit të konformitetit para-tregut, janë akoma të pasigurtë dhe pa konformitet kur arrijnë në treg. Shqipëria e ka përmirësuar gjithnjë e më tepër legjislacionin e saj kundrejt këtij modeli, duke përdorur shpesh si baze, direktivat e BE-se bazuar tek “Përafrimi i Ri”, i cili është treguar në mënyrë të thjeshtëzuar në Figurën 1.1 Në kuadrin e BE ”Përafrimi i Ri” po zëvendësohet në mënyrë progresive nga “Kudri i Ri Legjislativ” (NLF) dhe vetë CPD e Bashkimit Europian është në procesin e harmonizimit me parimet e NLF, pavaresisht se keto nuk e ndryshojnë bazën thelbësore mbi të cilin produktet hidhen në treg.

Në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Associmit, dhe në vecanti në lidhje me intensifikimin e mundësive për tregti dhe investime në Shqipëri, adoptimi i rregulloreve të tregut dhe standardeve të Bashkimit Europian, kanë fituar nja fokus mjaft të lart në axhendën politike të vendit. Shqipëria po harmonizon legjislacionin e saj teknik bazuar në principet e kuadrit legjislativ përproduktet të Bashkimit Europian.

Baza e përgjithshme ligjore për konformitetin e produktit në Shqipëri është Ligji “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve, kerkesat themelore dhe vlerësimi i konformitetit për produktet jo-ushqimore” (N° 9779, date 16.07.2007). Ky ligj konsiderohet i harmonizuar me EU *acquis* dhe transpozon plotësisht GPSD (Direktiva e Përgjithshme e Sigurisë së Produkteve) dhe elementet e përbashkët të Përafrimit të Ri dhe Global, duke shërbyer njëkohësisht edhe si bazë ligjore për transpozimin e Direktivave të Përafrimit të Ri (NAD). Ky ligj përcakton edhe prezumimin e konformitetit bazuar tek standardet e harmonizuara. Sa herë që aprovohet një Vendim i Këshillit të Ministrave (CMD) si transpozim i NAD, bashkëngjitur me të publikohet edhe lista e standardeve të harmonizuara Shqiptare, ndërkohe që standardet që kanë konflikt me rregulloret teknike terhiqen nga qarkullimi.

Për sa i takon produkteve të ndërtimit, kuadri ligjor ka qenë adoptuar se legjislacion sektorial përpara hyrjes në fuqi të Ligjit No. 9779 dhe nuk është plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e BE-se. Inspektoriati Kombëtar i Ndërtimit dhe Planifikimit Urban është i ngarkuar me mbikqyrjen e tregut për produktet e ndërtimit në përputhje me ligjin “Për inspektoriatin e ndërtimit” (N° 9780 datë 16.07.2007). Nxjerrja në treg e produkteve të ndërtimit, është e rregulluar nga ligji “Për materialet e ndërtimit” (N° 9290, datë 07.10.2004) si dhe dy Vendime të Këshillit të Ministrave (CMD):

- “Për procedurat e kontrollit në fabrika dhe qendrat e shpërndarjes për marrjen e çertifikatës së vlerësimit të konformitetit për çimenton, për të cilën rezistenca dhe stabiliteti përbëjnë një rëndësi të dorës së parë” (N° 58 datë 01.02.2006),
- “Për aprovimin e listës së produkteve të ndërtimit të cilat duhet të sigurojnë vlerësimin e konformitetit” (N° 279, datë 18.04.2007).

Ky vendim i fundit i Këshillit të Ministrave i referohet 142 standardeve që kanë të bëjnë me produktet e ndërtimit dhe detyron të gjithë personat fizike apo juridike, Shqiptare apo të huaj, të cilët prodhojnë apo tregtojnë produkte ndërtimi, që në mënyrë të detyrueshme të sigurojnë vlerësimin e konformitetit përpara hedhjes së produktit në treg.

Ligji horizontal N° 9779 ngarkon Këshillin e Ministrave me nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse dhe rregulloreve teknike për produkte të ndryshme ashtu siç klasifikohen në aneksin që i bashkëngjitet ligjit. Për kërkesat themelore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit, institucioni përgjegjës është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Për këtë arsye Ligji “Për produktet e ndërtimit” (N° 9290) u amendua nga Ligji N° 9825, datë 1.11.2007, kryesisht për të harmonizuar procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe për të prezantuar njohjen e deklaratave dhe aprovimeve të sistemeve të huaja për produktet e ndërtimit së bashku me të gjitha produktet e tjera jo-ushqimore.

Me qëllim për të siguruar shkallën më të lartë të harmonizimit me legjislacionin Europian, Ligji horizontal No. 9779 kërkon shndërrimin e legjislacionit teknik sektorial si dhe akteve nënligjore që kanë lidhje me të, për ta sjelle atë në linjë me Direktivat/Rregulloret përkatëse të BE-se. Për shkak se Direktiva e Produkteve të Ndërtimit është e transpozuar pjesërisht në Ligjin No. 9290 dhe VKM No. 58 datë 01.02.2006, ka nevojë që legjislacioni për produktet e ndërtimit të rishikohet me qëllim që të përputhet me përcaktimin. Megjithatë, është vendosur që ky rishikim të realizohet në vijim të aprovimit të propozimit nga Komisioni Europian të Rregullores së Re për Produktet e Ndërtimit, version NFL i cili do të zëvendësojë në fund Direktivën e Produkteve të Ndërtimit CPD.




Figura 1.1 - Spjegim i thjeshtuar i rregullores bazuar në Përafrimin e Ri

1.6) Lista e shkurtimeve

Shkurtimi	Kuptimi	Shpjegimi
AoC	Vërtetimi I konformitetit	Përcaktimi se kush duhet të përfshihet në verifikimin e konformitetit të një produkti kundrejt përcaktimeve të një specifikimi teknik. Prodhuesi është gjithmonë i përfshirë, gjithashtu mund të përfshihen edhe palë të treta në varësi të sistemit të përcaktuar.
CA	Vlerësimi i konformitetit	Procesi nëpërmjet të cilit tregohet përputhja e një produkti me specifikimet teknike; kombinon EoC dhe AoC.
OVK	Organizmi i Vlerësimit të Konformitetit	Organizatë e përfshire në procesin e vlerësimit të konformitetit: mbulon laboratorët e testimit, organizmat e inspektimit të FPC dhe organizmat e çertifikimit të produktit.
CEN	Komiteti European për Standardizimin	Organizate, krijuar prej Organizmave Kombëtare të Standardeve të shumë vendeve, nga brenda dhe jashtë Bashkimit European, përgjegjëse për përgatitjen e standardeve Europiane.
CENELEC	-	Ekuivalent i CEN por për standardet e fushës elektro-magnetike
CMD	Vendim i Këshillit të Ministrave	Instrument ligjor që fut rregulloret teknike në ligjin Shqiptar.
CPD	Direktiva e Produkteve të Ndërtimit	Direktiva e BE-së që përcakton kushtet në përputhje me të cilat produktet e ndërtimit mund të hidhen në tregun European.

CPL	Ligji Shqiptar për Produktet e Ndërtimit	Ligj i cili rregullon hedhjen në treg të produkteve të ndërtimit në Shqipëri (Ligji No. 9779). Bazuar pjesërisht në CPD.
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	Organizëm kombëtar që ka përgjegjësinë për akreditimin e laboratorëve (të testimit, kalibrimit dhe atyre mjekësore), organizmave të çertifikimit dhe organizmave të inspektimit. E njohur gjithashtu edhe si DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit).
EA	Bashkëpunimi European për akreditimin	Rrjeti European i organizmave të akreditimit të njohur në nivel kombëtar, të cilat ndodhen në zonën gjeografike Europiane.
EC	Komisioni European	Organizatë Europiane përgjegjëse për mbikqyrjen e implementimit të CPD dhe legjislacionit tjetër në nivel European.
EEA	Zona Ekonomike Europiane	Vendet Antare të bashkimit European së bashku me vendet e EFTA dhe Zvicrën.
EN	Standard European	Standard i publikuar nga njëra prej organizatave Europiane të Standardizimit.
EoC	Vlerësimi i konformitetit	Përcaktimet teknike nëpërmjet të cilave produkti demonstron konformitetin me një specifikim teknik; në thelb përcakton se “çfarë” duhet bërë.

EOTA	Organizata Europiane për Aprovimet Teknike	Organizëm European i përbërë nga organizma të Aprovimit nga i gjithë Bashkimi European, përgjegjës për draftimin e ETAG dhe nxjerrjen e ETA-ve.
ETA	Aprovimi Teknik European	Vlerësim i favorshëm të përputhjes me qëllimin të një produkti ndërtimi, lëshuar nga një Organizëm Aprovues ETA.
ETAG	Udhëzuesi për Aprovimin Teknik European	Dokument i zhvilluar brenda EOTA, i cili krijon bazat mbi të cilat mund të lëshohen ETA në lidhje me ato produkte që janë brenda veprimtarisë së ETAG.
EU (BE)	Bashkimi European	Zona Europiane që përfshin 27 Vendet aktuale Antare të BE
FPC	Kontrulli i prodhimit në fabrike	Sistemi i brendshëm i kontrollit të prodhimit realizuar nga prodhuesi, me qëllim për të siguruar që rezultatet e testimit të tipit fillestar, mbeten të vlefshme gjatë gjithë prodhimit të ardhshëm.
GNB	Grupi i Organizmave të Notifikuar	Organizatë e përbërë nga organizma të notifikuar nga Vendet Anëtare të BE-se përgjegjës për diskutimin dhe arritjen e marrëveshjeve për çështje që kanë të bëjnë me aplikimin e Standardeve Europiane.
hEN	Standardet Europiane të Harmonizuara	Standard European produkti i cili, në kuadrin e CPD, i lejon produktet e ndërtimit që të demonstrojnë që i plotësojnë kërkesat e kësaj direktive.
IAF	Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit	Shoqata botërore e organizmave të akreditimit të vlerësimit të konformitetit në fushat e sistemit të manaxhimit, produkteve, shërbimeve, personelit dhe programeve të ngjashme të vlerësimit të konformitetit.

ILAC	Bashkëpunimi ndërkombëtar i akreditimit të laboratoreve	Një bashkëpunim ndërkombëtar i organizmave të akreditimit të laboratoreve dhe trupave inspektues, krijuar më shumë se 30 vjet më parë për të ndihmuar heqjen e pengesave teknike në tregti.
ISO	Organizata ndërkombëtare e standardeve	Organizatë e përbërë nga organizmat kombëtare të standardeve nga e gjithë bota, përgjegjëse për përgatitjen e standardeve ndërkombëtare.
ITT	Testim i tipit fillestar	Mjet nëpërmjet të cilit përcaktohen performanca apo karakteristika të tjera të produkteve të ndërtimit; përfshin testimet ose metoda të tjera të vlerësimit sikurse është llogaritja.
NAD	Direktiva e Përafrimit të Ri	Instrument ligjor i BE-se bazuar në principet e Përafrimit të Ri (Kërkesa Themelore të detyrueshme dhe vlerësim konformiteti, mbështetur nga standarde vullnetare).
NPD	Nuk ka performace të përcaktuar	Deklaratë e përgatitur nga prodhuesi në lidhje me një karakteristike të një produkti ku, për qëllimin final të përdorimit të tij, nuk ekzistojnë kërkesa rregullatore në Vendin Anëtarë të përdorimit.
NSB	Organizmat kombëtare të standardeve	Organizatë përgjegjëse për disponueshmërinë kombëtare të standardeve Europiane dhe atyre ISO si dhe për përgatitjen e standardeve kombëtare.
SCC	Komiteti i Përhershëm i Ndërtimit	Komitet, I kryesuar nga Komisioni Europian dhe përbërë nga rregullatore për ndërtimin dhe vëzhgues të Vendeve Anëtarë, të ngarkuar për diskutimin dhe marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me implementimin e CPD-se.

Seksioni 2

SEKSIONI 2: Funksonimi i CPD

2.1) Standardet dhe ETA-at

2.1.1) Hyrje

CPD identifikon dy tipe specifkimesh teknike të cilat mund të përdoren për të përfituar markën CE dhe nëpërmjet saj të demonstron konformiteti me kërkesat e direktivës; Standardet Europiane (EN) si dhe Aprovimet Teknike Europiane (ETA), (aty është përfshirë edhe një rrugë e tretë nëpërmjet përdorimit të standardeve kombëtare, mundësi që nuk përdoret në BE - por që gjithësesi mund të përdoret në Shqipëri). Me qëllim arritjen e vazhdueshmërisë, standardet e vjetra kombëtare dhe aprovimet kombëtare janë zëvendësuar me EN dhe ETA dhe kjo garanton që të gjitha produktet vlerësohen në të njëjtën mënyrë.

Standardet EN janë dokumenta “vullnetarë”, çka nënkupton se në vetvete nuk përbëjnë kërkesa rregullatore apo kontrata. Shumica e standardeve të produkteve të ndërtimit janë përgatitur nga CEN (Komiteti Europian i Standardizimit) me qendër në Bruksel. Shumica dërmuese e standardeve EN janë ose standarde produktesh ose standarde metodash testimi. Megjithatë ekzistojnë shume tipe të tjera standardesh, sic janë: standardet e metodave të llogaritjes (për shembull Eurokodet Strukturale dhe llogaritjet akustike), standardet e klasifikimit (p.sh për performancë e zjarrit) si dhe standardet e të dhënave të references (për shembull tabelat e vlerave të përçueshmërisë termike).

2.1.2) Standardet e produkteve

Standardet e produkteve ndahen në dy lloje: të harmonizuar (që do të thotë që “mbështësin CPD-në”) dhe të pa-harmonizuara. Për të përfituar markën CE sipas CPD-së, prodhuesit i duhet të plotësojnë kërkesat e një standardi Europian të harmonizuar produkti nëse ky ekziston. Standardet e pa-harmonizuar të produkteve janë standard të cilat mbulojnë produkte apo materiale të cilat nuk çojnë në marrjen e markës CE. Ato mbulojnë produkte apo materiale të cilat nuk përfshihen në CPD, apo karakteristika produktesh jashtë fushës së veprimtarisë së direktivës.

Përmbajtja bazë e shumicës së standardeve të harmonizuar të produkteve është treguar më poshtë:

Fusha e veprimtarisë,
Referencat normative,
Kërkesat Themelore,
Metodat e testimit,
Vlerësimi i konformitetit,
Markimi dhe etiketimi,
Aneksi ZA: Klauzolat e standardit lidhur me kërkesat e CPD.

Standardet e produkteve (por edhe shumë standarde të tjera), përmbajnë lloje të ndryshme kërkesash, natyra e të cilave varet nga mënyra e përdorur për prezantimin e tyre:

- Kërkesa normative, prezantuar nga ‘do të’ (“Fortësia mekanike do të vlerësohet sipas 4.3”). Këto përcaktime duhet të zbatohen në mënyrë që të arrihet përputhja me standardin;
- Kërkesat normative nëse janë të aplikueshme, të prezantuara me “Nëse.... atëherë do të” (“Nëse produkti është i parashikuar të ekspozohet në cikle ngrirje/shkrirje, humbja e masës do të vlerësohet nëpërmjet testimit sipas EN 1234”). Këto përcaktime duhen zbatuar vetëm nëse kushti “Nëse” është i plotësuar;
- Kërkesat normative por me opsion, treguar me “ndoshta sipas X ose Y” (“Rezistenca në rrëshqitje mund të vlerësohet sipas Metodës 1 ose sipas Metodës 2”). Në këtë rast folja “mundet’ jep një lejim, por cilido opsion i zgjedhur mund të ndiqet sipas normativave;
- Kërkesa informative, të treguara me ‘do të duhej’ (“Produkti do të duhej të mbahej në një ambient me temperaturë të kontrolluar”). Këto përcaktime nuk duhet të ndiqen në mënyrë të detyruar.

Fusha e veprimtarisë së një standardi produktesh, përcakton saktësisht se cilat produkte mbulohen prej këtij standardi dhe në disa raste, se cilat produkte nuk mbulohen. Kur merret vendimi se cili standard duhet aplikuar, prodhuesit duhet të kontrollojnë fillimisht Fushën e veprimtarisë për t’u siguruar që standardi e mbulon produktin e tyre specifik. Seksionet për Kërkesat dhe Metodat e Testimit nëpër standard janë zakonisht vetë-spjeguese.

Me mjaft rëndësi për prodhuesit është përmbajtja e Aneksit ZA. Aneksi ZA, nga termat e standardizimit, konsiderohet ‘vullnetar’ (informative), por përcaktimet e tij duhen ndjekur për qëllimin e përputhjes me CPD. Aneksi ZA zakonisht përbëhet nga tre klauzola të veçanta. ZA.1 identifikon ato klauzola (kërkesa) nga përmbajtja e standardit të cilat mbulojnë karakteristikat e harmonizuara, p.sh. ato kundrejt të cilave duhet lëshuar një deklaratë ‘performance jo-performance e përcaktuar’. Njëra, disa apo të gjitha karakteristikat të dhëna në pjesën normative

të standardit, mund të jetë e nevojshme të merren në konsideratë, në varësi të produktit dhe mundësisht nga qëllimi i përdorimit; por prodhuesve u duhet të plotësojnë karakteristikat e harmonizuara që të përmbushin kërkesat e CPD; atyre u duhet të vlerësojnë cdo karakteristike vullnetare (p.sh. karakteristikat të cilat nuk përmenden nga ZA.1 dhe të pa mbuluara nga marka CE).

ZA.2 tregon sistemin(et) e çertifikimit të konformitetit të cilat duhen ndjekur për të përfituar markën CE dhe jep më shumë detaje për këtë çertifikim, si për shembull lidhur me rastet kur kërkohe testim i tipit fillestar nga një pale e tretë ndërkohe që karakteristikat e tjera testohen nga vetë prodhuesi (shih 2.3 më poshtë).

Pasi prodhuesi të ketë kaluar nëpër procedurën e çertifikimit të konformitetit, të ketë marrë rezultatet e testimit ITT dhe nëse nëvojitet, një çertifikatë nga një organizëm i notifikuar për çertifikim produkti, ai duhet të përgatisë një deklaratë konformiteti (provat e tij që produkti përmbush kërkesat e CPD). ZA.2 tregon gjithashtu edhe përmbajtjen e kërkuar të kësaj deklaratë (si edhe të çertificates nëse është e nevojshme), Së fundmi, ZA.3 përcakton rregullat lidhur me informacionin që duhet dhënë për të shoqëruar simbolin e markës CE, këto të vendosura ose në vetë produktin tek një etiketë e ngjitur me produktin apo në ambalazh, ose në dokumentat shoqëruese tregtare (standardi përcakton se cilat prej tyre si dhe cili kombinim duhet përdorur).

Informacioni lidhur me markën CE ka si synim kryesisht rregullatorët e tregut, sepse janë ata të cilët do ta lejojnë këtë produkt të hyjë në tregun e tyre dhe për këtë arsye duhet të jenë të bindur që produkti i përmbush kërkesat rregullatore. Një pjesë apo i gjithë informacioni i dhënë tek marka CE, sigurisht që mund të përdoret edhe nga blerësi dhe jo vetëm nga rregullatori i tregut. Por blerësit do t'i duhet të sigurohet që produkti që ai po blen (apo disa produkte të ngjashme që i ofrohen), kanë të njëjtën performance për përdorimin final që ai ka ndërmend; dhe ai mund të kërkojë edhe karakteristika të tjera të produkteve që nuk lidhen me shëndetin dhe sigurinë, të cilat përfshihen në pjesën e pa-harmonizuar të EN.

Një nga avantazhet e CPD është se çdo gjë që i kërkohe prodhuesit që të bëjë në mënyrë që të plotësojë kërkesat e direktivës, është e përcaktuar qartësisht në Aneksin ZA të standardit. Ajo që kërkohe nga prodhuesi është që ta lexojë këtë instruksion dhe të përmbushë kërkesat për marrjen e markës CE.

2.1.3) Aproximet Teknike Europiane

Pjesa më e madhe e këtij Dokumenti Udhëzues është shkruar sipas termave të Standardeve Europiane, duke qenë se këto mbulojnë pjesën më të madhe të produkteve. Megjithatë, ekziston edhe një mënyrë tjetër se si prodhuesit të

mund të përfitojnë markën CE, që është nëpërmjet Aprovimeve Teknike Europiane (ETA). ETA-t konsiderohen si specifikime teknike në kuadrin e CPD dhe përbëjnë një mekanizëm nëpërmjet të cilit prodhuesi mund të përfitojë markën CE për një produkt ndërtimi, kryesisht (por jo vetëm) për produktet innovative dhe të reja për të cilat nuk ekziston një hEN.

Një ETA është një vleresim i favorshëm teknik i përputhjes së produktit me qëllimin për të cilin ai është përgatitur. ETA-të leshohen nga një Organizëm Aprovues, i njohur si kompetent nga vendi ku ai ushtron aktivitetin. Pas konsultimeve me organizma të tjera Aprovues të BE që punojnë në kuadrin e Organizates Europiane për Aprovimet Teknike (EOTA). Lëshimi i një ETA kërkon që produkti të jetë objekt i një vleresimi nga një Organizëm Aprovues dhe pastaj i një procedure certifikimi të konformitetit (shih 2.3 me poshte); megjithatë, në shumicën e rasteve, rezultatet e vleresimit nga Organizmi Aprovues mund të përdoren për të plotësuar kërkesat e ITT.

Një produkt ndërtimi që ka një ETA dhe që plotëson kërkesat e çertifikimit të konformitetit, mund të mbartë markën CE, mund të nxirret në tregjet e çdo vendi të EEA dhe duhet të jetë në gjendje të përfitojë nga i njëjti prezumim konformiteti ashtu si edhe produktet që mbartin markën CE në përputhje me një Standard European.

Një ETA mund të jepet nëse plotësohet secila nga kushtet e mëposhtme:

- Nuk ekziston asnjë hEN për atë produkt,
- Komisioni European nuk i ka dhene CEN mandat për këtë hEN,
- Komisioni European konsideron që një standard nuk mund të zhvillohet (akoma),
- Produkti devijon në mënyrë domethënëse nga përcaktimet e hEN përkatës.

Ekzistojnë dy rrugë për të marrë një ETA; nëpërmjet një Udhëzuesi ETA (ETAG) i cili është një dokument i përgatitur nga një Grup Pune për përdorim nga Organizmat Aprovues EOTA; ose prodhuesi individual të ndjekë rrugën e Procedurës së Vlerësimit të Mirëkuptimit të Përbashkët (CUAP) (shih më poshtë).

ETAG ekzistojnë atëherë kur ka mundësi që të ekzistojnë prodhues të cilët dëshirojnë të përfitojnë ETA për produktet që mbulohen nga Udhëzuesi. Qëllimi i tyre kryesor është të përcaktojnë mënyrën se si Organizmat Aprovues do të vlerësojnë karakteristikat/kërkesat specifike të një produkti apo familje produktesh, dhe ato përcaktojnë bazat në përputhje me të cilat Organizmat Aprovues lëshojnë një ETA.

Për ato fusha produktesh ku nuk ekzistojnë ETAG, mund të jepen ETA, pas një marrveshjeje të Organizmave Aprovues EOTA dhe në shumicën e rasteve, edhe aprovimit nga Komisioni European që të mund të lëshohet një ETA. Organizmat Aprovues EOTA bien dakord rreth metodës së përdorur të vlerësimit për të lëshur një ETA nëpërmjet asaj që njihet si Procedura e Vlerësimit të Mirëkuptimit të Përbashkët (CUAP), në të cilën përcaktohen kriteret e vlerësimit për produktin si dhe qëllimi i tij i përdorimit.

Një prodhues individual mund t'i kërkojë një Organizmi Aprovues EOTA që të lëshojë një ETA për produktin e tij, duke përdorur një nga rrugët e sipërpërmendura. Megjithatë, fakti që një prodhues ka kërkuar, dhe pas një vlerësimi të duhur dhe të suksesshëm, ka përfituar një ETA dhe si rrjedhojë markën CE, nuk përbën detyrim për prodhuesit e produkteve të njëjta që të aplikojnë gjithashtu për një ETA. Megjithëse në Vendet Anëtare ku marka CE është e detyrueshme, prodhuesit duhet të aplikojnë dhe plotësojnë kërkesat e hEN përkatës sapo ai të jetë publikuar, Komisioni European ka konfirmuar se ETA-t mbeten elementë opsionale. Për këtë arsye nëse një prodhues kërkon të marrë një ETA apo jo, ky mbetet kryesisht një vendim komercial.

Versioni Shqiptar i CPD, parashikon mundësinë për prodhuesit që të aplikojnë për një Aprovim Teknik Shqiptar (si ekuivalent i ETA por aktualisht aplikuar vetëm në Shqipëri). Megjithatë në kohën kur është shkruar ky Dokument Udhëzues, Organizata Shqiptare për Aprovimet Teknike nuk është krijuar akoma dhe për këtë arsye kjo mundësi është aktualisht vetëm teorike.

Fakti nëse një prodhues duhet të kërkojë një ETA (apo një Aprovim Teknik Shqiptar (ATA) kur kjo të bëhet e mundshme), nuk është i ngjashëm me faktin se nëse ai duhet të kërkojë markën CE sipas një hEN, megjithëse në rastin e ETA dhe të shitjes në BE, ai nuk ka të njëjtat detyrime për përdorimin e markës CE sic do të kishte nëse do të ekzistonte një hEN për produktin e tij. Nëpërmjet markës CE bazuar tek një ETA, prodhuesi duhet të realizojë që të mund ta ofrojë produktin e tij për shitje në tregjet e Bashkimit European pa asnjë problem, dhe që marka CE ka të ngjarë t'i japë atij një avantazh komercial karshi produkteve konkruuese të pa-markuara. Por nga ana tjetër duhen marrë në konsideratë edhe nëse fillimisht ka kuptim nga ana ekonomike për ta eksportuar produktin, dhe nëse kosto e marrjes së markës CE, e bën procesin të leverdisshëm. E njëjta logjike do të jetë e vërtetë në Shqipëri kur përdorimi ATA të bëhet i mundur; prodhuesve do t'u duhet të marrin parasysh përfitimet nga përdorimi i markës Shqiptare të konformitetit kundrejt koston që kërkohet për ta marrë atë.

2.2) Vlerësimi i konformitetit

2.2.1) Hyrje

Vlerësimi i konformitetit (EoC), në mënyrë të thjeshtuar, është procesi nëpërmjet të cilit një produkt demonstroi që të ketë karakteristikat dhe performancën e pretenduar nga përdoruesi nëpërmjet testimit të tipit fillestar (ITT) si dhe mënyrave nëpërmjet të cilave prodhuesi siguron që të gjitha produktet e tij të ardhshme do të arrijnë në mënyrë të vazhdueshme performancën e deklaruar duke përdorur kontrollin e prodhimit në fabrike (FPC). Të gjitha standardet e produkteve që mbulohen nga CPD përmbajnë kërkesa si ndaj ITT ashtu edhe ndaj FPC si dhe përfshijnë metoda testimi apo vlerësimi. Për këtë arsye EoC në hEN, mbulon atë që si do të demonstron që produkti është konform standardeve. EoC merret vetëm me atë se çfarë duhet bërë për ta demonstruar këtë konformitet. Se kush duhet të merret me (gjë që njihet edhe si çertifikimi i konformitetit) është sqaruar në pikën 2.3 më poshtë.

Përveç plotësimit të kërkesës ligjore të CPD, nevojitet një klauzole e vlerësimit të konformitetit për të demonstruar nëpërmjet ITT-se, që produkti plotëson kërkesat e standardit dhe që deklaratat e performancës përfaqësojnë realitetin mbi këtë produkt, dhe nëpërmjet kontrollit në fabrikë, faktin që deklaratat e performancës bazuar në ITT do të mbeten të vlefshme edhe për produktet pasardhëse. Përveç kësaj, ajo duhet të garantojë që performanca e deklaruar nga prodhuesi të ndryshëm lidhur me një karakteristike të caktuar, janë të besueshme dhe vërtet të krahasueshme, përcaktuar me një nivel ekuivalent sigurie, dhe që mund të përdoren për të plotësuar çdo klas apo nivel të caktuar punimesh (p.sh. në rregulloret kombëtare).

Standardet e produktit përmbajnë një sërë kërkesash dhe karakteristikash të performancës të cilat aplikohen tek produkti. Këto mund të përshkruhen në mënyrë të ndryshme sipas shembujve tipike të përshkruar më poshtë:

- Kërkesa kalon/dështon (termi “kalon/dështon mund të keqkuptohet sepse zakonisht produkti duhet të ‘kalojë’”),
- Vlerat kufi, të cilat janë vlera jashtë të cilave një produkt nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm për asnjë lloj përdorimi,
- Performanca e deklaruar, ku produkti është testuar dhe rezultati është deklaruar,
- Klasat, që përdoren kryesisht për performancën e zjarrit.

Të gjitha klauzolat e vlerësimit të konformitetit do të përmbajnë një nën-klauzole që quhet “Testimi i tipit fillestar”, që identifikon mënyrën se si testohen dhe vlerësohen karakteristikat e produkteve (që mund të përmbajnë një seksion të titulluar “marrja e mostrave”), si dhe një nën-klauzole të titulluar “Kontrolli i prodhimit të fabrike”. Pavarësisht se këtu përdoret termi ITT, mund të përdoren gjithashtu edhe mënyra të tjera vlerësimi, sic janë:

- Llogaritjet (p.sh të performancës strukturale),
- Përdorimi i të dhënave nga tabulatet (p.sh përçueshmeria termike),
- Përcaktimet ‘konsiderohet që përmbush’ (p.sh produkte për reagim ndaj zjarrit të Klasit A1).

Të gjitha përcaktimet rreth vlerësimit të konformitetit që përfshihen në një hEN janë njësoj të detyrueshme si për prodhuesit ashtu edhe për organizmat e notifikuar. Kjo do të nënkuptojë për shembull që aty ku një hEN përcakton një minimum frekuence testimi, asnjë prodhues nuk mund të plotësojë kërkesat e hEN duke përdorur një frekuence më të ulët dhe në mënyrë të ngjashme, nëse produkti i tij i plotëson kërkesat e hEN në nivelin minimal të frekuencës, asnjë organizëm i notifikuar nuk mund ta detyrojë prodhuesin që të përdorë një frekuence më të lartë.

2.2.2) Testimi i tipin fillestar (ITT)

Direktiva e Produkteve të Ndërtimit CPD kërkon që të gjitha karakteristikat e harmonizuara (për të cilat prodhuesi deklaron performancën), të jenë objekt i ITT kur prodhuesi deklaron në fillim konformitetin me një hEN. Kjo vlen gjithashtu edhe për produktet ekzistuese edhe nëse ato kanë qenë për disa kohë në prodhim. Jo të gjitha karakteristikat e identifikuar në një standard janë detyrueshme të detyrueshme për marrjen e markës CE. Kjo si për arsye të përdorimit final të parashkuar (p.sh. izolimi i tingullit nuk ka nevojë të deklarohet nëse produkti nuk është parashkuar të përdoret për izolim tingulli), ashtu edhe për arsye se karakteristika nuk është objekt i rregulloreve të Vendeve Anëtare ku produkti do të hidhet në treg. Në secilin nga rastet, prodhuesi ka mundësi të përdorë opsionin ‘Jo performance e përcaktuar’. Prodhuesit duhet t’i njohin tregjet e tyre si edhe përdorimin(et) finale të produkteve të tyre, dhe si rrjedhojë të testojnë dhe vlerësojnë vetem ato karakteristika të cilat janë të nevojshme, pavarësisht se nëse një prodhues i deklaron të gjitha karakteristikat, ai i maksimizon përdorimet finale të produktit të tij.

Atëherë kur kërkojnë të përmbushin kërkesat e standardit, prodhuesit duhet të kryejnë ITT në përputhje me cilatdo kërkesa të standardeve, duke përdorur

metodën e specifikuar të testimit apo vlerësimit dhe rezultatet duhen deklaruar në përputhje me kerkesat që ka standardi. Shumë standarde specifikojnë “vlera kufi”, vlera minimale apo maksimale të një karakteristike përtej të cilave një produkt nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm për asnjë përdorim. Në këtë rast, të gjitha produktet duhet të arrijnë të paktën vlerat kufitare të përcaktuara.

Disa standarde përmbajnë alternative ndaj testimit direkt për qëllimet e ITT dhe disa standarde e lejojnë prodhuesit që të zgjedhë se çfarë metode të përdorë. Atëherë kur një standard ofron alternativa të tilla, është krejtësisht përgjegjësia e prodhuesit të vendosë se cilën metode të zgjedhë për të zbatuar, megjithëse në disa raste standardet kërkojnë që rezultati të shoqërohet me identifikimin e metodës së përdorur.

2.2.3) Kontrolli i prodhimit në fabrikë (FPC)

Kontrolli i prodhimit në fabrikë (FPC) nënkupton një kontroll të brendshëm permanent të prodhimit ushtruar nga prodhuesi. FPC e lejon një prodhues që të garantojë që performancë që ai deklaron (përfutur në bazë të ITT), të vazhdojë të jetë e vlefshme për të gjithë prodhimin në vazhdim. Përgjithësisht kjo përfshin sigurimin që produktet në vijim të jenë në thelb të njëjta me ato të paraqitura gjatë ITT.

Në përgjithësi, FPC ka lidhje me të gjitha karakteristikat. Megjithatë kjo nuk do të thotë që të gjitha karakteristikat të jenë objekt testimi apo që të njëjtat teste të përdorura për ITT duhet të përdoren për FPC. Vetë FPC mund të përfshijë kontrolle nëpërmjet mjeteve indirekte apo të nënkuptojë përdorimin e metodave të ndryshme të testimit (zakonisht më të thjeshta dhe meëpak të kushtueshme) krahasuar me ato që përdoren gjatë ITT.

FPC përfshin shpesh etapa të ndryshme të procesit të prodhimit: kontrolli i lëndës së parë, kontrolli i procesit dhe testimi i produktit final. Disa standarde përcaktojnë kërkesa për disa apo të gjitha këto aspekte por ndërkohë standarde të tjera mund të kenë kërkesa vetëm për testimin e produktit përfundimtar. Prodhuesit dhe organizmat e notifikuar (nëse këta përfshihen), duhet të ndjekin çfarëdo përcaktimi të jetë shkruar në standard, por një system i kënaqshëm FPC mundet që të përfshijë edhe aspekte të tjera të cilat nuk identifikohen në standard. Në shumë standarde konsiderohet që nëse prodhuesi përdor një system menaxhimi EN ISO 9001i cili është përgatitur specifikisht për produktin në fjalë, atëherë ai i plotëson kërkesat e Direktivës së Produkteve të Ndërtimit për FPC, pavarësisht se ai nuk është i detyruar që ta bëjë këtë.

2.3) Vërtetimi i konformitetit

2.3.1) Hyrje

Në ndryshim nga vlerësimi i konformitetit i përshkruar në 2.2, i cili merret me atë çka duhet bërë për të demonstruar që një produkt plotëson kërkesat e një standardi, vërtetimi i konformitetit i jep përgjigje pyetjes “Kush duhet ta bëjë këtë?”. Për sa i takon CPD-se, vërtetimi i konformitetit e përfshin gjithmonë prodhuesin dhe mundet që, në varësi të tipit të produktit dhe qëllimit të parashikuar të përdorimit të tij, të përfshijë një ose më shumë organizma të notifikuar që kanë katër funksionë të mundshme: testim apo vlerësim, inspektim FPC, çertifikim FPC ose çertifikim produkti.

Direktiva e Produkteve të Ndërtimit përcakton katër vërtetime baze të sistemeve të konformitetit (1-4, me dy nën-sisteme, 1+ dhe 2+). Sistemi(et) që kanë të bëjnë me një produkt specifik (dhe mundësisht edhe me qëllimin e tij të përdorimit) janë të përcaktuar në Aneksin ZA të cdo hEN-i dhe e thënë shumë thjesht, sistemi(et) janë zgjedhur bazuar në rrezikun që shoqëron çdo produkt. Çdo produkt për një përdorim specifik të parashikuar (ose për të cilin prodhuesi dëshiron të deklarojë disa karakteristika), ka vetëm një sistem të përgjithshëm çertifikimi. Por ky sistem mund të ndryshojë si rezultat ose i nivelit të performancës ose të relevancës së një apo më shumë karakteristikave. Sistemet e ndryshme dhe mënyra se si aplikohen ato, janë përshkruar më poshtë.

2.3.2) Vërtetimi i sistemeve të konformitetit

Të katër sistemet e Vërtetimit të Konformitetit të lejuara në kuadrin e CPD-se, janë përshkruar shkurtimisht më poshtë:

- Sistemi 1: Çertifikim produkti nga një organizëm i notifikuar për çertifikim produkti, ku ITT kryhet nga organizmi çertifikues (Sistemi 1+ shton testimin e auditit);
- Sistemi 2: Çertifikim FPC nga një organizëm i notifikuar çertifikues sistemi, ku ITT kryhet nga vetë prodhuesi (Sistemi 2+ shton inspektimet e rregullta të sistemit FPC);
- Sistemi 3: ITT realizohet nga një laborator i notifikuar testimi;
- Sistemi 4: ITT realizohet nga prodhuesi.

Në të gjithë sistemet e Vertetimit të Konformitetit AoC, prodhuesi duhet të zbatojë një sistem FPC si dhe të realizojë ITT ose nga vetë prodhuesi ose nga një laborator i notifikuar testimi (në Shqipëri puna e organizmave të notifikuar do të kryhet nga ‘organizmat e autorizuar’ kompetenca e të cilave është e njohur nga autoritetet Shqiptare që të operojnë në kuadrin e CPD). Në fakt sistemi është disi më i komplikuar se kaq sepse, duke marrë si shembull një produkt të Sistemit 1, megjithëse një organizëm çertifikimi duhet të kryejë ITT për të paktën një karakteristike, karakteristikat e tjera duhen testuar ose nga vetë prodhuesi (ato që janë me karakter releativisht jo-kritik), ose nga një laborator i notifikuar testimi në emër të prodhuesit. Kur të jenë realizuar të gjitha këto testime, organizmi i çertifikimit grumbullon rezultatet dhe lëshon një çertifikate.

Detyrat që duhet të kryejë secila palë e përfshirë në këtë sistem, si edhe detyrat që varen nga detajet e sistemit AoC përcaktuar në Aneksin ZA, janë të treguara në tabelën e mëposhtme, e cila ndiqet nga spjegime të mëtejshme rreth mënyrës se si funksionojnë këto sisteme.

Tabela 2.1 - Detyrat e vërtetimit të konformitetit në kuadrin e CPD

Çertifikimi i sistemit të konformitetit	1+ 1	2+ 2	3	4
Detyrat për prodhuesin				
Kontrulli i produktit në fabrikë (FPC)	✓	✓	✓	✓
Testim i mëtejshëm i provave të marra në fabrikë	☑	☑	☑	-
Testim i tipit fillestar nga një laborator i notifikuar testimi	☑	☑	☑	✓
Testim i tipit fillestar nga vetë prodhuesi ²	☑	☑	✓	✓
Detyrat për organizmin e notifikuar				
Çertifikimi i produktit	✓	✓	-	-
Çertifikimi i FPC	-	-	✓	✓
Mbikqyrja e FPC	✓	✓	-	-
Testim i tipit fillestar nga organizmi i certifikimit të produktit	✓	✓	✓	✓
Testim auditi i mostrave	✓	-	✓	-

- ✓ = Detyrë e kërkuar gjithmonë
- ☑ = Detyrë mundësisht e kërkuar¹
- = Detyrë që nuk kërkohet

1) Shumë sisteme mund të kenë nevojë për një kombinim të detyrave të ndryshme të kryera nga organizma të ndryshëm. Për shembull, në kuadrin e Sistemit 1+ do të ketë gjithmonë të paktën një karakteristike objekt i ITT direkt nën përgjegjësinë e organizmit të certifikimit të produktit (për shembull reagimi ndaj zjarrit). Megjithatë, mund të ketë edhe karakteristika të tjera të testuara nga një laborator i notifikuar testimi nën përgjegjësinë e prodhuesit (p.sh. për substancat e dëmshme) si dhe disa karakteristika të testuara nga vetë prodhuesi. Tabelat në Anëksin ZA.2 tregojnë me saktësi se çfarë detyrash duhen realizuar nga cili organizëm.

2) Prodhuesi mund të përdore një laborator testimi si palë e tretë nëse ai vetë nuk i ka pajisjet e nevojshme të testimit. Laboratori i testimit në këtë rast nuk ka nevojë të jetë i notifikuar.

2.3.3) Caktimi i një sistemi AoC për një produkt të caktuar

Çdo produkt për një përdorim final të veçantë (çka do të thotë që duhet vlerësuar një set i caktuar karakteristikash), ka vetëm një sistem AoC dhe ky sistem është i përcaktuar në ZA.2 të Anëksit ZA të standardit të harmonizuar European të produktit. Sistemi AoC që duhet aplikuar do të jetë gjithmonë sistemi më i lartë që i aplikohet të paktën një karakteristike, por kjo mund të varet nga niveli i performancës së reagimit ndaj zjarrit të produktit (nëse produkti digjet) si edhe nga fakti se cilat karakteristika janë treguar, ashtu sikurse tregohet më poshtë.

Produktet objekte të kërkesave për reagim ndaj zjarrit, mbulohen nga një prej sistemeve të mëposhtme në varësi të klasit të tyre të performancës (ku Klasi 1 është më i lart; produkti nuk digjet, ndërsa Klasi F me i ulti):

Klasi (A1, A2, B, C)*	Sistemi 1
Klasi (A1, A2, B, C)** , D, E	Sistemi 3
Klasi (A1 - E)*** , F	Sistemi 4

* Produktet/materialet për të cilat një stad i identifikuar qartë gjatë procesit të prodhimit, rezultojnë në një përmirësim të klasifikimit të reagimit ndaj zjarrit (p.sh. me shtimin e elementeve vonues të zjarrit apo me kufizimin e materialit organik).

** Produkte/materialet të pa-mbuluara nga shenimi (*).

*** Produkte/material të cilat nuk ka nevojë të testohen për reagimin ndaj zjarrit (p.sh. produktet/materialet e Klasit A sipas Vendimit të Komisioni 96/603/EC, i amenduar).

Në mënyrë të ngjashme, produktet mund të ndahen (për shembull) në:

Produkte objekt të kërkesave rregullatore për substancat e rrezikshme	Sistemi 3
Të gjitha produktet e tjera	Sistemi 4

Megjithatë, fakti që një produkt i përket një sistemi të caktuar, nuk do të thotë që të gjitha karakteristikat e tij duhet të testohen sipas atij sistemi; kjo spjegohet edhe nga shembujt e mëposhtëm (shembuj të tjerë për produkte në kuadrin e Sistemit 1 dhe Sistemit 4, janë dhënë në Seksionin 4).

Në kuadrin e Sistemit 3, ndërkohë që përgjegjësia si për ITT dhe FPC mbetet tek prodhuesi, disa apo të gjithë karakteristikat kërkojnë që ITT të kryhet nga një laborator i notifikuar testimi. Kjo do të tregohet në Aneksin ZA ashtu sic tregohet edhe në tabelën e mëposhtme (Tabela ZA.3b).

Tabela ZA.3b - Caktimi i detyrave të vlerësimit të konformitetit (për Sistemin 3)

Detyrat		Përmbajtja e detyrave	Vlerësimi i klauzolave të konformitetit që aplikohen
Detyrat nën përgjegjësinë e prodhuesit	Kontrulli i prodhimit në fabrike (FPC)	Parametra të lidhur me të gjithë karakteristikat e Tabeles ZA.1 lidhur me qëllimin e përdorimit	6.3
	Testimi i tipit fillestar nga prodhuesi	Të gjithë karakteristikat e Tabeles ZA.1 lidhur me qëllimin e përdorimit, përveç atyre që tregohen me poshtë (siguria elektrike dhe rezistenca termike)	6.2
	Testimi i tipit fillestar nga një laborator i notifikuar testimi	Reagimi ndaj zjarrit (Klasat A1**, A2**, B**, C**, D, E) Rezistenca ndaj zjarrit Forca e Përkuljes elastike Aftësia ngarkese-mbajtëse Leshimi i substancave të demshme	6.2

Ajo çka nënkuptohet me këtë është që nëse prodhuesi zgjedh të deklarojë (për arsye se ato kanë lidhje të ngushtë me qëllimin final të përdorimit), cilvdo nga karakteristikat në kutinë më të ulët të tabelës (reagimi ndaj zjarrit, etj.), këto karakteristika duhen testuar nga një laborator i notifikuar testimi. Karakteristikat e tjera (siguria elektrike dhe rezistenca termike) do të testoheshin nga vetë prodhuesi. Kjo tabelë kërkon gjithashtu që prodhuesi të realizojë një sistem FPC për të kontrolluar të gjithë karakteristikat kryesore.

Edhe për ato karakteristika të cilat janë testuar nga laboratorit i notifikuar i testimit, nuk është detyra e laboratorit as të vendosë nëse produkti e ka plotësuar ndonjë kërkesë të standardit dhe as të vendosë nëse produkti përputhet për qëllimin e caktuar të përdorimit. Përgjegjësitë e laboratorit të testimit kufizohen vetëm me

realizimin e testeve apo vlerësimeve dhe dërgimin e rezultateve tek prodhuesi. Pas kësaj varet nga prodhuesi që të përcaktojë për veten e tij nëse produkti plotëson ndonjë nga kërkesat e duhura të përcaktuara në standard.

Sistemet e Vërtetimit 2+ dhe 2 kërkojnë që sistemi FPC i prodhuesit të jetë objekt i një vlerësimi fillestar dhe çertifikimi nga një organizëm i notifikuar çertifikimi FPC (Sistemi 2), si dhe mbikqyrje të vazhdueshme, vlerësim dhe aprovim të sistemit (Sistemi 2+). Sistemet 2+ ose 2 nuk janë domosdoshmerisht “me të larta” se Sistemi 3, ato thjesht përdoren për lloje të ndryshme produktesh. Sistemi 3 aplikohet kryesisht për produktet prodhimi i të cilave është i stabilizuar dhe vetë produkti ka pak të ngjarë të jetë objekt defektesh si rezultat i vetë prodhimit; ndërkohe që Sistemet 2+ dhe 2, aplikohen për produkte për të cilat sistemi i prodhimit mund të jetë i ndryshueshëm. Tabela e mëposhtme jep një shembull për caktimin e detyrave për një produkt në kuadrin e Sistemit 2+ të AoC.

Tabela ZA.3 - Caktimi i detyrave të konformitetit për të caktuar forcën e drurit të struktur me seksion kryq rrethor (Sistemi 2+)

Detyrat		Përmbajtja e detyrave	Vler. klauz. të konf. që apl.
Detyrat nën përgjegjësinë e prodhuesit	Kontrolli i prodhimit në fabrikë (FPC)	Parametra të lidhur me të gjithë karakteristikat e Tabelës ZA.1 lidhur me qëllimin e përdorimit	6.3
	Testimi i tipit fillestar nga një laborator i notifikuar testimi	Reagimi ndaj zjarrit (vetëm kur testohet)	6.2
	Testimi i tipit fillestar nga prodhuesi	Parametra të lidhur me të gjithë karakteristikat e Tabeles ZA.1 lidhur me qëllimin e përdorimit përveç reagimit ndaj zjarrit (kur testohet)	6.2
	Testimi i mostrave të marra në fabrikë	Parametra të lidhur me të gjithë karakteristikat e Tabeles ZA.1 lidhur me qëllimin e përdorimit	6.3
	Çertifikimi i FPC nga organizma të çertifikimit të FPC në bazë të:	Inspektim fillestar të fabrikës dhe të FPC	Parametra të lidhur me të gjithë karakteristikat e Tabeles ZA.1 lidhur me qëllimin e përdorimit
Mbikqyrje e vazhdueshme, vlerësimi dhe aprovimi i FPC		Parametra të lidhur me të gjithë karakteristikat e Tabelës ZA.1 lidhur me qëllimin e përdorimit, në veçanti: forcat në përkulje dhe shtypje	6.3



Udhëzues për direktivën e produkteve të ndërtimit

Në këtë shembull, karakteristika e vetme që duhet testuar për ITT nga një laborator i notifikuar testimi, është reagimi ndaj zjarrit; të gjithë karakteristikat e tjera mund të testohen nga prodhuesi.

Seksioni 3

SEKSIONI 3: Proceset mbështetëse të CPD

3.1) Akreditimi

3.1.1) Të përgjithshme

Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) është krijuar në Mars të vitit 2004. Funksionimi i saj bazohet në Ligjin No. 9824 datë 01.11.2007 “Akreditimi i organizmave të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë” si dhe kërkesat e standardit EN ISO/IEC 17011:2004. DPA është organizmi kombëtar që ka përgjegjësinë për akreditimin e laboratorëve (të testimit, kalibrimit dhe atyre mjekësore), organizmave të çertifikimit dhe atyre të inspektimit. Ajo ofron shërbimet e akreditimit në përputhje me standardet përkatëse ndërkombetare dhe Europiane dhe udhëzuesin e detyrueshëm publikuar nga EA, IAF dhe ILAC.

DPA mbështet gjatë realizimit të detyrave të saj nga Bordi Këshillimor dhe Komitetet Teknike. Bordi Këshillimor i DPA përbëhet nga përfaqësues të ministrive përgjegjëse për ekonominë dhe tregtinë, bujqësinë dhe ushqimin, çështjet ambientale, ndërtimit dhe transportit, shëndetit dhe sigurisë në punë, institucionëve shkencore, biznesin dhe konsumatorët, etj. Antarët e Komiteteve Teknike të DPA-se janë përfaqësues të vetë DA-se si dhe ekspertë nga fusha të ndryshme.

DPA punëson vlerësues dhe ekspertë të jashtëm. Vlerësuesit përzgjidhen dhe trainohen sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me rigozitet dhe aktiviteti i tyre duhet të përputhet me kërkesat e rregulloreve specifike në lidhje me pavarësinë, integritetin dhe konfidencialitetin.

Kuadri ligjor për akreditimin në Shqipëri përbëhet nga:

- Ligji № 9824 datë 01.11.2007 “Akreditimi i organizmave të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave № 1716 datë 03.10.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”,
- Urdhëri i Kryeministrit № 124 datë 03.08.2007 “Për aprovimin e struktues dhe skemes organizative të Drejtorisë së Akreditimit”.

Sipas ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) është organizmi i vetëm kombëtar i akreditimit në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të realizuar dhënien, mbikqyrjen, zgjerimin, kufizimin dhe heqjen e akreditimit për:

- Laboratorët e testimit,
- Laboratorët e kalibrimit,
- Organizmat e çertifikimit të sistemeve dhe personelit,
- Organizmave të certifikimit të produktit,
- Organizmat e inspektimit,
- Ofruesit e Testeve të Zotësise/Krahasimeve Ndërlaboratorike,
- Përgatitesit e materialeve të çertifikuara të referencës (CRM).

3.1.2) Bashkëpunimi ndërkombëtar

Një nga objektivat kryesore të DPA-se është që të sigurojë njohjen ndërkombetare të raporteve dhe çertifikatave të lëshuara nga organizatat e akredituara prej saj. Gjatë dy viteve të fundit është shënuar një progres i ndjeshëm në këtë drejtim, dhe konkretisht:

- DPA ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi me EA në Shkurt të vitit 2007 dhe në muajin Dhjetor 2008 aplikoi për marrëveshje dypalëshe me EA në fushën e laboratorëve të testimit,
- DPA është një anëtar i asociuar dhe me të drejtë votë i ILAC që nga data 27 Tetor 2007,
- DPA është e anëtare e IAF që nga 20 Tetori i vitit 2008,
- DPA ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me organizmat ekuivalentë të rajonit, sikurse janë ESYD Greqi, RENAR Rumani, ATCG Mali i Zi, IARM Maqedoni dhe DAK Kosovë, TURKAK, Turqi.

3.2) Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit

DPA ka akredituar deri më sot 17 Organizma të Vlerësimit të Konformitetit (CAB) nga fusha të ndryshme të prodhimit dhe shërbimit. Ky numër përbëhet nga trembëdhjetë laboratorë testimi dhe kalibrimi, një organizëm për çertifikim produkti dhe tre organizma inspektimi. Detaje më të hollësishme rreth këtyre organizmave mund të gjenden në faqen zyrtare të DPA në internet: <http://www.albanianaccreditation.gov.al>.

Organizmat e akredituar të cilat operojnë në sektorin e ndërtimit janë treguar në tabelën e mëposhtme.

Emri	Fusha e akreditimit	Data e akreditimit	Data e përfundimit të akreditimit	Adresa
Labororet e testimit				
Instituti i Ndërtimit	Produkte ndërtimi	02.04.2007	02.04.2011	Rr. "Muhamet Gjollësja", Tirana, Albania Tel.: +355 (0) 422 73449 Fax:+355 (0) 422 73449
ECF-fabrika e Prodhimit të Cimentos, Elbasan	Produkte ndërtimi	31.07.2007	30.07.2011	Fabrika e Cimentos Elbasan, Albania Tel.: +355 (0) 544 24480
Laboratori KIBE, SH.P.K	Produkte ndërtimi	19.06.2008	18.06.2012	Laboratori "Kibe" SH.P.K, Lagja 15, Rr. "Aleksandër Goga", Porto Romano, Durrës, Albania Tel.: +355 (0) 523 7159
Altea Geo Studio	Produkte ndërtimi	26.12.2008	26.12.2012	Rr. "Kavajes" ish mjetet mesimore, Qyteti i Nxensve, Tirana,Albania Tel.: + 355 (0) 422 21288
Laboratori i Kerkimeve Shkencore në Universitetin "Aleksandër Xhuvani"	Produkte ndërtimi	20.01.2009	20.01.2013	Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Albania Tel./Fax: +355 (0) 545 2593
ELBA SHPK	Produkte ndërtimi	04.03.2010	04.03.2014	Elba SH.P.K, Rr. Vaso Pasha Pallati, Insigut Nr. 6, Tirana, Albania Tel. & Fax: +355 (0) 422 65857
Organizma inspektues				
Instituti i Ndërtimit	Inspektimi për vlerësimin e konformitetit të cimentos	22.09.2008	21.09.2012	Rr. "Muhamet Gjollësja", Tirana, Albania Tel.: +355 (0) 422 73449 Fax: +355 (0) 422 73449

Gjashtë laboratorë të tjerë si dhe një organizëm inspektimi janë në faza të ndryshme të vlerësimit për akreditim. Këto Organizma të Vlerësimit të Konformitetit mbulojnë fusha të ndryshme siç janë:

- Produkte ndërtimi,
- Monitorimi ambiental,
- Ujë jo i pijshëm,
- Ushqimin,
- Testimet jo-shkatërruese dhe enët nën presion.

3.3) Mbikqyrja e tregut

3.3.1) Hyrje

Mbikqyrja e tregut (MS) përbën një pjesë kyçe të çdo sistemi rregullator për produktet dhe kjo është po kaq e vërtetë edhe për rastin e produkteve të ndërtimit. Ai ka dy role kryesore: të mbrojë konsumatorët edhe përdoruesit e produkteve duke siguruar që produktet e pasigurta dhe pa konformitet të ndalohen apo të hiqen nga tregu, si dhe të sigurojë që prodhuesit vendas të jenë në gjëndje të konkurojnë ndërshterisht duke verifikuar që të njëjtat kushte aplikohen për të gjithë prodhuesit dhe importuesit. Gjatë këtij procesi, ajo ndalon “hedhjen” e produkteve të lira por ndoshta të pa-sigurta në treg, duke bërë të mundur që produktet vendase të konkurojnë ndërmjet tyre por edhe me ato të importit në kushte të njëjta dhe në bazë të cilësisë dhe jo vetëm të çmimit.

Krijimi një sistemi të përshtatshëm të Mbikqyrjes së Tregut është trajtuar në Seksioni 5 të këtij Dokumenti Udhëzues, ndërkohe që ky seksion e trajton atë vetëm nga pikëpamja e prodhuesve. Ky seksion tregon atë se çka mund të presin prodhuesit nga autoritetit e Mbikqyrjes së Tregut në rast se u kërkohet të demonstrojnë konformitetin e produkteve të tyre të veçanta, por gjithashtu edhe rolin të cilin duhet të luajnë për t’i ndihmuar këto autoritete.

Direktiva e Produkteve të Ndërtimit CPD nuk e përmend në mënyrë specifike mbikqyrjen e tregut, por dy përcaktime të kësaj direktive e bëjnë atë si një kërkesë që të gjitha vendet të cilat e implementojnë CPD-në duhet të kenë një sistem funksional mbikqyrjeje të tregut MS. Neni 21 i direktivës, klauzola mbrojtëse, kërkon që të gjitha Vëndet Antare të marrin masat e nevojshme për të larguar nga tregu produktet pa konformitet, të ndalojnë hedhjen e tyre në treg si dhe të kufizojnë lëvizjen e lirë të tyre. Përveç kësaj, Neni 15 trajton përdorimin korrekt të simbolit të markës CE dhe i kërkon Vëndeve Antare që të sigurojnë që ky markim të përdoret në mënyrën e duhur dhe, nëse marka CE është vendosur në një produkt pa konformitet, ta ndalojë përdorimin e kësaj marke dhe të tërheqë

nga tregu të gjitha produktet e pa-shitura. Përveç këtyre përcaktimeve specifike në CPD, Bashkimi European ka përgatitur se fundmi një Rregullore No. 765/2008, e cila i detyron të gjithë Vendet Antare që të adoptojnë Mbikqyrjen e Tregut tek të gjithë fushat e produkteve.

3.3.2) Aktivitetet e mbikqyrjes së tregut

Për sa i përket Vëndeve Antare, mbikqyrja e tregut përmbledh dy lloje aktivitetesh:

- monitorimin e produkteve të hedhura në tregjet e tyre dhe sigurimi që atë të përputhen me përcaktimet e CPD si dhe që kanë vlera të performances si ato të deklaruara nga prodhuesit,
- në rastet e mos-përputhjes, ndërmarrjen e aksioneve që synojnë ose të sigurojnë këtë përputhje ose heqjen apo pezullimin e produkteve nga tregu. Në rastin e dytë, Vendet Antare kanë për detyrë të notifikojnë Komisionin European si dhe Vendet e tjera Antare në rastet kur një produkt specifik është ndaluar apo hequr nga tregu.

Përveç rolit të tyre zbatues, shumë autoritete të mbikqyrjes së tregut kanë gjithashtu edhe rolin e dhënies së këshillimit dhe asistencës për prodhuesit rreth nevojave të duhura të tyre për të plotësuar që në fillim kërkesat e direktivës. Kjo bazohet në parimin se do të ishte shumë e lehtë dhe më pak e kushtueshme që jo-konformitetet të parandaloheshin, se sa të korigjoheshin pasi të kishin ndodhur.

Udhëzuesi i Komisionit European i ashtuquajtur “Udhëzuesi Blu’ “Udhëzues për implementimin e direktivës bazuar në Përafrimin e Ri dhe Përafrimin Global”, në kapitullin për MS trajton jo-përputhshmeritë “jo-thelbësore’ dhe ato “thelbësore”. Mos-përputhjet jo-thelbësore mund të përfshijnë çështje si përdorimi i proporcioneve të gabuara të simbolit të markës CE, mos vënia në kohën e duhur në dispozicion e deklaratës se konformitetit si përgjigje e një kërkesë specifike, ose rasti kur numri i standardit nuk shoqërohet me informacionin rreth markës CE. Nga ana tjetër mos-përputhjet thelbësore mund të përfshijnë çështje si mungesa nga ana e prodhuesit e deklarimit (ose përdorimi i NPD) të disa karakteristikave të kërkuara nga standardet Europiane të harmonizuara, apo mos-arritja nga ana e produktit e plotësisht të niveleve të performancës së deklaruar për të nga prodhuesi, gjatë testimit të kryer nga autoritetet e mbikqyrjes së tregut. Raste të tjera të mos-përputhjes thelbësore mund të jenë mungesa e raportit të testimit në mbështetje të niveleve të performances së deklaruar nga prodhuesi, apo regjistrime të FPC që demonstrojnë që prodhuesi nuk i ka plotësuar përcaktimet e FPC ashtu sic kërkohen në hEN.

3.3.3) Mbikqyrja e tregut dhe prodhuesit

Të gjithë prodhuesit që hedhin produktet e tyre në treg kanë përgjegjësinë e përgjithshme për të siguruar që produktet e tyre janë të sigurta dhe përputhen me qëllimin për të cilin janë përgatitur, dhe ky parim vlen pavarësisht nëse produkti mbulohet nga përcaktimet e CPD-se apo jo. Kjo nënkpton që autoritetet e MS kanë të drejtë të ndërmarrin aksione kundër çdo produkti të pa-sigurtë dhe pa konformitet; ky nën-seksion trajton vetëm ato produkte që mbulohen nga CPD dhe si rrjedhojë mbartin shenjën e konformitetit CE apo atë Shqiptare. Situata në Shqipëri do të ndryshojë me kalimin e kohës dhe direktiva do të fillojë të zbatohet dhe të hyjë në fuqi, dhe si pasojë, përdorimi i markës së konformitetit do të bëhet i detyrueshëm për shumicën e produkteve të ndërtimit dhe mund të themi që situata ekzistuese në Bashkimin Europian i korrespondon situates së ardhshme në Shqipëri.

Për sa i përket kontrollit të konformitetit sipas përcaktimeve të CPD, ekzistojnë pesë “nivele” informacioni apo aktivitete të hapura për autoritetet e Mbikqyrjes së Tregut:

- simboli i markës CE. Shumica e Vëndeve Antare të BE e kanë bërë të detyrueshëm përdorimin e markës CE (pavarësisht se kjo nuk është gjithmonë e vënë në zbatim) dhe si rrjedhojë, çdo produkt kryesor ndërtimi i cili nuk mbart markën CE duhet të ngrëjë dyshime;
- informacioni që shoqëron simbolin e markës CE. Autoritetet kompetente duhet të njohin, brenda arsyes, cili është informacioni “tip” i performances për shumë produkte dhe çfarë sistemi duhet t’i nënshtrohen për certifikimin e produktit. Ky element i fundit ka të bëjë me rastin kur tek marka CE shfaqet gjithashtu edhe një numër certifikatë apo numër certifikimi të organizmit certifikues. Nëse autoritetet e mbikqyrjes së tregut vërejnë se informacioni që shoqëron simbolin e markës CE duket i gabuar apo i papërshtatshëm, ato përsëri duhet të bëhen dyshues;
- deklaratë e konformitetit të prodhuesit, që përbën provën nga ana e tyre që produkti i ka plotësuar kërkesat e CPD. Kjo deklaratë mund të përmbajë një certifikatë konformiteti, ose të vetë produktit ose të sistemit FPC, për produktet që mbulohen nga Sistemi 1 dhe 2 i Çertifikimit të Konformitetit AoC. Nëse autoritetet e mbikqyrjes së tregut duan të kontrollojnë konformitetin e një produkti, ka shumë mundësi që veprimi i tyre i parë (pasi të kenë kontrolluar fillimisht për prezencën e markës CE dhe vlefshmërinë e informacionit shoqërues), do të ishte që t’i kërkojnë

prodhuesit që të vërë deklaratën në dispozicion të tyre. Për këtë arsye, të gjithë prodhuesit duhet të vazhdojnë t'i mbajnë këto dokumenta dhe t'i venë ato në dispozicion nëse u kërkohet ta bëjnë këtë gjë;

- rezultatet e testimit të tipit fillestar dhe rezultatet e kontrollit të prodhimit në fabrikë, mbi të cilën bazohet deklarata e konformitetit; shumica e deklaratave të konformitetit ose do t'i përmbajë ose do t'u referohet këtyre dokumentave. Edhe pse kjo nuk përbën një kërkesë specifike të CPD, shumica e prodhuesve do të përgatisin dhe mirëmbajnë një Dosje Teknike e cila e përshkruan produktin e tyre në një nivel të mirë detajimi. Nëse mbeten akoma dyshime në mendjet e autoriteteve të Mbikqyrjes së Tregut, ato kanë të drejtë që t'u kërkojnë prodhuesve kopje të rezultateve të testeve, rezultatet e FPC si dhe çdo Dosje Teknike dhe, ashtu si në rastin e deklaratës së konformitetit, prodhuesit duhet të jenë të gatshëm që t'i venë këto në dispozicion;
- së fundmi, autoritetet e Mbikqyrjes së Tregut kanë të drejtë që të kryejnë teste të produkteve me qëllim verifikimin e deklaratës së performancës të përgatitur nga prodhuesi si edhe nëse kjo nënkupton që produkti i plotëson kërkesat e CPD. Gjatë procesit të punës, ata kanë zakonisht të drejtë të hyjnë në ambientet e punës apo magazinat, etj, të prodhuesit, si dhe të marrin produkte apo dokumenta mbështetëse e kështu me rradhë. Megjithatë, testimi i produkteve nga tregu mund të rezultojë një proces i kushtueshëm dhe jo gjithmonë përfundimtar sidomos në rastet kur, megjithëse një prodhues ka bërë një deklaram jo-korrekt rreth produktit të tij, përseri nuk është e lehtë që t'i jepet përgjigje pyetjes nëse produkti është apo jo “i sigurtë” dhe “në përputhje me qëllimin e tij”.

Në përgjithësi, prodhuesit duhet ta kuptojnë përderisa produktet e tyre përputhen me standardin e duhur, ata nuk kanë asnjë kontakt me autoritetet e mbikqyrjes së tregut. Një nga përcaktimet themelore të CPD është që përputhja me qëllimin e përdorimit të produktit përcaktohet *përpara* se produkti të hidhet në treg, ndërkohë që Mbikqyrja e Tregut është një aktivitet që kryesisht zhvillohet *pasi* produktet të jenë hedhur në treg. Për këtë arsye prodhuesit duhet ta ruajnë krejt dokumentacionin përkatës dhe të jenë të përgatitur për ta vënë atë në dispozicion nëse kjo gjykohet e nevojshme.

Standardet e hershme të harmonizuara kërkonin që certifikata dhe deklarata e konformitetit të paraqitesh në gjuhën apo gjuhët të Vendit Antar ku produkti destinohej, cka nënkupton se në shumicën e rasteve ekzistonte nevoja për përkthimin e tyre. Standardet e mëvonshme kërkojnë ‘vetëm gjuhën apo gjuhët

e pranuar në Vendin Antar ku është destinuar produkti”, që i lejon Vendet Antare të pranojnë dokumenta në gjuhë që nuk janë gjuhët e tyre zyrtare, si p.sh në Anglisht. Gjithesesi Udhëzuesi Blu i Komisionit Europian sugjerojnë që deklarata dhe certifikata duhet të vihen menjëherë në dispozicion sipas kërkeses, që do të thotë se prodhuesit të cilet nuk mbajnë kopje të dokumentacionit të tyre të përkthyer në gjuhët e atyre Vendeve Antare me të cilët ata kanë marrdhenie tregtare, mund të vihen në veshitësi nëse keto dokumenta do t’u kërkohen. Udhëzuesi Blu sugjeron gjithashtu se mungesa e paraqitjes së një deklarate kur kjo gje kërket, përbën arsye të mjaftueshme për të dyshuar rreth konformitetit të produktit. Gjithesesi nuk ekzistojnë përcaktime që të kërkojnë përkthimin e raporteve të ITT apo FPC.

Megjithese autoritetet e Vendeve Antare mund t’i kërkojnë deklaratat dhe certifikatat e konformitetit atehere kur ata kanë dyshime rreth konformitetit të produktit, ato nuk duhet ta organizojnë kontrollin e ketyre dokumentave në mënyre rutinë apo për të gjithë produktet; nëse ato veprojnë në këtë mënyre parimi i ‘presumimit të konformitetit’ që sigurohet nga marka CE, është i rrezuar.

Një gjë që vërehet qartë është diferenca ndërmjet jo-konformitetit “rastesor” dhe jo-konformitetit “të qëllimshëm”. Nëse një prodhues nuk mund të vere në dispozicion dokumentat e nevojshme mbështetëse dhe raportet e testimit, ose nëse keto raportë përmbajnë vlera me të keqia se ato që ai deklaron, ketu jemi në rastin e një jo-konformiteti “të qëllimshëm” dhe prodhuesi duhet të ndiqet penalisht. Nëse një prodhues mund t’i paraqesë dokumentat mbështetës por produkti i testuar përsëri nuk duket që krijon përputhje, në këtë rast mund të mos jetë faji i prodhuesit. Në rastë të tilla nuk ka të ngjare që prodhuesi të ndiqet penalisht.

Rezultatet e aktiviteteve të mbikqyrjes së tregut mund të jenë një apo të shumefishta. Në rast se zbulohet një jo-konformitet, autoritetet do të kërkojnë fillimisht që prodhuesit apo agjentet e tij ta korigjojnë jo-konformitetin. Nëse është verifikuar një jo-konformitet jo-themelor, si për shembull një produkt nuk e ka marken CE kur CPD e kërkon këtë gje, autoritetet do të kërkojnë që kjo situatë të zgjidhet (mundesisht duke e pezulluar produktin në treg deri sa kjo të ndodhe). Nëse prodhuesi, për cfaredo lloj arsyeje refuzon ta zgjidhe këtë situatë, produkti i tij mundet që të kufizohet apo ndalohet krejtësisht hedhja në treg). Të njëjtat parime aplikohen edhe në rastin e një jo-konformiteti “thelbësor”, megjithese, duke qenë një rast me serioz, ka me shume të ngjare që produkti të pezullohet, ndalohet dhe hiqet nga tregu në mënyre të menjëhershme. Ka mundesi që rezultati i mundshëm përfundimtar të jetë që produkti të verifikohet si plotësisht konform. Në këtë rast, sidomos atehere kur produkti është kufizuar apo pezulluar nga tregu, prodhuesi mund të ketë drejtë të kompensohet për humbjen financiare të shkaktuar ndërkohe që po kryhesh investigimi.

3.3.4) Roli dhe përgjegjësia e prodhuesve

Përvec nevojës për të ruajtur dhe paraqitur dokumentacionin e nevojshëm në rastet kur kjo i kërkohet nga autoritetet e MS, dhe sigurisht të ketë plotësuar paraprakisht kërkesat e Standardit të duhur European, prodhuesit nuk kanë përgjegjësi të tjera direktë në lidhje me mbikqyrjen e tregut. Nëse një produkt i një prodhuesi individual është i kontestuar nga autoritetet e mbikqyrjes së tregut, prodhuesi (apo agjenti i tij) do të informohen rreth asaj që ata pritet të bejnë dhe natyrisht që është në interesin e tij të veproje ashtu sic i kerkohet, ose të paktën të fillojë të diskutojë me autoritetet.

Megjithatë, Komisioni European ka deklaruar shpesh se edhe prodhuesit kanë një rol indirekt në mbikqyrjen e tregut dhe në mbrojtjen e besueshmerise se markes CE si dhe të të gjithë sistemit të CPD-se. Shpeshere burimet në dispozicion të mbikqyrjes se tregut janë të kufizuara në Vendet Antare dhe vetë prodhuesit mund të jenë me të aftë të identifikojnë produkte jo-konforme, sidomos në rastet e jo-konformitetit ‘jo-thelbesor’, dhe t’i çojnë keto raste për vemendjen e autoriteteve. Ky rast është vecanërisht i vertetë kur p.sh një prodhues Shqiptar është i detyruar të konkurojë, padrejtesisht, kundër produkteve të cilat ai i njëh si pa-konformitet apo të cilat kanë të atashuar informacionin e gabuar teknik.

Për këtë arsye është mjaft e rëndësishme që prodhuesit të vendosin dhe të mbajnë marrdhënie të mira e të ngushta punë ndërmjet tyre dhe me autoritetet e mbikqyrjes se tregut, për interes dhe përfitim reciprok. Në shume rastë kjo mund të realizohet nëpërmjet Shoqatave të Tregtise, Organizatave të Mbrojtjes se Konsumatoreve apo organizmave të tjere të ngjashëm.

3.4) Standardizimi

Standardizimi është procesi i zhvillimit dhe pajtimit me standardet teknike. Një standard teknik është një dokument që krijon specifikime teknike ose inxhinierike uniforme, kriteret, metoda, procese apo praktika. Një nga qëllimet kryesore të standardizimit është të reduktojë pengesat teknike në tregtinë rajonale dhe globale, por mund të ketë qëllime të tjera të tilla si rritja e produktit dhe procesit të performancës, ose mbrojtjen e mjedisit

Organizmi formal i standardeve në Shqipëri është Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), përgjegjëse për të siguruar që procesi i zhvillimit të standardeve teknike përformohet në përputhje me rregullat dhe parimet e standardizimit European.

DPS përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe Europiane të standardeve, të tilla si ISO (Organizata Ndërkombëtare për Standardizim), IEC (Komiteti Ndërkombëtar i Elektroteknikës, CEN (Komiteti

European i Standardeve) dhe CENELEC (Komiteti European i Standardeve për Elektroteknikën). Ai nuk ka të drejtë votë në punën teknike të standardeve CEN, CENELEC and ISO si dhe ka të drejta votë të limituara (vetëm në katër Komitete Teknike) në IEC.

Shumica e standardeve teknike të publikuara nga DPS janë përshtatje që rrrjedhin nga standardet Europiane dhe ndërkombëtare (CEN & CENELEC and ISO & IEC). Mënyra e adoptimit është, kurdo që është e mundur, që të mos bëhen modifikime të tekstit origjinal të standardeve të publikuara nga këto organizata.

Në çdo projekt ndërtimi, nga një strukturë me një kat deri tek shumica e ndërtimeve shumëkateshe komplekse ose urave, standardet luajnë një rol kryesor në adresimin e çështjeve të rëndësishme që përfshijnë sigurinë, besueshmërinë, efijensën e energjisë, qëndrueshmërinë dhe ekonominë.

Adoptimi i standardeve të harmonizuara është prioritet i punës së DPS dhe publikimi i tyre bëhet duke ndjekur ritmin e publikimeve të standardeve Europiane të harmonizuara. DPS siguron rreth 1200 standarde në fushën e ndërtimit dhe të gjitha standadet e harmonizuara nën Direktivën 89/106/EC (CPD) të publikuar deri tani. Puna teknike për zhvillimin dhe adoptimin e standardeve në fushën e ndërtimit bëhet nëpërmjet pesë Komiteteve Teknike, në të cilën DPS mban sekretariatit.

Këto standade të ndërtimit sigurojnë informacionë kritike dhe krijuese për prodhuesit, projektuesit, ndërtuesit, furnizuesit, shpërndarësit dhe mbulojnë:

- produktet dhe materialet, duke përfshire adhesivët, çimenton, betonin, materialet e ndërtimit, izolimin,
- produktet hidraulike, çatite, dritaret, dyert dhe produktet e drurit.
- aplikime të tilla si metodat testuese, saldimet, proceset e ndërtimit dhe shërbimet hidraulike
- projektim, duke përfshirë limit states design, projektim të strukturave duke përdorur materiale specifike (të tillë si alumin, beton, hekur ose dru), dhe projektim të strukturave të tilla si ura dhe garazhe.

Adoptimi i Eurokodeve EN si standarde Shqiptare (shiko gjithashtu 5.4.4) do të fillojë kur Anekset Kombëtare, të cilat përmbajnë informacion mbi Parametrat e Përcaktuar Kombëtar, të përcaktohen nga ministritë përgjegjëse. Megjithatë, me qëllim që të thejshëzojmë punën me Eurokodet EN, DPS ka krijuar një komitet pasqyrë ndaj CEN/TC 250 “Eurokodet Strukturale EN”, anëtarësia e së cilës është e hapur ndaj të gjitha palëve të interesuara. Kryetari është zgjedhur nga Fakulteti i Inxhinierisë Civile dhe sekretariati mbahet nga DPS. Anëtarët e Komitetit Teknik -TC 250 janë përfaqësues nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT) dhe nga fakulteti i sipër përmendur.

Seksioni 4

SECTION 4: CPD në praktikë

4.1) Përftimi i markës së konformitetit

a) Hyrje

Pasi një prodhues kupton që i kërkohet, ose dëshiron të aplikojë një markë të konformitetit tek produkti i tij (shiko 4.1 e), ai duhet të kalojë procesin e aplikimit të Standardit European (ky seksion nuk mbulon rrugën e përftimit të Aprovimit Teknik). Aspektet e ndryshme të këtij procesi përshkruhen nga Dokumenti Udhëzues por, në përgjithësi, ato përfshijnë:

- identifikimin nëse produktet janë brenda fokusit të një ose më shumë prej Standardeve Europiane të harmonizuara dhe nëse po, cilat prej tyre;
- identifikimin e tregut të synuar dhe përdoruesve finale dhe si rrjedhojë cilat karakteristika të produktit duhet të vlerësohen;
- kalimin e vlerësimit të procedurë së konformitetit, duke identifikuar vertetimin e duhur të sistemit të konformitetit, dhe nëse është e domosdoshme, duke iu përqasur edhe organizmave të autorizuara/notifikuara;
- përgatitja e një deklaratë të konformitetit (dhe nëse është e nevojshme përftimi i një certifikatë të konformitetit), e cila u jep të drejtë prodhuesve të përdorin markën e konformitetit.

Secila prej këtyre hapave është trajtuar më poshtë.

b) Produktet brenda fokusit të Standardit European të harmonizuar

Qëllimi i cdo Standardi European është përfundimtar dhe i qartë, me deklarata të tilla si: “Standardi European mbulon.....” dhe “Ky Standard European nuk mbulon.....”. Shtrirja mund të jetë e kufizuar nga një sërë kërkesash normative (p.sh. Ky standard aplikohet tek produktet prej 9 mm ose më të trasha), por produktet nuk duhet të përjashtohen nga një standard nëpërmjet një kërkesë performace të dhënë brenda këtij fokusi. Për sa kohë një produkt është i përfshirë brenda këtij fokusi, prodhuesi duhet të aplikojë standardin.

c) Tregu i synuar dhe përdorimi final

Prodhuesit kanë nevojë të kenë parasysh që detajet e dhena me markën e konformitetit mund të jenë relevante për vendin e përdorimit të synuar. Prodhuesi rekomandohet fuqishëm që të familiarizojë veten me kërkesat ligjore në vendin e përdorimit final për t’u siguruar që që marka e konformitetit është ajo e duhura për tregun (karakteristikat korrekte /nivelet e deklaruara) për atë treg. Në shumë raste, prodhuesi do të verifikoje kushtet më të vështira dhe kërkesat e performancës me cdo vend me të cilin ai tregton, dhe duke i përmbushur këto, ai sigurohet gjithashtu që do të plotësojë kushtet me pak të vështira në vendet e tjera. Është fakt i njohur, megjithatë, që prodhuesit ndonjëherë deklarojnë nivele më të ulëta të performancës dhe jo aq sa janë të aftë të përftojnë produktet e tyre, me qëllim që të konkurojnë me produkte të tjera të cilat kanë nivel më të ulët.

Tabela e mëposhtme dhe teksti shoqërues është marrë nga një Standard European ekzistues dhe ajo tregon të gjitha karakteristikat për produktin (një tavan i varur në këtë rast) e cila ka lidhje me Kërkesat Thelbësore të punimeve në të paktën një vend të BE. Me qëllim që të përftojë markën e konformitetit, prodhuesi ka nevojë të vlerësojë dhe të deklarojë disa ose të gjitha karakteristikat. Fatkeqësisht, standardet nuk tregojnë se cilat karakteristika kërkohen në cilat vende ose dhe për çfarë përdorimesh të synuar, kështu që kjo është dicka që prodhuesi ka nevojë ta identifikojë për veten e tij.

Produkt Ndërtimi: Pjesë të tavanit të varur
 Përdorimi i synuar: Të ndërtohet një tavan i varur i brendshëm

Table ZA.1 – Rastet relevante për pjesët e tavanit të varur

Karakteristikat thelbësore	Rastet e Kërkesës në këtë standard	Nivelet e mandatuara dhe/ose klasat	Shënimet
Reagimi kundrejt zjarrit	4.4.2.1	Klasat A1 deri tek F	
Rezistenca kundrejt zjarrit	4.4.1	Shiko EN 13501-2	
Çlirimi i asbestit	4.5.1	Përfshin rastin e përmbajtjes zero	
Çlirimi i formaldehide	4.5.2	Klasat E1 dhe E2	

Karakteristikat e shkaterrimit (thyerje e sigurte)	4.3.6 and 4.6.1	-	
Forca e përkuljes elastike	4.6.2	-	
Kapaciteti i mbajtjes së ngarkesës - tolerancat dhe dimensionët	4.3.2, 4.3.3 and 4.3.4 4.2	- -	
Siguria Elektrike	4.6.3	-	
Izolimi i tingullit të drejtpërdrejtë të transmetuar në rruge ajrore	4.7.3	-	
Absorbimi i tingullit	4.7.2	-	
Përçueshmëria Termike	4.10	-	
Qëndrueshmëria	4.8	-	

Kërkesa mbi një karakteristikë e treguar në tabelën ZA.1, nuk është e aplikueshme në ato vende antare ku nuk ka kërkesa rregullatore për atë karakteristikë për përdorimin e synuar të produktit. Në këtë rast, prodhuesit që hedhin produktet e tyre në tregun e këtyre vendeve antare nuk janë të detyruar të përcaktojnë ose deklarojnë performancën e produkteve të tyre në lidhje me këtë karakteristikë dhe mund të përdoret opsioni “Jo performance e përcaktuar” (NPD) në informacionin shoqërues të markës CE (shiko ZA.3). Ky opsion (NPD) mund të mos përdoret, megjithatë, ku karakteristika është subjekt i nivelit kufi.

Standardet e CPD sigurojnë një mundësi të rëndësishme, të treguar në tekstin poshtë tabelës së mësipërme, e njohur si “Jo performance të përcaktuar (NPD)”. Kjo mund të përdoret ku prodhuesi nuk ka ndërmend që produkti i tij të përdoret për një qëllim final ku një karakteristikë e vecantë do të ishte e domosdoshme dhe/ose që ajo karakteristike nuk mbulohet nga kërkesat rregullatore për të gjitha, ose disa përdorime të vecanta. Nëse një prodhues vendos mos të deklarojë një karakteristikë e cila është subjekt i rregullave për të gjithë përdorimet finale, në një vend të caktuar, ai përsëri mund të fitojë në parim markën e konformitetit dhe të hedhe produktin e tij në treg në atë vend, por produkti nuk mund të përdoret në të njëjtin vend.

Disa standarde përmbajnë “vlerat kufi” përkundrejt një ose disa karakteristikave, të cilat përfaqesojnë vlerat minimale (ose maksimale) të cilat nuk mund të kalohen nga ndonjë produkt që deklaron konformitetin me ato standarde. Në rastë të tilla, opsioni NPD nuk mund të përdoret dhe produkti duhet të ketë së paku nivelin kufi. Përveç kesaj, pak standarde identifikojnë disa karakteristika të cilat duhet të deklarohen për të gjitha përdorimet finale të synuara, dhe në keto rastë përsëri, prodhuesi nuk mund të përdore NPD-në. Si një përcaktim final, për të gjitha karakteristikat e treguara në tabelë si ajo më sipër, prodhuesi duhet gjithnjë ose të deklarojë një vlerë ose të deklarojë NPD, ai nuk mund të mos thotë asgjë sikur kjo të ishte ekuivalente e NPD.

Nga shembulli i tabelës së mësipërme (edhe pse kjo nuk mund të njihet nga teksti i treguar këtu) ka një karakteristikë e cila duhet të ketë gjithnjë një deklaratë të performancës për të, dhe kjo është kapaciteti i mbajtjes së ngarkesës dhe tolerancat mbi dimensionet. Arsyeja për këtë është që tavanit i varur duhet të suportojë peshën e tij, dhe struktura e tavanit duhet të jetë e tillë që panelet e përdorura të tavanit nuk bien, dhe të dyja këto janë të mbuluara nga dy karakteristika të mbajtjes së ngarkesës.

Shumica e karakteristikave të tjera janë “opsionale” në varësi të përdorimit final të produktit (vereni se: p.sh. të gjitha produktet e ndërtimit të shitura në Gjermani duhet të kenë së paku reagimin kundrejt zjarrit të klasit E, kështu që një tavan në të cilin reagimi kundrejt zjarrit ishte deklaruar si i klasit F (ekuivalent i NPD për reagimin kundrejt zjarrit) nuk mund të përdoret në Gjermani. P.sh. karakteristikat e rezistencës kundrejt zjarrit, izolimit të zhurmës, absorbimit të zhurmës dhe përcjellshmërisë termike do t’ju nevojitej vetëm një deklaratë performancë nëse prodhuesi kishte ndërmend që tavanit të përdorej në kushtet kur ai i kontribuonte rezistencës ndaj zjarrit në dyshe dhe çati nën të cilën është instaluar tavanit, apo performancës akustike, ose nëse ajo kishte si synim përmirësimin e performancës termike. Nëse ky nuk është rasti, prodhuesi mund të përdorte NPD kundrejt të gjithë këtyre karakteristikave.

Një vend mund të mos refuzojë në përgjithësi aksesin e një produkti në tregun e tij për arsye se prodhuesi ka zgjedhur të përdorë NPD përkundrejt një ose disa karakteristikave. Kjo ndodh sepe në të shumtën e rasteve është e vështirë të identifikohet një karakteristikë e cila është subjekt i kërkesave rregullore në të gjithë përdorimet finale të mundshme. Në të njëjtën kohë organizmat autorizuese/notifikuese (shiko më poshtë) nuk mund të detyrojnë prodhuesit të vlerësojnë dhe deklarojnë disa karakteristika nëse vetë prodhuesit janë të kënaqur që përdorimi i NPD do të korrespondojë me përdorimin e synuar të produktit. Të vetmet përjashtime të mundshme në këtë rregull janë reagimet ndaj zjarrit në disa vende, sikurse shpjegohet më sipër, dhe substancat e rrezikshme. Të gjitha vendet anëtare të BE-se tani mund të ndalojnë disa substanca (p.sh. asbesti) nga të gjitha pjesët e zinxhirit të furnizimit, kështu një prodhues që deklaron NPD

kundrejt një substance të rrezikshme të ndaluar në një ose shumë vende, nuk do të lejohej të hidhte produktin e tij në treg, edhe pse ai do të kishte markën e konformitetit.

Një tjetër përcaktim në lidhje me karakteristikat e deklaruara ka nevojë të spjegohet. Shumë standarde sigurojnë një diapazon të niveleve të ndryshme të performancës kundrejt disa karakteristikave, ose ato përmbajnë klasa (p.sh. për performancën e zjarrit). Performanca e çdo produkti është e pandarë nga ai produkt, në varesi të p.sh. projektimit dhe materialit bazë të përdorur, dhe prodhuesi mund të deklarojë vetëm nivelin ose klasën e performancës së përcaktuar nga Testimi i Tipit Fillestar. Mbi këtë bazë, ai ka të drejtë të përdorë markën e konformitetit dhe të hedhe produktin e tij në tregun e të gjitha vendeve. Megjithatë, produkti i tij nuk mund të përdoret në një situatë të një përdorimi final ku rregullat kërkojnë një nivel ose klasë më të lartë të performancës sesa ajo e deklaruar. Të marrim një shembull specifik, tavan mund të ketë një klasifikim të rezistencës së zjarrit EI 30 (që ruan integritetin dhe izolimin për 30 min). Ky tavan mund të përdoret në çdo situatë përdorimi final ku rregulloret e kërkojnë më pak se 30 min (vetëm nëse p.sh. dyshemesë në fjale i janë bërë ndryshime të tjera për të përmbushur kërkesat për kombinimin-dysheme-tavan).

Për produktet e shitura në tregun Shqiptar, mund të mos jetë gjithnjë e mundur për prodhuesit (për sa kohe që sistemi i përgjithshëm rregullator për punimet e ndërtimit dhe produktet e ndërtimit është akoma duke u zhvilluar), të njohin ekzaktësisht cilat karakteristika të produkteve të tyre ata duhet të deklarojnë dhe cilat karakteristika ato mund të deklarojnë sipas dëshires. Ata mund t'i referohen udhëzuesve të projektimit ose dickaje të ngjashme ku këto ekzistojnë, por ndoshta ka shumë rastë ku udhëzues të tillë nuk ekzistojnë. Si një rregull i pranuar (por duke pranuar që është gjithnjë prodhuesi i cili është përgjegjës për deklaratat e bëra rreth produktit të tij), mund të thuhet që të gjitha ato karakteristika të cilat ka qenë vlerësuar dhe deklaruar në Shqipëri, dhe të listuara në tabelën e karakteristikave të harmonizuara në Aneksin ZA të standardeve, janë të njëjtat karakteristika sikurse duhet të deklarohen për të përmbushur dsipozitat e Ligjit Shqiptar të Produkteve të Ndërtimit dhe kërkesat lokale rregullatore Shqiptare.

Qartësisht, një prodhues që deklaron të gjitha karakteristikat ose një numër të madh të karakteristikave do të maksimizojë përdorimin final të mundshëm tek të cilët produkti i tij mund të hidhet, dhe në mënyrë të ngjashme, një prodhues produkti i të cilit ka një performancë më të lartë kundrejt një ose disa karakteristikave, ka gjasa që të fitojë një avantazh komercial kur krahasohet me produktet që kanë nivele më të ulëta performace.

CPD ka një kërkesë për prodhuesit që vlera specifike ose klasa e performancës të deklarohet me markën CE dhe si rrjedhojë ky informacion është i vlefshëm për blerësit potenciale dhe specifikuesit. Ky fakt mund të ketë si efektë pozitive ashtu

edhe negative. Në aspektin pozitiv, ajo lejon blerësit që të krahasojnë direkt një produkt me një tjetër mbi bazën e performancës teknike dhe gjithashtu i lejon blerësit që të blejnë vetëm ato produkte që kanë nivelin ose klasën e duhur të performancës për të përmbushur kërkesat rregullatore specifike të cilat aplikohen tek ato produkte në një ndërtesë ose punim inxhinierik civil. Në aspektin negativ, ajo i lejon blerësit të fillojë të kërkojë vlerësimin e karakteristikave të cilat mund të mos jenë të nevojshëm dhe mund të çojë në prezumimin që produktet me performancë më të lartë janë automatikisht më të mira se të tjerat. Është roli i prodhuesve që të diskutojnë me klientët këto efekte negative të mundshme, dhe të sigurojnë që produktet, të cilat përpara markës së konformitetit, ishin konsideruar krejtësisht të pranueshme, të mbeten të tilla, dhe të shmangë pasojat e mundshme të specifikimeve të tepërta.

Në shumë raste, detyrimet mbi prodhuesit shtrihen në Standardet Europiane të harmonizuara dhe, përveç vendimeve rreth NPD, nëse prodhuesi ndjek dispozitat e standardit, ai do të ketë përmbushur kërkesat ligjore të imponuara mbi të nga CPD-ja. Në pak raste, kuptimi i standardit mund të jetë i paqartë ose prodhuesi mund të mos dije se cilat karakteristika të deklarojë. Nëse ndeshen me situata të tilla, prodhuesit duhet që më mirë fillimisht të sqarojnë (p.sh. nëpërmjet Shoqatave të tyre ose Organizmit kombëtar të Standardeve (DPS), sesa ta injorojnë dipozitën në standard.

d) Vlerësimi dhe vërtetimi i konformitetit

Vlerësimi i konformitetit (EoC), sikurse shpjegohet në kapitullin 2.2, është procesi nga i cili derivojnë karakteristikat dhe performanca e produktit kur përdorim Testimin e Tipit Fillestar (ITT) të cilat pastaj ruhen nëpërmjet kontrollit të prodhimit në fabrikë (FPC). Çaktimi i dispozitave të vlerësimit të konformitetit (EoC) tek standardet, siguron që të gjithë prodhuesit konkures të operojnë me procedura ekuivalente, të domosdoshme për të krijuar një treg të hapur dhe të drejtë, dhe që të gjitha produktet konkuresive të vlerësohen duke përdorur të njëjtat metoda testimi, dhe si rrjedhojë rezultatet nga një prodhues mund të krahasohen drejtpërdrejt me ato të një prodhuesi tjetër.


Për të përmbushur kërkesat e CPD, prodhuesi duhet të operojë një sistem FPC (kontrollin e prodhimit në fabrikë) me qëllim që të përmbushë kërkesat për markën CE, si dhe ka nevojë të kryhen disa ITT (testime të tipit fillestar) mbi produktin me qëllim që të përcaktojë performancën e tij. Dispozitat EoC (vlerësimit të konformitetit) mundet gjithashtu të aplikohen për karakteristikat e tjera dhe kërkesat e përfshira në standard, por të cilat nuk janë pjesë e kërkesave të markes CE, kështu që rastet e EoC (vlerësimit të konformitetit) janë të shkruara në pjesen normale (normative) të standardit.

Nuk është praktike ose e domosdoshme që të jepen shembuj specifikë të

dispozitave të EoC (vlerësimi të konformitetit) sepse secila prej tyre është specifike. Megjithatë, një konsideratë e përgjithshme mund të jetë e dobishme, që i referohet vlerës se një karakteristike të cilën prodhuesi mund ta deklarojë si rezultat i ITT (testimit të tipit fillestar). Shumë standarde specifikojnë që vetëm një numer i kufizuar i produkteve kanë nevojë të testohen për ITT (ndoshta tre) të cilat të çojnë në devijime të mëdha të standardit dhe mund të japë një vlerë jo të dëshirueshme nga ajo çfare pret prodhuesi. Devijimi i standardit mund të përmirësohet duke bërë teste të mëtejshme dhe nëse prodhuesi e di nga eksperienca që rezultatet e ITT janë zakonisht jo të mira, ai këshillohet që të deklarojë një vlerë disi më të ulët në mënyrë që të sigurojë që produktet e tij të kenë vlerë reale nëse do hasen probleme. Rezultatet jo të kënaqshme të deklaruara, mund të jenë gjithnjë më të ulta se rezultati jo i mirë që rrjedh nga ITT por nuk mund të jenë më të larta sepse prodhuesi duhet të ketë një rezultat ITT e cila justifikon vlerën e deklaruar.

Ndryshe nga vlerësimi konformitetit, përmendur më sipër, i cili përshkruan çfarë nevojitet që të bëhet për të demonstruar që një produkt përmbush kërkesat e një standardi, vertetimi i konformitetit i përgjigjet pyetjes “Kush duhet ta bëjë këtë?. Përsa i përket CPD-se, vertetimi i konformitetit gjithmonë përfshin prodhuesin dhe mundet, në varësi të tipit të produktit dhe përdorimit të tij final, të përfshijë një ose disa organizma notifikuese (shiko më sipër 2.3)

E shprehur në mënyrë të thjeshtë, një prodhues që kërkon markën e konformitetit duhet të lexojë tabelat që përshkruajnë sistemet (AoC-vertetimi i konformitetit) i cili mund të aplikohet (në atë rast ku standardi jep një zgjedhje), tek produkti i tij i veçantë, të vendosë midis mundësive se cili sistem aktualisht aplikohet tek produkti i tij dhe pastaj, nëse është e nevojshme, dhe t’i drejtohet një ose më shumë organizmave të autorizuar/notifikuar. Dy grafikët e mëposhtëm tregojnë procedurën të cilën duhet të ndjekë prodhuesi për produktet të cilat janë nën sistemin AoC 1 dhe 4 (shembujt për sistemin 2 dhe 3 janë dhënë në kapitullin 2.3). Në këto grafikë vijat e plota tregojnë rrugën që duhet ndjekur gjithnjë, ndërsa me vija të ndërprera tregohen rrugët e mundshme, në varësi se si është përkufizuar sistemi AoC në një hEN të veçantë (standartet Europiane të harmonizuara).



Produktet nën sistemin AoC 1+ or 1

Produktet nën sistemin AoC System 4

Figure 4.1 - Grafikë për aplikimin e vertetimit të sistemit të konformitetit Systemet 1+/1 and 4

e) Deklarata dhe çertifikata e konformitetit, dhe marka CE

Pasi është kaluar me sukses procesi i vlerësimit dhe vertetimit të konformitetit, prodhuesi duhet të përgatisë gjithnjë një deklaratë të konformitetit e cila, nëse sistemi AoC ka përfshirë një organizem certifikues, do të përmbajë referencën e një çertifikatë të konformitetit të marrë nga ky organizem. Kjo deklaratë është, në fakt, prova e prodhuesit që produkti i tij përmbush dispozitat e hEN dhe që ai ka të drejtë të përdorë simbolin e markës së konformitetit.

Nuk ka një 'model' të vecantë të deklaratës dhe certifikatës së konformitetit që duhet ndjekur, por përmbajtja e këtyre dokumenteve është treguar në Anëksin ZA.2 për të gjitha standardet e harmonizuara. Ndërmjet të tjerave, dokumentat do të identifikojnë prodhuesin dhe standardin që është aplikuar, dhe deklarata i referohet raporteve të ITT dhe rekordeve të FPC.

Deklarata dhe certifikata e konformitetit janë dokumenta të cilat duhet të mbahen nga prodhuesi. Ashtu si edhe informacioni i markës CE (më poshtë), që duhet të qarkullojë me produktin, deklarata ose certifikata nuk ka nevojë të shoqërojë produktin. Ato duhet t'u paraqiten autoriteteve të mbikëqyjes së tregut, nëse ka ndonjë dyshim rreth konformitetit të produktit.

Pasi ka përgatitur deklaratën e konformitetit, prodhuesi mundet pastaj të përgatisë markën e konformitetit për produktin e tij. Rregullat se çfarë duhet të shoqëroje marka e konformitetit janë dhënë në Anëksin ZA.3 për çdo standard të harmonizuar të produktit, dhe kjo pjesë e Anëksit A deklaron ekzaktësisht se çfarë duhet të tregojë prodhuesi dhe çfare mundësish ka ai; ndaj edhe prodhuesi i duhet vetëm të ndjekë instruksionet. Megjithatë, më poshtë jepen disa parime mbi të cilat këto instruksionë janë mbështetur dhe më pas jepet një shembull (4.2 në këtë dokument udhëzues tregon parimet dhe shembujt e leximit dhe të kuptimit të informacionit të markës së konformitetit).

CPD kërkon që informacioni i markës CE të jepet në një nga katër vendet: mbi vetë produktin, mbi etiketën e ngjitur tek produkti, mbi paketimin ose në dokumentin shoqërues. Ka një numër parimesh dhe kërkesash që aplikohen në informacionin e dhënë bashkë me simbolin e markës CE:

- ai duhet të përfshijë emrin e prodhuesit;
- ai duhet të përfshijë: numrin unik të identifikimit të organizmit të çertifikimit (produktit ose FPC) për produktet nën kuadrin e Sistemit të vërtetimit të konformitetit 1+, 1 dhe 2+, dy shifrat e fundit të vitit kur është vendosur simboli i markes CE dhe numrin e çertifikatës së konformitetit;
- ai duhet të përfshijë numrin e standardit European të produktit dhe një përshkrim të produktit (të tillë si emri i përgjithshëm, materialet,

dimensioni dhe përdorimi final);

- ai do të japë (gati në të gjithë rastet), informacionin e performancës për të gjitha karakteristikat për të cilat prodhuesi dëshiron të deklarojë një vlerë, dhe NPD për të tjerat;
- nuk ka aktualisht rregulla se në cilën gjuhë duhet të jepet informacioni i markës CE. Megjithatë, meqenëse informacioni duhet të jetë i kuptueshëm për autoritetet zbatuese të ligjit në treg në vendin e destinacionit (dhe vetëm nëse prodhuesi ose është i sigurtë që ekziston një gjuhë e vetme, si anglishtja, që kuptohet, ose simboli apo sistemi i përcaktimit që përdoret, nuk kërkon përkthim), prodhuesi rekomandohet të konsiderojë përdorimin e gjuhës ë vendit të destinacionit.

Për informacion në lidhje me karakteristikat thelbësore, përsëri zbatohen disa parime:

- Informacioni mund të jepet në formën e vlerave të deklaruara dhe, kurdo që është relevante, niveli ose klasa (që përfshin “kalon” për kërkesat “kalon/dështon”, ku nëvojitet) dhe “Shënime” në tabelen ZA.1 duhet të tregojë formën. Opsioni “Nuk përcaktohet performanca” (NPD, shiko 4.1c) mund të përdoret për karakteristikat në ato rastë që është relevante.
- Nëse standardi siguron vlerën e pragut, dhe vetëm nëse standardi në mënyrë specifike siguron të kundërtën, prodhuesi duhet të jetë i aftë të deklarojë vlerën e njëjtë ose më të mirë sesa ajo e pragut.
- Informacioni teknik jepet zakonisht me simbolin e markës CE. Megjithatë, nëse njihet performanca kundrejt një ose disa karakteristikave nga leximi i standardit (të tillë si kur standardi kërkon që produkti “kalojë” një kërkesë të vecantë), këto karakteristika nuk ka nevojë që të tregohen (nëse ato kanë nevojë të tregohen ose jo do të qartësohet në vetë tekstin e standardit);
- Në rastet kur një standard ofron me shume se sa një metodë vleresimi/ testimi apo kushte testimi, dhe keto metoda ose kushte ndikojnë tek rezultati, atehere metoda e testimit dhe kushtet e përdorura kanë nevojë të identifikohen së bashku me rezultatin e deklaruar.
- Disa teste (veçanërisht të zjarrit dhe akustikës), kërkojnë që produkti të testohet në kushtet e përdorimit të tij final (ose kushte që i përfaqësojnë keto); rezultatet janë pastaj të aplikueshme vetëm për këto kushte. Në këtë rast, kushtet e përdorimit final duhet të deklarohen si pjesë e informacionit të markës CE, prodhuesi mund të deklarojë rezultatë të ndryshme për kushte të ndryshme të përdorimit final.
- Disa produkte dhe set-e do të përmbushin performancën e deklaruar nëse

ato instalohen në një mënyrë të vecantë, përdoren me produkte të tjera ose trajtohen në disa mënyra pas instalimit (të tillë si lustrimi). Në këtë rast, informacioni i markës CE duhet të përmbajné detajet e kësaj, por nuk mund të garantojë që produkti do të instalohet ose trajtohet në mënyrë korrekte. Prodhuesi deklaron efektivisht “Produkti do të përformojë ashtu sic deklarohet nëse.....”por nëse produkti instalohet ndryshe, prodhuesi nuk mund të mbajë përgjegjësi nëse ai nuk përformon sic deklarohet.

Shembulli i mëposhtëm i markës CE (e cila vazhdon poshtë në shënimin 2) për shtresat metalike të çatisë, është marrë nga EN 14783. Ajo tregon një situatë ku prodhuesit i jepet një mundësi të zgjedhë se ku të tregojë informacionin, si edhe ilustron disa prej parimeve të përmendura më sipër. Shembulli në Figuren ZA.1 është për produktet të cilat klasifikohen pa patur nevojë për testime të mëtejshme (CWFT) për reagime kundër zjarrit e kështu me rradhë; megjithatë teksti tregon që, nëse produkti është testuar, do të duhej të tregoheshin kushtet e përdorimit final, në këtë rast treguesi “CWFT” jepet me markën CE, duke treguar që cdo kusht i përdorimit final i aplikueshëm mund të gjendet nga përshkrimi i CWFT i dhënë në vetë standardin. Të njëjtat dispozita aplikohen për performancën e jashtme të zjarrit por, në shembullin në Figuren ZA.1, produktet gjykohen që kënaqin Class B_{ROOF} pa nevojën e testimit, dhe kjo tregohet nga fakti që nuk jepet informacion për kushtet e përdorimit final.

“(Fillimi i shembullit) ZA.3 Etiketimi dhe marka CE

Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar brënda EEA, është përgjegjës për vendosjen e markës CE. Vendosja e simbolit të markës CE duhet të jetë në përputhje me Direktivën 93/68/EC dhe të tregohet mbi produkt, paketim ose dokumentin shoqërues komercial.

Informacioni i mëposhtëm që vendoset mbi produkt dhe kërkesat thelbësore (tabela ZA.1) mund të shoqërojnë simbolin e markës CE. Kur i gjithë ky informacion nuk jepet as në produkt as në paketim, atëherë duhet të jepet në dokumentat shoqërues komerciale:

- Emri ose shenja identifikuese e prodhuesit;
- Fabrika e prodhimit;
- Dy shifrat e fundit të vitit në të cilën është vendosur simboli;
- Referenca ndaj këtij Standardi European p.sh. EN 14783;
- Përshkrimi i produktit: emri i përgjithshëm, materiali, dimensionimi..... përdorimi final
- Reagimi kundrejt zjarrit;

Shënim 1 Kur klasifikimi i produktit në përputhje me EN 13501-1 i korrespondon klasifikimit pa testim të mëtejshëm në përputhje me Vendimin e Komisionit, atëherë “(CWFT)” i shtohet klasifikimit të reagimit ndaj zjarrit.

- Përformanca e jashtme e zjarrit, nëse është relevante;
- Qëndrueshmëria.

Kur produktet janë testuar për të vlerësuar performancën e reagimit ndaj zjarrit, prodhuesi do të specifikojë kushtet e ngjitjes dhe vendosjes në lidhje me testimin SBI. Informacioni do të jepet ose nëpërmjet markës CE ose nga referenca e dokumentit, e mbajtur nga prodhuesi, i cili përshkruan kushtet e përdorimit final.

Kur produktet janë testuar për të vlerësuar performancën e jashtme të zjarrit, prodhuesi do të specifikojë kushtet e përdorimit final (tipin e nënshtresës, llojin dhe trashësinë e izolimit, metodën e mbërthimit, etc,) sikurse jepen në raportin e testimit. Informacioni ose do të jepet me markën CE ose nga referenca tek dokument, i mbajtur nga prodhuesi, i cili përshkruan kushtet e përdorimit final.

Opsioni NPD (Klasi F për reagimin kundër zjarrit ose F_{ROOF} për performancën e jashtme të zjarrit) mund të përdoret kur dhe ku karakteristika për një përdorim të synuar nuk është subjekt i kërkesave rregullatore.

Figura ZA.1 jep një shembull të informacionit që duhet dhënë me markën CE.

	Marka e konformitetit CE, konsiston në simbolin “CE” të dhënë në Direktivën 93/68/EEC
AnyCo Ltd, PO Box 21, B-1050 07	Emri ose shenja identifikuese dhe adresa e regjistruar e prodhuesit Dy shifrat e fundit të vitit në të cilin është vendosur marka
EN 14783 Produkte me mbështetje të plotë metalike që përdoret për mbulesat e çatave Shtresa hekuri - 2 000 mm x 3 000 mm x 0,63 mm - DX52D+Z275 - Polyester 25 µm - EN 505 Reagimi ndaj zjarrit: Klasi A1 (CWFT) Përformanca e jashtme e zjarrit: Klasi $B_{ROOF(t1)}$, Klasi $B_{ROOF(t2)}$, Klasi $B_{ROOF(t3)}$ dhe Klasi $B_{ROOF(t4)}$ Qëndrueshmëria: Shtresa Z275-Polyester 25 µm	No. i Standardit European Përshkrimi i produktit dhe informacioni mbi karakteristikat

Figura ZA.1 – Shembulli i informacionit që shoqëron markën CE, për një produkt të klasifikuar pa testime të mëtejshme (CWFT) për reagime ndaj zjarrit dhe “të gjykuara të kënaqshme” për performancën e jashtme të zjarrit, pa substanca të rrezikshme dhe si i tille nën sistemin 4 të AoC

Në vijim të cdo informacioni specifik në lidhje me substancat e rrezikshme të treguara më sipër, produkti duhet të shoqërohet gjithashtu, kur dhe ku kërkohet në formën e duhur, nga dokumenti që liston cdo legjislacion tjetër mbi substancat e rrezikshme për të cilat është deklaruar përputhshmëria, së bashku me cdo informacion të kërkuar nga ai legjislacion.


Shënim 2 Nuk ka nevojë të përmendet legjislacioni European pa derogim kombëtar. (Fundi i shembullit)


4.2) Kuptimi i Markës CE

Siç është spjeguar tashmë në këtë Dokument Udhëzues, e dhena shoqëruese të simbolit të markës CE për produktet e ndërtimit është e rëndësishme, sepse ajo paraqet informacionin e performancës rreth produktit, i cili mund të kufizojë përdorimet e mundshme ose të përcaktojë përdorimin final të cilin mund të ketë produkti. Ky nën-seksion jep disa shembuj për të ilustruar këtë parim, si nga pikëpamja e përdoruesve të produkteve, ashtu edhe për mbikqyrjen e tregut

Në shumë raste, kuptimi i plotë i informacionit të dhënë mund të kuptohet vetëm duke lexuar standardin vetë, në vijim të kërkimit mbi informacionin e markës CE. Gjithashtu, përdoruesit duhet të jenë të vetëdijsëm se informacioni i dhënë në produkt, mbi etiketën e ngjitur tek produkti apo tek paketimi, mund të mos jetë informacioni i plotë (vini re se shembujt e dhënë nuk janë domosdoshmërisht të vërtetë, por janë përshtatur për të treguar disa nga parimet e përfshira në markën CE).

Dy shembujt e parë mbulojnë profilet plastike të përdorura në ndërtesa, të bashkuar cep me cep për të formuar një mur në vazhdim ose pjesën e brendshme të tavanit.


Cdo kompani sh.p.k , PO Box 21, B-1050 05
EN 13245-2 PVC-UE profile për përdorim të brendshëm Reagimi ndaj zjarrit : D-s3,d2/AVG Instalimi: Ngjitur në hapësirë ose e vidhosur Rezistanca ndaj ndikimit : 500 g Qëndrueshmëria: Kodi (23,10)



Numri i Çertifikatës 26845 Çdo kompani sh.p.k , PO Box 21, B-1050 05 Kompania e Çertifikimit Taipei, 02865-CPD-26845
EN 13245-2 PVC-UE profil për përdorim të brendshëm Reagimi ndaj zjarrit: D-s3,d2/AVM Instalimi: Ngjitur në hapësirë ose e vidhosur Rezistenca ndak ndikimit: 600 g D Qëndrueshmëria: Kodi (23,10)


Për një sy të pastërvitur, këto dy produkte shfaqen si të ngjashme përsa i përket performancës, por kjo ka nevojë për një investigim të mëtejshëm. Të dy produktet deklarohen klasën e reagimit ndaj zjarrit si D-s3,d2 (s3 dhe d2 i referohen prodhimit të duhanit dhe nën klasifikimin e pikëzave), por njëra tregon “AVM” ndërsa tjetra “AVG”. Duke parë vetë standardin (EN 13245-2), AVM nënkupton që produkti është testuar vertikalisht, i fiksuar me lidhëse mekanike me një të hapsire ajri ndërmjet profilit dhe murit, ndërsa AVG nënkupton që produkti është testuar vertikalisht por i ngjitur tek spesorët. Kjo diferencë është e rëndësishme sepse standardi tregon që rezultati i produktit të ngjitur të testuar gjithashtu aplikohet tek i njëjti produkt i lidhur mekanikisht por jo anasjelltas. Prandaj informacioni në të majtë është korrekt; produkti do të arrijë klasën D-s3, d2 të reagimit ndaj zjarrit, nëse ajo është e ngjitur ose e lidhur mekanikisht. Megjithatë, informacioni në të djathtë është potencialisht keq orientues, prodhuesi deklaron klasen D-s3, d2 të lidhjes mekanike të testuar dhe akoma duhet të thotë që produkti do të arrijë të njëjtin klas edhe nëse është i ngjitur, e cila mund të mos jetë keshtu. Nëse produkti në të djathtë do të ishte i instaluar me ngjitje, nuk ka garanci që ai do të arrinte klasën e deklaruar të reagimit ndaj zjarrit.

Atëhere cila performon më mirë kur rezistenca që ndikon në rezultatin e testimit duket të jetë e ngjashme? Këtu është relativisht e dukshme; një kampion i masave të ndryshme hidhet nga një lartësi e caktuar dhe profili nuk duhet të shpohet, kështu që sa më e madhe masa e deklaruar, aq më e mirë rezistenca ndaj impaktit. Për disa produkte shifrat mund të jenë respektivisht “10 mm” dhe “15 mm” ose “200 mm” dhe “300 mm” dhe mund të gjykohej (në mënyrë të gabuar) që produkti i dytë të jetë gjithmonë më i mirë. Por në rastin e parë, dimensionimi ka të bëjë me diametrin e kampionit dhe për këtë arsye sa më i vogël të jetë diametri, aq më i mirë është produkti, ndërsa në rastin e dytë dimensionimi i referohet lartësisë së rënies, kështu që sa më e lartë të jetë vlera aq më e mirë do të ishte në të vërtetë. Ky fakt megjithatë mund të njihet duke lexuar vetë standardin.

Për më tepër, një sy i stërvitur do ta dallonte menjëherë që produkti në të djathtë ka një markë CE falso. Si fillim, prodhuesi deklaron numrin e produktit ose certifikatën e FPC (duke nënkuptuar sistemin 1 ose 2+ të Vertetimit të Konformitetit), dhe akoma produktet me reagim ndaj zjarrit të Klasit D janë në kuadrin e Sistemit 3 të Vertetimit të Konformitetit; kështu që nuk mund të ketë përfshirje të ndonjë organizmi certifikimi në këtë rast. Në vijim (megjithëse evidenca këtu është e dyshimtë dhe jo përfundimtare), të gjithë organizmat notifikuese duhet të kenë bazen në BE, kështu që Kompania e Certifikimit “Taipei” menjëherë tingellon si e pamundur. Ky rast përben një rast evident ku ka vend për ndërhyrje të mbikqyrjes së tregut.

Dy shembujt e tjerë janë (të thjeshtëzuar) për panelet sanduiç faqe metalike.

	
01234	
Çdo kompani sh.p.k, PO Box 21, B-1050 05 01234-CPD-00234	
EN 14509 Panel izolues me faqe metalike për përdorim në ndërtesa. Reference: KS1000. Izolimi : PUR. Densiteti: 35 kg/m ³ Siperfaqja: Celiku 0,5 mm nga jashte: 0,4 mm nga brneda (EN 10147). Veshja: PVC, mass: 12 kg/m ² . Përdorimi : Çatitë Transmetimi Termik: 0,25 w/m ² K Rezistenca mekanike: - Rezistenca në tërheqje 0,12 MPa - Forca shpernfdarese 0,10 MPa Reagimi ndaj zjarrit: B-s2,d0 (m e detaje të ndezjes së celikut) Rezistenca e zjarrit: E240, EI 15 (ngarkesa 1,5 KN) Performanca e zjarrit nga jashte: B _{ROOF} Depërtimi i ujit: Klasi C Qëndrueshmëria:Kalo - ngjyra të lehta: reflektimi 40-90	

	
01234	
Çdo kompani sh.p.k , PO Box 21, B-1050 05 01234-CPD-00234	
EN 14509 Panel izolues me faqe metalike për përdorim në ndërtesa. Përdorimi : Çatitë	

Përdorimi i shenjave në të dy rastet është korrekt dhe i ligjshëm, por ai i anës së majtë tregon të gjithë informacionin e gjetur tek dokumentat tregtare shoqëruese, kurse ajo që tregohet djathtas është ajo çfarë duhet të tregohet në paketim. Kur lexon këtë të fundit nuk kuptohet pothuajse asgjë. Informacioni nën frazvn EN 14509 në krahun e majtë përshkruan produktin, ai nuk përfaqëson informacion të harmonizuar. Për këtë arsye, pavaresisht se ka shume mundësi të jetë i saktë përderisa pjese tjetër e informacionit rreth markës CE është e rregullt, ai nuk “garantohet” nga simboli i markës CE në të njëjtën mënyrë si karakteristikat e tjera.

Do kishin rëndësi disa pika në lidhje me veçoritë ndaj zjarrit. Nuk janë dhënë kushte për montimin dhe fiksimin (M+F) për reagimin ndaj zjarrit, përvec asaj që mbajtëset ansore duhet të jenë prej celiku. Kjo do të nënkuptojë që prodhuesi

e ka testuar duke përdorur kushtet M+F të dhena tek EN 14509 dhe për këtë arsye, paneli duhet instaluar në të njëjtën mënyrë në praktike dhe e njëjta gjë vlen edhe për rezistencën ndaj zjarrit (nëse prodhuesi e ka testuar në kushtet e përdorimit final, kjo duhet treguar se bashku me markën CE dhe paneli duhet instaluar në të njëjtën mënyrë).

4.3) Burimet e Informacionit

Ka shumë burime informacioni në lidhje me BE, institucionët e saj, legjislacionin e saj dhe CPD dhe proceset e saj në veçanti. Me një kërkim në internet normalisht do të gjeni informacionin e nevojshëm. Ky nën-seksion, megjithatë, jep një përmbledhje të shkurtër mbi burimet kryesore të informacionit

Institucionet dhe dispozitat ligjore

Komisioni Europian: http://ec.europa.eu/comm/index_en.htm

Kesh. i Ministrave: <http://www.consilium.europa.eu/showPage.aspx?id=1&lang=en>

Legjislacioni Europian: <http://eur-lex.europa.eu/en/index.htm>

Direktivat e BE-së: http://ec.europa.eu/enterprise/regulation/goods/index_en.htm

Traktatet e BE-së: http://europa.eu/abc/treaties/index_en.htm

Të dyja, si website i legjislacionit Europian dhe direktivat e BE mund të përdoren për të gjetur tekstin e Direktivës së Produkteve të Ndërtimit 89/106/EEC. Gjithashtu për referencë, për mbikëqyrjen e tregut, është “Kudri i Ri Legjislativ”, Rregullorja 765/2008 mbi akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut në lidhje me markën e produkteve, dhe Vendimi 768/2008/EC (shiko më poshtë).

Direktivat e Përafrimit të Ri dhe Kudri i Ri Legjislativ

“Guida Blu” e BE, megjithëse tani është e rifreskuar, është konsideruar të jetë burimi kryesor i informacionit në lidhje me Direktivat e Përafrimit të Ri dhe aplikimit të tyre.

“Guida Blu” e BE “Një guidë për zbatimin e direktivave të mbështetura në Përafrimin e Ri dhe Globale”:

http://ec.europa.eu/enterprise/newapproach/legislation/guide/document/1999_1282_en.pdf

Kudri i Ri Legjislativ:

<http://ec.europa.eu/enterprise/policies/single-market-goods/regulatory-policies-common-rules-for-products/new-legislative-framework/>

Standardizimi dhe sektori i ndërtimit

Hartimi i Standardeve

<http://www.cenorm.be/sectors/construction>

BTS1 N888 Model Product Standard

BTS1 N888 Supplement No. 2 - Annex ZA

Dokumenta Udhëzues (shembuj):

- Përdorimi i formave të foljes në Standardet Europiane
- Udhëzues mbi përdorimin e modelit CEN/ISO
- Situata në mungesë të referencave normative
- Roli dhe përgjegjësitë e Komiteteve Teknike dhe konsulentëve të CEN
- Hartimi i dispozitave mbi Vlerësimin e Konformitetit (EoC)

Standarde të Harmonizuara:

http://europa.eu.int/comm/enterprise/newapproach/standardization/harmstds/index_en.html

Dokumenta Udhëzues të CPD

<http://europa.eu.int/comm/enterprise/construction/index.htm>

Tema udhëzuese:

- A - Përcaktimi i Organizmave të Aprovuara
- B - Kontrolli i Prodhimit në Fabrikës
- C - Trajtimi i kit-eve nën CPD
- D - Marka CE nën CPD
- E - Nivelet dhe klasat në CPD
- F - Qëndrueshmëria dhe CPD
- G - Sistemi i klasifikimit për kundërveprimin ndaj zjarrit
- H - Substancat e rrezikshme
- I - Aplikimi i Nenit 4(4) të CPD
- J - Rregullimet e Tranzitore
- K - Sistemi i Vertetimit të Konformitetit dhe detyrat e organizmave notifikuese
- M - Vlerësimi i konformitetit

Database përkatës i BE

Legjislacioni, standardet dhe organët notifikuese

<http://ec.europs/eu/enterprise/newapproach/nando/>

Database RAPEX (mbikëqyrja e tregut)

http://ec.europa.eu/consumers/dyna/rapex/rapex_archives_en.cfm

Akreditimi

ILAC: <http://www.ilac.org/>
IAF: <http://www.iaf.nu/>
APLAC: <http://www.aplac.org/>
PAC: <http://www.apec-pac.org/>
EA: <http://db.european-accreditation.org/>
UKAS: <http://www.ukas.com>

Burimet të tjera me interes të përgjithshëm

Shoqata e Tregtisë së Lirë të vendeve të Europës Qendrore (CEFTA): <http://www.cefta2006.com/>

CEN: <http://www.cenorm.be/cenorm/index.htm>

Zbatimi i markës CE të BE: <http://www.ce-mark.com/euen.html>

Rregulloret Mjedisore për SMEs: <http://www.nëtregs.gov.uk/nëtregs/help/59046.aspx>

çështjet e Konsumatorëve të BE GPSD:

http://europa.eu.int/comm/consumers/cons_safe/prod_safe/gpsd/revisedGPSD_en.htm

Informacioni me mbështetje në internët dhe Sistemi i Komunikimit për Mbikëqyrjen e Tregut pan-European të produkteve teknike (ICSMA): <http://www.icsms.org>

Seksioni 5

SECTION 5: Plani Kohor për CPD dhe sektorin e ndërtimit në përgjithësi në Shqipëri

5.1) Nevojat e zhvillimit (CPD)

Prezantimi i një direktive të BE në një vend pa një histori të një sistemi rregullator të zhvilluar ose të një sistemi të rregulluar pjesërisht, përbëhet prej dy pjesëve esenciale:

- “Transpozimi” = prezantimi i instrumentit ligjor,
- “Zbatimi” = sjellja e instrumentit ligjor në aplikimin e saj të plotë.

Transpozimi i CPD në ligj kombëtar është relativisht i lehtë dhe i shpejtë, dhe në të vërtetë CPD është adoptuar pjesërisht si një ligj Shqiptar. Megjithatë zbatimi, si një proces që fillon aktualisht ta aplikojë direktivën në praktikë, është detyrë shumë më e gjatë dhe e vështirë, që do të kerkonte shumë vitë punë si dhe përfshirjen e shumë aktorëve të ndryshëm të sektorit. Mund të konsiderohet që ekzistojnë katër fusha kryesore që kërkojnë zhvillim:

- Zhvillimi rregullator:
 - kompletimi i sistemit rregullator,
 - mbikëqyrja e tregut,
 - mbështetja e duhur teknike.
- Zhvillimi i Prodhuesve.
- Zhvillimi i Organizmave të Vlerësimit të Konformitetit.
- Zhvillimi i Konsumatorëve, dhe Përdoruesve dhe Specifikuesve.

Shqipëria ka planë planë për përfundimin e sistemit rregullator për produktet e ndërtimit (shiko seksionin më sipër 1.5) por të gjitha aspektet e tjera janë trajtuar në këtë nën seksion

Mbikëqyrja e Tregut nevojitet të sigurojë që:

- Të gjitha produktet janë të sigurta dhe që ato përmbushin kërkësat rregullatore (detyrimin mbi autoritetet për të mbrojtur qytetarët),
- Produktet e importuara si dhe të prodhimit vendas të përmbushin kërkësat rregullatore ekzaktësisht në të njëjtën mënyrë (duke shmangur shtrembërimin, konkurrencen jo të ndershme nga importet që nuk kanë vlerësimin e konformitetit si dhe ‘dumping’),
- Ndërmerren veprime kundër produkteve që nuk janë konform.

Këto detyrime rrjedhin si nga vetë CPD ashtu edhe Rregullorja relativisht e re e BE 765/2008, e cila është përgatitur për të fuqizuar sistemet e mbikëqyrjes së tregut në të gjithë BE. Ka ndoshta dy aspekte të mbikëqyrjes së tregut që duhen theksuar: së pari, që është ndoshta më i dukshmi, sistemi duhet të jetë operativ dhe të shikohet si i tillë sepse kjo jep sinjalin tek prodhuesit dhe importuesit që në tregun Shqiptar nuk ka me vend për produkte jo- konforme.

Së dyti, ngrihen pyetje në lidhje me afatet e Mbikëqyrje së Tregut dhe zhvillimin e prodhuesve Shqiptarë. Sigurisht, qëllimi afat-gjatë është të sigurohet që në tregun Shqiptar duhet të hyjnë vetëm produktet e ndërtimit që përshtaten me qëllimin e duhur. Por ka pak kuptim të pengosh hyrjen e produkteve pa standard nga importi nëse këto produkte vazhdojnë të prodhohen nga prodhues Shqiptarë. Në vijim, nuk ka kuptim që të përpiqemi të imponojmë kushtet e markës CE mbi prodhuesit Shqiptarë, nëse të njëjtat kushte nuk imponohen, pak a shumë në të njëjtën kohë, mbi importet me të cilat prodhuesit duhet të konkurojnë. Përfundimisht, mund të jetë e dëmshme për sektorin e produkteve Shqiptare të ndërtimit nëse autoritetet duhet të imponojnë standarde dhe marka konformiteti përpara se një shumicë prodhuesish vendas të mund t'i përmbushin kërkësat.

CPD-ja kërkon që prodhuesit të provojnë konformitetin e produkteve të tyre dhe kjo nënkupton që:

- Ata të fitojnë ekspëriencën e punës për të arritur Standardet Europiane:
- Ata të zbatojnë sistemet e kontrollit të prodhimit në fabrikë , i cili në vetvetë kërkon:
 - trainimin p.sh. në EN ISO 9001,
 - zhvillimin e Manualit të Cilësisë dhe Procedurat Specifike të Operimit, si dhe
- vënien në zbatim të sistemit
- Ata të krijojnë kontakte me Organet e Vlerësimit të Konformitetit.

Nënkuptohej lehtë që nëse prodhuesit duan të punojnë në përputhje me hEN, këto duhet të vihen në dispozicion në Shqipëri, dhe me rreth 475 standarde të harmonizuara të produkteve për produktet e ndërtimit dhe standarde mbështetëse rreth 1500-2000 të vlerësuara, kjo nuk është një detyrë e lehtë, nëse standardet duhet të përkthehen. Zgjidhja e mundshme për këtë vështirësi është të përshtatja e standardeve në një periudhë disa vjecare, duke futur paketat e standardeve (p.sh. hEN dhe të gjitha standardet e duhura mbështetëse), nga pak produkte të fushës në cdo kohë, duke u përqëndruar në një prioritet fillestar mbi ato produkte që mbartin rrezikun më të madh, ato të interesave ekonomike të rendësishme për Shqipërinë (si vendase ashtu dhe për eksport) dhe ato ku importet e produkteve nën standard shkaktojnë probleme.

Sikurse e kemi theksuar edhe herë tjetër në këtë Udhëzues, sistemi i certifikimit të konformitetit për produktet nën CPD kërkon, tek të gjitha produktet përveç atyre më pak të rrezikshme, ndërhyrjen e një ose më shumë Organizmash të Vlerësimit të Konformitetit: organizmat certifikues, organet inspektues dhe laboratorët e testimit. Disave prej tyre do t'u kërkohej të njihen formalisht si kompetentë (të autorizuar) nga autoritetet Shqiptare, ndërsa të tjerat, vecanërisht laboratorët testues, do t'u kërkohej të përmbushin një kërkesë për testim e cila nuk ekziston momentalisht tek prodhuesit. Në më të shumtën e rasteve, në mos në të tëra, autorizimi do të lëshohet nga organët që janë të autorizuar. Megjithatë, kjo shpesh paraqet skenarin klasik të "pulës dhe vezës":

- Nuk mund të vazhdoje me zbatimin e ligjit derisa të ekzistojnë Organet e Vlerësimit të Konformitetit (OVP),
- Nuk mund të krijojnë OVP derisa ekziston kërkesa,
- Nuk mund të zhvillojnë kërkesën derisa të jenë gati prodhuesit,
- Organizmi i akreditimit nuk mund të akreditojë derisa OVP të jenë gati!

Krijimi i laboratorëve testues të autorizuar mund të jetë fusha më e lehtë e aktivitetit dhe ajo e cila mund të sigurojë punë dhe eksperiencë për organin Akreditues. Ekzistenca e laboratorëve testues mund të asistohet me zhvillimin e sistemit të tyre të menaxhimit me standardet ISO/IEC 17025 dhe, fillimisht, akreditimi (dhe autorizimi nëse nevojitet) mund të kryhet për ato metoda testimi të cilat tashmë i ofrojnë laboratorët, sepse këto përfaqësojnë një kërkesë të tregut ekzistues.

Megjithatë kemi dy konsiderata të tjera të mëtejshme: tregu për nevojat e testimit mbetet i qëndrueshëm kështu që laboratorët janë të aftë të zhvillohen me etapa drejt akreditimit ndërkohë që vazhdojnë të ofrojnë shërbimet e tyre për prodhuesit. Për të arritur këtë, është e këshillueshme që të vendoset një proces zhvillimi i fazuar që të përfshijë p.sh. laboratorët e akredituar të testimit, ato të njohur -teknikisht si dhe laboratorët kandidatë për akreditim.

Laboratorët kandidatë janë në fazën fillestare të zhvillimi të sistemit të tyre dhe aftësive testuese, por të cilat informohen për fazat tek të cilat u duhet të kalojnë drejt akreditimit; laboratorët e njohur teknikisht do të jenë ato laboratorë që mund të kryejnë testime në përputhje me metodat dhe praktikat Europiane, por që nuk zbatojnë akoma sistemin që të përfitojnë akreditimin, ndërkohë që laboratorët testues të akredituar janë që ndodhen në fund të procesit dhe janë akredituar në të njëjtën nivel me ato të BE-se apo vendeve të tjera të ngjashme.

Krijimi i Organizmave të Inspektimit dhe Certifikimit mund të jetë më i vështirë, vecanërisht kur këto organizma nuk ekzistojnë fare. Organizmat duhet si fillim të identifikohen dhe krijohen, pastaj të trajtohen dhe asistohen sic duhet në krijimin e sistemit të tyre të brendshëm të manaxhimit në sipas ISO/IEC 17020, 17021 dhe/ose 17065, pastaj të lejohen të kryejnë vlerësime trajnimi të prodhuesve dhe së fundmi, të asistohen drejt akreditimit. Është e vështitë të krijosh organizma inspektimi dhe certifikimi ndërsa nuk ka kërkesa për shërbimet e tyre, por fatmirësisht këto funksione tentojnë të jenë “horizontale”; kështu për shembull një organizem certifikues mund të operojë në një fushë të gjerë të produkteve të ndërtimit si dhe në sektorët e tjerë, dhe të maksimizojë shanset për të mbijetuar në treg.

Aktivitete të vlefshme që ndihmojnë prodhuesit, OVP dhe autoritetet rregullatore, janë ato që quhen “Ushtrime Pilote”. Këto mund të marrin forma të ndryshme, për shembull, një formë është përzgjedhja e një fushe të një produkti të vecantë për të cilin ekzistojnë disa prodhues në Shqipëri (por jo aq shumë sa ushtrimi të bëhet i pa menaxhueshëm). Faza tjetër është që të identifikojë kapacitetet dhe nevojat e tyre në lidhje me punën në përputhje me Standardet Europiane, dhe aksesin e tyre në OVP të kualifikuara, dhe pastaj t’i jepet asistencë kur është e nevojshme (p.sh. në draftimin dhe zbatimin e sitemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë). Këto ushtrime nuk janë të vlefshme vetëm për prodhuesit, ato sigurojnë aktivitet për OVP përpara se atyre t’u kërkohej punë nga vetë prodhuesit dhe ato gjithashtu mund të ndihmojnë autoritetet të identifikojnë fazat e zhvillimi të prodhuesve Shqiptarë në përgjithësi si dhe asistencën e mëtejshme për të cilën ata kanë nevojë. Përfundimisht, prodhuesit dhe OVP të asistuar nëpërmjet këtyre ushtrimeve pilot mund të veprojnë si modele për prodhuesit dhe OVP të tjerë dhe t’i ndihmojnë në propagandimin e njohurive të tyre në të gjithë sektorin e ndërtimit.

Grupi “final” i cili ka nevojë të zhvillohet dhe informohet, duke qenë se ato mund t’i japin një stimul të rëndësishëm përdorimit në rritje të markës së konformitetit, është ai i blerësve dhe përdoruesve të produkteve të ndërtimit. Një sistem rregullator i cili nuk kuptohet ose zbatohet i shërben shumë pak qëllimit dhe mund të jetë dhe kundërveprues, vecanërisht nëse nuk ekziston kontrolli në vend, disa prodhues fillojnë të përdorin markën e konformitetit në mënyrë jo korrekte. Nëse përdoruesit, etj, janë të informuar mbi mundësitë që ju ofrohen

atyre nga marka e konformitetit, ata mund të fillojnë ta përdorin këtë sistem në avantazhin e tyre. Përveç të tjerash, kjo kërkon që ata:

- Të jenë gati të kërkojnë që produktet që ata përdorin të jenë prodhuar në përputhje me standardet Europiane (EN) dhe janë të markuara në mënyrë korrekte.
- Të pranojnë CE ose markën e konformitetit dhe të largohen prej blerjeve me “koston më të ulët”
- Të jenë familiarizuar me markën e konformitetit dhe të kuptojnë deklaratat e performancës së produktit, dhe kështu të jenë të aftë të bëjnë zgjedhje korrekte midis produkteve konkurrues
- Janë të informuar mbi CPD dhe çështjeve të tjera rregullatore (në universitet etj).

Për të arritur të gjithë këtë, si dhe për të ndihmuar grupet e tjera të identifikuar më sipër, nevojitet një publicitet i vazhdueshëm dhe një fushatë infomimi, me karakter të përgjithshëm apo specifik, ndërsa grupet e ndryshme fillojnë të zhvillohen drejt fazës ku ligji mbi produktet e ndërtimit mund të fillojë të hyjë në fuqi në Shqipëri.

5.2) Zhvillimi i sistemit rregullator në sektorin e ndërtimit (përveç CPD)

Në shumë vende që punojnë drejt sistemit rregullator që mbulojnë si ndërtimin (punimet e ndërtimit të përfunduara) ashtu dhe produktet e ndërtimit, ka një “Ligj Ndërtimi” të përgjithshëm idealisht i mbështetur në CPD e BE. Ligji i Ndërtimit shpesh korrespondon ngushtësisht me 6 Kërkesat Thelbësore mbi punimet e ndërtimit sikurse jepen në CPD, por këto kërkesa tentojnë të shkruhen në terma të përgjithshëm, sipas modelit “Struktura e punimeve duhet të jetë e tillë që t’i rezistojë forcave mekanike dhe të tjera që veprojnë mbi të” ose “Ndërtesa do të projektohet në mënyrë të tillë që përdorimi i enërgjisë të jetë i arsyeshëm”. Megjithatë, këto rregullore të nivelit të lartë, edhe pse korrekte në vetvete, nuk mund të përdoren lehtësisht me qëllim që të identifikojnë se çfarë nënkupton kjo në lidhje me karakteristikat e nevojshme dhe nivelin e performancës së produkteve të ndërtimit të mbështetura nga Ligji i Produkteve të Ndërtimit. Ajo që shpesh mungon, sikurse tregon dhe kjo diagramë, është dicka për të “lidhur” Ligjin e Ndërtimit tek Ligji i Produkteve të Ndërtimit:



Cfarëdo dokumentash që të përdoren për të zëvendësuar pikëpyetjen, ato i shërbejnë funksionit kyc të:

- ‘Lidhjes’ së Ligjit të Ndërtimit me Ligjin e Produkteve të Ndërtimit,
- Sigurimit të udhëzimeve për prodhuesit mbi karakteristikat e produktit dhe performancën,
- Lejimit të përzgjedhje korrekte të produkteve.
- Lejimin e mbikëqyrjes së tregut,
- Dhënien e udhëzimeve mbi praktikat korrekte të ndërtimit,
- Aplikimin e rregullave tek produktet jashtë CPD, p.sh. beton i gatshëm i përzier,
- Mundësimi për të paraqitur një sistem të inspektimit të ndërtimit.

Një shembull nga Mbretëria e Bashkuar mund të përdoret për të ilustruar këtë pikë. Rregullorja e Ndërtesave në Mbretërinë e Bashkuar, në lidhje me eficensën e energjisë të ndërtesave, pohon:

“Përcaktime të arsyeshme do të bëhen për mbrojtjen e gazit dhe elektricitetit në ndërtesa duke kufizuar fitimet dhe humbjet e nxehtësisë nëpërmjet elementeve termike dhe pjesëve të tjera të materialeve të ndërtimit.”

Megjithatë, asgjë nuk thuhet rreth asaj që konsiderohet e “arsyeshme” dhe, prandaj, nuk është e mundur, nga teksti i rregullores, të identifikosh se si mund të përmbushen kërkesat rregullatore. Në Mbretërinë e Bashkuar, megjithatë, ka një seri të atyre që quhen “dokumenta aprovuese” të cilat zgjerohen me kërkesat rregullatore. Duke ndjekur shembullin e mësipërm, dokumenti i Aprovimit deklaron që limiti i sipërm i humbjes së nxehtësisë për një mur ndërtimi normal është (vlera-U) $0,7 \text{ Ę/m}^2 \cdot \text{K}$. Me këtë vlerë, është e mundur të kontrollosh objektivisht nëse janë përmbushur kërkesat rregullatore.

Vlera-U në përgjithësi është shuma e anasjelltë e të gjitha vlerave të rezistencës termale të produkteve që përbejnë elementin, të dhënë nga:

$$U = 1 / (R_{so} + \sum R_n + R_{si})$$

ku R_{so} dhe R_{si} janë rezistencat e sipërfaqeve të brëndshme dhe të jashtme respektive dhe $\sum R_n$ është shuma e rezistencave të produktit.

Nëse rregulloret përmbajnë një kërkesë për performancën termike të mureve, atëherë është e qartë se prodhuesit e të gjitha produkteve të përdorura në mure, dhe ku produkti përbën një kontribut të rëndësishëm për performancën, duhet të paktën të deklarojë rezistencën termike (ose përcjellshmërinë) e produkteve të tyre dhe si dhe trashësia duhet gjithashtu të njihet. Ky informacion mund të përdoret pastaj, nga ana e projektuesit të ndërtimit, për të llogaritur nëse

projektimi i ndërtimit të tij përmbush kërkesat rregullatore.

Supozojmë që muri është i përbërë prej 220mm tulla, prej 40 mm izolimi me polistiroli të zgjeruar (EPS) dhe 16 mm suva në anën e brëndshme. Nga të dhënat e referuara, mund të gjejmë vlerat e mëposhtme:

Tulla $k = 0,84 \text{ W/m.K}$
 Suva $k = 0,50 \text{ W/m.K}$

Rezistenca e jashtme, $R_{so} = 0,055 \text{ m}^2.\text{K/W}$
 Rezistenca e brëndshme $R_{si} = 0,123 \text{ m}^2.\text{K/W}$

Prodhuesi i EPS deklaron, nëpërmjet markes CE që përçueshmëria e izolimit të tij është:

EPS $k = 0,04 \text{ W/m.K}$

Rezistenca e produktit është thjesht trashësia e pjesëtuar me përcjellshmërinë e cdo shtrese, kështu:

$R_{tullës} = 0,22/0,84 = 0,261 \text{ m}^2.\text{K/W}$
 $R_{suva} = 0,016/0,50 = 0,032 \text{ m}^2.\text{K/W}$
 $R_{EPS} = 0,04/0,04 = 1,000 \text{ m}^2.\text{K/W}$

Duke përdorur ekuacionin e mësipërm:

$$U = 1 / (0,055 + 0,261 + 0,032 + 1,000 + 0,123) = 0,680 \text{ W/m}^2.\text{K}$$

Duke krahasuar këtë vlerë me maksimumin e vlerës së lejuar $0,7 \text{ W/m}^2.\text{K}$, mund të vërehet se ky projektim i veçantë i murit përputhet me kërkesat, edhe pse nëse projektuesi të kishte specifikuar 30 mm EPS në vend të 40 mm, dizajni nuk do të përputhej.

Ky është vetëm një shembull nga ku 'lidhja' e kërkesave të ndërtimit me kërkesat e produkteve të ndërtimit e lejon sistemin rregullator të funksionojë në një mënyrë praktike dhe relativisht të lehtë; prodhuesit e dinë se çfarë ata duhet të deklarojnë për prodhimet e tyre, dhe projektuesit marrin informacionin e nevojshëm të produktit nga marka CE dhe kanë një kriter objektiv kundrejt të cilit ata mund të kontrollojnë nëse kërkesat rregullatore për punimet e ndërtimit janë përmbushur. Një inspektor i ndërtimit mund të vizitojë ndërtesën dhe të

sigurohet që janë përdorur produkte korrekte. I njëjti parim mund të zbatohet në lidhje me të gjitha Kërkesat Thelbësore të cilat janë të rregulluara.

Sasia e përgjithshme e dokumentacionit përkatës apo mbështetës, të cilat mund të përfshijnë Kodet e Praktikës, Guidat e Instalimit dhe dokumentë të Praktikave më të Mira korrente, mund të jetë voluminoze (një vlerësim prej 50 000 faqe në disa shtete të BE nuk është larg realitetit). Përsa i përket Shqipërisë (duke supozuar që informacioni nuk ekziston momentalisht), pyetja do të jetë se si të prodhohet sa më mire udhëzuesi i munguar. Një mundësi është që të përshtaten dokumentet ekzistuese nga vende që kanë të njëjtat kushte të ngjashme gjeologjike dhe klimaterike (p.sh. Greqia, Spanja ose Italia), por edhe kur përshtat dokumenet ekzistuese, ajo kërkon veprim nga dikush që të sigurojë që ato janë të aplikueshme për kushtet Shqiptare. Krijimi i një grupi pune i përbërë prej ekspertëve përkatës të ndërtimit, mund të ishte zgjidhja më e mirë për këtë detyrë.

5.3) Obligimet dhe angazhimi i palëve të interesuara

Një menaxher i famshëm i futbollit skocez, një herë tha: “Është shumë më mirë ta realizosh hakmarrjen në fillim” dhe, në qoftë se do përdornim këtë apo deklarata tjera të ngjashme të tilla si “Është gjithmonë më mirë të jesh një hap përpara lojës” , kjo do të ishte tema e këtij nën-seksioni. Ndërkohe që tregu Shqiptar hapet si rezultat i zbatimit të ligjit të mbështetur në CPD, si do të sigurohen aktorët e ndryshëm të tregut që ato nuk zëvendësohen nga të tjerët, vecanërisht ato që vijnë nga jashtë, dhe që ata do të jenë të aftë të konkurojnë efektivisht si në tregun Shqiptar dhe në tregun e eksporteve?

Prodhuesit

Një nga mundësitë e ofruara për prodhuesit nga direktiva është ajo e eksportimit të produkteve të tyre në vende të tjera, dhe ky është fakt i vërtetë. Por detyrimi korrespondues është se prodhuesi duhet të punojë në përputhje me dispozitat e duhura të standardit European, ai duhet të testojë produktet e tij, ai duhet të operojë me sistemin e kontrollit të prodhimit në fabrikës dhe kështu me radhë. Po ashtu, në të njëjtën mënyrë, Ligji për Produktet e Ndërtimit hap tregun për eksportin e produkteve Shqiptare dhe gjithashtu hap tregun Shqiptar për importet që vijnë nga tregjet e tjera.

Ditët kur prodhuesit lokalë mund të kenë tregjet e tyre të “mbrojtura” në njëfarë mënyre, pra ata mund të vazhdojnë të prodhojnë produkte nën- standard duke mos pasur frikë nga konkurrenca, do të kalojë shumë shpejt dhe do të mbeten vetëm ato prodhues të cilët rinovojnë facilitetet e prodhimit dhe sistemin e menaxhimit, dhe sigurisht ata produktet e të cileve janë në përputhje me Standardet Europiane të cilët do të mund të mbijetojnë dhe konkurojnë në një treg të hapur. Por

prodhuesit nuk mund që të presin që dikush ose ndonjë organizatë t'u thotë ekzaktësisht se çfarë duhet të bëjnë dhe kur; është e rëndësishme për to që ta gjejnë vetë informacionin dhe ky udhëzues është një pikënisje për këtë.

Prodhuesit që përftojnë markën CE, ose markën e konformitetit me standardet Shqiptare, përpara rivaleve të tij (Shqiptare ose importues), kanë më tepër shanse të fitojë avantazh në treg. Gjithashtu, ndërsa tregu Shqiptar zhvillohet, ato prodhues të cilët përfitojnë nga pajisjet e përditësuara të prodhimit, ose ato që përdorin marka të cilësisë në mënyrë vullnetare, ose ato që zgjerojnë biznesin e tyre etj, kanë më tepër shanse të përfitojnë më të shumtën prej tyre. Prandaj, më mirë se sa të presin që keto zhvillime të ndodhin rreth tyre, prodhuesit kanë nevojë të veprojnë vetë për të ecur përpara.

Është e dukshme se në Ballkan dhe në vende të tjera, të ngjashme, ato prodhues të cilët janë të suksesshëm apo ata të cilët janë në proces për t'u bërë të suksesshëm, janë ata që tashmë janë përpara në lojë. Për shembull, ligji do të vendosë kërkesën për prodhuesit për të operuar një sistem kontrolli të prodhimit në fabrikë (për shembull sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas standardit ISO 9001). Por një prodhuesi i cili pret derisa ai të jetë i obliguar të bëjë këtë, do t'i duhet më pas të kalojë nëpër procesin e zhvillimit dhe zbatimit të një sistemi të tillë (i cili mund të marrë një vit ose më shumë); do të kuptojë çfare humbet në krahasim me rivalin e tij që tashmë e ka një të tillë sistem. Edhe pse është e mundur që të pritët për një detyrim dhe pastaj të veprohet, nuk ka asgjë që parandalon prodhuesit të shikojnë përpara nga të vepruarit më parë se këto detyrime të vijnë. Edhe nëse një prodhues merr vendimin që të fillojë të punojë drejt një sistemi të Menaxhimit të Cilësisë përpara se ky detyrim të vijë, ai mund të marrë përfitim teknike dhe komerciale të cilat do fuqizojnë dhe pozicionin e tij në treg.

Tre opsionë të tjera mund të përdorim për të ilustruar këtë pikë. Si fillim, një prodhues mund të thotë "Unë nuk mund të punojë me një Standard European sepse ky standard nuk është i disponueshëm në Shqipëri". Kjo nuk mund të jetë e vërtetë, pasi Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit thotë që ka adoptuar të gjitha Standardet European të harmonizuara në kaudrin e CPD-se (edhe pse keto nuk janë akoma të përkthyer në Shqip). Nëse Standardet European nuk janë adoptuar akoma, ato janë të disponueshme nëpërmjet internetit nga disa burime dhe, megjithëse kostot e standarteve të tilla mund të duken fillimisht të larta, ato janë shumë të vogla kur shpërndahen në vlerën e prodhimit vjetor ose kur krahasohen me tregjet në rritje, dhe uljen e humbjeve apo produkteve nën standard që ato do të sillnin.

Së dyti, kur një standard fillon të hyjë në fuqi, ekziston nevoja që produktet të testohen kundrejt tij dhe kjo kërkon kohë. Nëse burimet testuese janë të kufizuara, nuk mund të jetë e mundur për një prodhues specifik të testojë produktet e tij

dhe ai do të humbasë përkundrejt prodhuesve të cilët kanë filluar procesin e testimit kohë më parë. Përfundimisht, mund të jetë e vështirë që të përmbushësh kërkesat e një standardi duke përdorur pajisje dhe metoda matjeje të vjetra. Kjo nuk nënkupton automatikisht që prodhuesit duhet të investojnë vetë në makinëri të reja, ekzistojnë mundësitë e krijimit të partneriteteve të një forme apo një tjetër, për shembull nga BE e cila sjell investimet e nevojshme.

Në përmbledhje, prodhuesit të cilët janë ‘një hap përpara lojës’ do të përfitojnë shumë nga mundësitë që sjell CPL e re dhe ato që qëndrojnë ku janë mund të humbasin.

Autoritetet

Ekzaktësisht ashtu si vetëm ato prodhues të cilët janë proaktivë për të ecur përpara, do të përfitojnë nga zbatimi i CPL, edhe Shqipëria si një e tërë do të përfitojë nëse ekziston një përfshirje proaktive e autoriteteve të ndryshme. Në nivelin më të lartë, ka nevojë që të sigurohet “paketa” ligjore e kompletuar, edhe nëse kjo paketë kërkon përditësimin ndërkohë që dhe vetë legjislacioni i BE ndryshon. Por pastaj planet duhet të ekzistojnë jo vetëm për të filluar zbatimin e legjislacionit por edhe të publikojnë ekzistencën e saj tek ato që preken prej saj. Le të marrim një shembull: Ligji për Produktet Shqiptare të Ndërtimit i lejon prodhuesit të aplikojnë markën e konformitetit Shqiptar, cka është tërësisht korrekte. Por si është ky simbol i markës së konformitetit Shqiptar, si i duket ai prodhuesve, dhe a ka ai ndonjë vlerë në vendet fqinjë ku edhe prodhuesit Shqiptarë mund të eksportojnë?

Një treg jo i rregulluar është një target i lehtë për “shkarkimin” e produkteve nën standard ose për shitjen e produkteve të përjashtuara mbi bazë performace nga tregu i BE-se. Autoritetet Shqiptare kanë një rol për të mbrojtur prodhuesit e tyre dhe qytetarët nga produkte të tilla, jo direkt me ndalimin e importeve ose ekuivalentëve të saj, por duke siguruar ekzistencën e një sistemi të mbikqyrjes së tregut i cili të funksionojë në mënyrën e duhur dhe i pajisur më së miri. Dhe pastaj pyetja thelbësore për autoritetet Shqiptare do të ishte nëse zbatimi i CPL, dhe i legjislacionit shoqëruar dhe infrastrukturës mbështetëse (e cila përfshin zhvillimin dhe përditësimin e infrastrukturës), është një aktivitet i “orientuar nga tregu” ose një aktivitet i cili kërkon nga qeveria ndërhyrje dhe asistencë, në një formë apo në një tjetër.

Është korrekte që direktivat e BE, pasi ato të jenë operative, të jenë orientuar fillimisht nga tregu, p.sh. përgjegjësi për hedhjen e produkteve të sigurta në treg është kryesisht një aktivitet për vetë prodhuesit. Por procesi i kalimit nga situata e tregut aktual Shqiptar në atë në të cilën prodhuesit marrin përgjegjësitë e tyre të duhura, edhe nëse nuk kërkon shumë vjet nëse kjo do t’i liresh tregut, kërkon ndërhyrje, financim dhe asistencë gjatë gjithë zhvillimit të tij.

Infrastruktura Mbështetëse

Në kategorinë e “infrastrukturës mbështetëse” përfshihen Organizata e Standardeve Shqiptare (DPS), organi i Akreditimit dhe Vlerësimit të Konformitetit Shqiptar. DPS duhet të ketë (dhe e ka tashmë) një plan kohor për paraqitjen e standardeve të duhura për të mbështetur zbatimin e CPL, ku ky plan kohor merr parasysh nivelet e ndryshme prioritare: produktet kritike në lidhje me sigurinë, produktet me rëndësi ekonomike për tregun Shqiptar, produktet ku importet që janë nën-standard njihen që shkaktojnë probleme, e kështu me rradhë. Përveç kësaj, kurdo që prezantohet një Standard European i harmonizuar, duhen future gjithashtu të gjitha standardet mbështetëse të nevojshme, sepse pa to është e vështirë të sillet hEN në praktikë.

Po kështu, eksperiencia në vendet fqinjë ka treguar që për produktet e ndërtimit ‘tipike’ në tregun Shqiptar, sistemi më i ngjashëm i vërtetimit të konformitetit do të jetë sistemi 2+ dhe, prandaj tipi i Organit të Vlerësimit të Konformitetit i nevojshëm do të jetë sistemi i kontrollit të prodhimit në fabrikë. A është prioriteti i Organit të Akreditimit të identifikojë më shumë organe të tilla sesa ajo tashmë e akredituar për cimenton?

5.4) “Standardet Mbështetëse”

5.4.1) Hyrje

Përveç Standardeve të Harmonizuara Europiane të cilat mbulojnë produktet në kuadrin e CPD, dhe atyre standardeve të cilat drejtpërdrejt i mbështesin ato, ekzistojnë standarde të ndryshme të tjera të përgatitura kryesisht nga CEN të cilat, edhe pse ata nuk janë të nevojshme drejtpërsëdrejti për zbatimin e CPD, janë relevante për sektorin e ndërtimit. Këto standarde janë përshkruar shkurtimisht në këtë nën-pjesë.

Ndoshta seritë më relevante të standardeve janë Eurokodet Strukturore, të cilat përcaktojnë parimet dhe rregullat për projektimet strukturore në të gjithë Evropën; këto janë të përshkruara në 5.4.4.

5.4.2) Përformanca e Energjisë, substancat e rrezikshme, produktet në kontakt me ujën, kostimi i ciklit jetësor dhe standardet mjedisore.

Nën “Direktivën e Përformancës së Energjisë së Ndërtesave (EPBD)” të BE, 2002/91/KE, ekziston një numer i konsiderueshem standardizimesh me qëllim

mbështetjen e kësaj directive. Përvec karakteristikave termike të ndërtesave, direktiva kërkon gjithashtu vlerësimin e shkallës së ngjeshjes së ajrit, eficientësinë e instalimeve të ngrohjes, furnizimin me ujë të nxehtë, ajrin e kondicionuar, ventilimin dhe ndricimin e inkorporuar, pozicioni dhe orientimin e ndërtesave, sistemet diellore pasive dhe mbrojtjen diellore, klimën brenda ndërtesës, influencën pozitive të sistemit aktiv diellor dhe sistemet e tjera të ngrohjes apo elektrike mbështetur kjo në burimet e energjisë se rinovueshme, rrymën dhe nxehtësinë e kombinuar (CHP), ngrohjen dhe freskimin e zonës si dhe ndriçimin natyral.

Komitetet e ndryshme Teknike CEN (TCs) të përfshira këtu dhe në fushat përkatëse përfshijnë:

CEN/TC 89: Përformanca termike e ndërtesave dhe komponentët e ndërtimit,
CEN/TC 156: Ventilimi i ndërtesave,
CEN/TC 169: Drita dhe Ndricimi,
CEN/TC 228: Sistemet e ngrohjes në ndërtesa,
CEN/TC 247: Automatizimi i ndërtesave, kontrolli dhe menaxhimi i tyre,
CEN/TC 350: Qëndrueshmëria e punimeve të ndërtimit.

Nuk është e mundur të listohen të gjitha standardet nga këto Komitetë Teknike (megjithatë ato mund të gjenden në websitë të CEN , www.cen.eu) por ato më relevantet janë :

EN 15217:2007 *Përformanca e Energjisë së ndërtesave - Metodrat për shprehjen e performancës së energjisë dhe certifikimin e energjisë së ndërtesave*
EN 15265:2007 *Përformanca e Energjisë së ndërtesave - Llogaritja e nevojave të energjisë për hapsirat e ngrohjes dhe të ftohjes duke përdorur metodat dinamike-Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e miratimit*
EN 12599:2000 *Ventilimi për ndërtesat - Procedurat e Testimit dhe metodat e matjes për dorëzimin e sistemit të kondicionimit dhe ventilimit të instaluar*
EN 15603:2008 *Përformanca e Energjisë së ndërtesave - Përdorimi i përgjithshëm i energjisë dhe përcaktimi i vlerësimit të energjisë*

Komiteti Teknik CEN/TC 351 është krijuar për t'ju përgjigjur Mandatit M/366 mbi përmbajtjen e substancave të rrezikshme dhe leshimit të tyre nga produktet e ndërtimit, vecanërisht në mbështetje të Kërkeses Thelbësore 3 të CPD. Ky Komitet Teknik nuk vlerëson vetëm metodat e testimit dhe të vlerësimit por gjithashtu punon mbi produkte që klasifikohen, në lidhje me substancat e rrezikshme, pa e testuar ose “pa e testuar më tej”. Megjithëse disa rastë të substancave të rrezikshme janë tashmë përfshirë në hEN-e, kjo fushë do të bëhet më e rëndësishme me zhvillimin e punës së Komitetit Teknik TC 351, si dhe atij të sistemit rregullator për substancat e rrezikshme.

Ekzistojnë lidhje të qarta ndërmjet Direktivës së Ujit të Pijshëm të KE dhe CPD në lidhje me produktet e ndërtimit që janë në kontakt më ujë dhe pijshëm. Kjo punë, megjithëse ka vazhduar për vite, akoma mbetet në fazën e saj relativisht të hershme të zhvillimit, por kjo do të ketë një ndikim mbi shumë standarde të produkteve të ndërtimit në momentin, atëherë kur vendet anëtare të BE bien dakord mbi kërkesat e tyre rregullatore.

Komiteti Teknik CEN/TC 126 “Akustikat” përgatit një shumicë standardesh të metodave të testimit që kërkohen për përcaktimin e performancës akustike të produkteve të ndërtimit për qëllime të markës CE. Këto standarde i mbulojnë si testimin e laboratorit ashtu edhe testimin e fushës dhe janë kryesisht brenda serive EN ISO 140. Megjithatë, KT 126 gjithashtu prodhon standarde, nëpërmjet Grupit të saj të Punës GP 2 “Parashikimi i performancës akustike të ndërtesave nëpërmjet performancës së elementeve” të cilat synojnë që performanca e ndërtesave të jetë rezultat i informacionit të performancës së akustikës të dhënë me markën CE.

Vazhdon puna brenda Komitetit Teknik ISO/TC 59/SC14 “Design life” e cila ka lidhje me sektorin e ndërtimit. Nëpërmjet serisë së standardeve ISO 15686, ideja është përdorimi i konceptit të planifikimit të shërbimeve jetesore për të lejuar prodhuesit të vlerësojnë dhe deklarojnë jetegjatesinë e shërbimit të produkteve të tyre në disa përdorime finale të caktuara. Ky koncept mund të funksionojë në të ardhmen, vecanërisht kur të ketë më tepër të dhëna për metodat e vlerësimit, por ndërkohë nuk ka planë për të përfshirë jetegjatesinë e shërbimeve si një kërkesë për markën CE në kuadrin e CPD.

Në bazë të Traktatit që përcakton se “Kërkesat e mbrojtjes mjedisore të Komunitetit Europian duhet të integrohen në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve të BE.....vecanërisht e parë në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm”. BE përpiqet të arrijë këtë mbrojtje mjedisore nëpërmjet një paketë të instrumentave ligjore, zbatimi i të cilave mbështetet shpesh nga standardet. Një standard i tillë, për të cilën një paketë programesh është e disponueshme është EN 15446:2008 *Emetimet e shpërndara dhe të humbura një shqetësim i përbashkët i sektorëve të industrisë - Matja e emisionëve të humbura të avujve që gjenerohen nga pajisjet dhe rrjedhja e tubacionëve*.

5.4.3) Menaxhimi i sistemit të standardeve

Standardet nën këtë titull përdoren më shumë në mbështetje të CPD ose proceseve të saj, pra është relevante që t'i përmendim këtu. Megjithatë ato nuk janë të detyrueshme, edhe pse disa vende zgjedhin që t'i bëjnë të tilla.

EN ISO 9001: Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë - Kërkesat: Shumë standarde hEN nën CPD përmbajnë një klauzolë, në lidhje me sistemin e kontrollit të prodhimit të

fabrikës (FPC), e cila thotë: “Nëse prodhuesi operon me një sistem që mbështetet tek standardi EN ISO 9001, dhe i specifikon kërkesat e këtij standardi, atëherë kërkesat e FPC të këtij standardi konsiderohen të jenë përmbushur”. Nuk është e lejueshme, në bazë të rregullave të BE, të përputhesh në mënyrë të detyrueshme me standardin EN ISO 9001 dhe as lejohet të kërkesat që prodhuesi të ketë një sistem EN ISO 9001 të certifikuar. Megjithatë nëse prodhuesi zgjedh të adoptojë një sistem të tillë (të cilin mund ta bëjë për arsye marketingu), atëherë për aq kohë sa sistemi i tij mbulon kërkesat specifike të FPCme standardet hEN me të cilat punon, atij nuk i duhet të bëjë gjë tjetër. Dispozita tjetër relevante këtu është që nëse sistemi Vërtetimi i Konformitetit të CPD kërkon që sistemi FPC i prodhuesit të inspektohet dhe/ose certifikohet nga një organizem i notifikuar, atëherë prodhuesi nuk mund të përdorë rezultatet nga një organizem jo-i notifikuar për qëllime të CPD (ai duhet megjithatë të mund të përdorë rezultatet nga një organizem i notifikuar që përmbush cdo kërkesë për certifikim vullnetar).

Standarde për Vlerësimin e Konformitetit: Me qëllim që të gjykojmë kompetencat e organizmit të autorizuar/notifikuar që të punojë nën CPD, shumica e vendeve anëtare të BE kërkojnë që të akreditohen me standardin e duhur ISO/IEC për vlerësimin e konformitetit si më poshtë :

- **ISO/IEC 17025:** Kërkesat e përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibruës,
- **ISO/IEC 17020:** Kriteri i përgjithshëm për operimin e tipeve të ndryshme të organeve që kryejnë inspektim,
- **ISO/IEC 17021:** Vlerësim i Konformitetit- Kërkesat për organizmat që sigurojnë auditim dhe certifikim të sistemit të menaxhimit,
- **ISO/IEC 17065:** Vlerësimi i Konformitetit- Kërkesat për organizmat certifikuese që certifikojnë produkte, procese dhe shërbime.

Edhe nëse organizmat nuk kërkojnë që të jenë formalisht të akredituara, është tepër e dëshiruar, për kredibilitet teknik dhe qëllime të njohjes reciproke, që ata të punojnë në përputhje me këto standarde. Në vijim të përmbushjes së kërkesave të përgjithshme të parashtruara për këto standarde, organizmat certifikues dhe inspektues duhet gjithashtu të kenë njohuritë e duhura specifike të produktit, një organizem që certifikon një prodhues çimentoje duhet për shembull të jetë kompetent për të vlerësuar dispozitat specifike të prodhuesit të çimentos.

5.4.4) Eurokodet Strukturore

Detyra e Komitetit Teknik CEN/TC 250 është përgatitja e kodeve të konstruksionit që do të përdoret në Bashkimin Europian në fushën e inxhinierisë strukturore. Këto kode njihen si **Eurokodet Strukturore**. Eurokodet sigurojnë rregulla konstruksioni strukturore të përbashketa për përdorim të përditshëm për një **konstruksion**

të sigurtë të gjithë strukturave dhe produkteve përbërës. Aktualisht, Eurokodet Strukturore përfshijnë standardet e mëposhtme:

- EN 1990 Eurocode 0: Bazat e projektimit strukturor
- EN 1991 Eurocode 1: Veprimet mbi strukturat
- EN 1992 Eurocode 2: Projektimi i strukturës së betonit
- EN 1993 Eurocode 3: Projektimi i strukturës së hekurit
- EN 1994 Eurocode 4: Projektim i hekurit të përbërë dhe strukturave të betonit
- EN 1995 Eurocode 5: Projektim i strukturave drusore
- EN 1996 Eurocode 6: Projektim i strukturave të ndërtimit
- EN 1997 Eurocode 7: Projektimi Gjeoteknik
- EN 1998 Eurocode 8: Projektimi i strukturave për rezistencë ndaj tërmeteve
- EN 1999 Eurocode 9: Projektim i strukturave të aluminit

Standardet japin procedura alternative, vlera dhe rekomandime, me shënime që tregojnë se ku mund të bëhen zgjedhjet kombëtare. Versionet kombëtare të Eurokodeve përfshijnë Anekset Kombëtare që përmbajnë të gjitha Parametrat e Përcaktuar Kombëtare (NDPs) për t'u përdorur për projektimin e ndërtesave dhe punimeve inxhinierike civile që do të ndërtohen në vëndin përkatës. Këto parametra (NDPs) mbulojnë kryesisht faktorët e sigurisë që duhen përdorur në projektim.

Situata aktuale tregon që të gjitha Eurokodet Strukturore janë në fazën e tyre përfundimtare. Kjo do të thotë që Marsi i 2010 është data që të gjithë vendet e BE duhet të terhiqnin cdo kod strukturor kombëtar konfliktues dhe nga kjo datë e në vazhdim Eurokodet janë e vetmja bazë mbi të cilën do të projektohen strukturat inxhinierike civile. Përtej avantazheve të tjera, përshtatja e gjerë e këtyre standardeve duhet të lejojë projektuesit strukturorë të ofrojnë shërbimet e tyre në të gjithë Bashkimin Europian.

Zhvillimi i Eurokodeve është i vazhdueshëm dhe aktivitetet planifikohen që të prezantojnë dispozita për xhame strukturore, fibër përforcuar polimere, struktura membranë, vlerësimin e strukturave ekzistuese, etc. Puna mund të fillojë edhe për të parë aspektin e qëndrueshmërisë në inxhinierinë strukturore.

Përsa i përket Shqipërisë, adoptimi i Eurokodeve Strukturore konsiderohet gjerësisht si një nevojë aktuale, me qëllim që të përditësohen dhe të përmirësohen ndjeshëm kodet për projektimin strukturor të sigurtë të ndërtesave dhe punimeve të inxhinierisë civile. Puna për adoptimin e Eurokodeve në Shqipëri është përceptuar si një proces që duhet arritur hap-pas-hapi duke marrë parasysh nevojat aktuale, prioritetet dhe vecoritë në projektimin strukturor në Shqipëri. Kjo mund të realizohet brenda kuadrit të bashkëpunimit ndërmjet, para së gjithash, të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimeve si një Organ Kombëtar i Standardeve që ka kontakte zyrtare me CEN dhe CEN/TC 250, me



Udhëzues për direktivën e produkteve të ndërtimit

Departamentet/Drejtoritë respektive të Ministrisë së Punëve Publike. Zyra të tjera shtetërore/ publike dhe institucionë që merren me problemet e sigurisë strukturore të ndërtesave, si edhe homologë të tjerë publikë ose privatë në fushën e ndërtimit, mundet gjithashtu të ofrojnë kontributin e tyre në këtë proces.